

Grupet e komunitetit dhe planifikimi urban në Prizren
QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS 2014
Dhjetor 2014, Prizren

PËRMBAJTJA

I. Hyrje	2
II. Metodologjia e projektit	3
III. Koncepti i “qytetit gjithëpërfshirës”	4
IV. Të moshuarit dhe planifikimi urban në Prizren	5
V. Gratë dhe planifikimi urban në Prizren	14
VI. Personat me nevoja të veçanta dhe planifikimi urban në Prizren	24
VII. Të rinjtë dhe planifikimi urban në Prizren	33
VIII. Lagjet e varfra/vendbanimet joformale dhe planifikimi urban në Prizren (lagjia Tusuz)	40
IX. Mjedisi dhe planifikimi urban në Prizren	49
X. Kultura dhe planifikimi urban në Prizren	56
EC Ma Ndryshe.....	65

Ky publikim është përgatitur në kuadër të projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, që përkrahet financiarisht nga Olof Palme International Center, e cila përkrahet nga Qeveria e Suedisë



I. Hyrje

Ky është viti i dytë i publikimit “Qyteti gjithëpërfshirës”, që përmbledh raportet e shtatë ekspertëve, detyra e të cilëve ishte t’i strukturojnë të gjeturat e një cikli të gjatë hulumtues dhe t’i paraqesin ato në formë të dokumenteve udhëzuese për qeverinë lokale të Prizrenit, si kontribut për procesin e planifikimit urban. Sikurse në vitin e parë të këtij publikimi, autorët e shtatë raporteve janë shërbyer me të dhëna konkrete nga hulumtimi i zhvilluar me shtatë grupe të komunitetit në Prizren (të moshuarit, gratë, personat me nevoja të veçanta, të rinjtë, lagjet e varfra / vendbanimet joformale, mjedisi dhe kultura). Të gjitha raportet janë shkruar duke e respektuar një strukturë standarde, që përfshin: përmbledhjen ekzekutive, hyrjen, situatën aktuale, të gjeturat dhe rekomandimet.

EC Ma Ndryshe ka vazhduar takimet e rregullta me grupet e komunitetit edhe gjatë vitit 2014 për të diskutuar mbi nevojat dhe shqetësimet e këtyre grupeve. Fokus grupet janë fascilituar nga persona që kanë njohuri adekuate mbi grupet përkatëse të komunitetit, ndërsa diskutimet janë orientuar kah identifikimi i nevojave dhe vizionimi i zgjidhjeve për adresimin e shqetësimeve. Në të njëjtën kohë, gjatë vitit 2014 është zhvilluar një anketim me mostër përfaqësuese, që ka identifikuar shqetësimet e qytetarëve të Prizrenit në raport me planifikimin urban. Ky ka qenë anketimi i tretë rradhazi, pas dy të tjerëve që janë zhvilluar gjatë vitit 2013. Të gjitha të gjeturat janë validuar në debate publike (një për secilin grup të komunitetit), në të cilat kanë marrë pjesë një numër i madh hisedarësh. Të gjitha të gjeturat nga ky cikël i hulumtimit i janë dërguar ekspertëve, të cilët i kanë përpiluar raportet përfundimtare në formë të dokumenteve udhëzuese për qeverinë lokale.

Nga një koncept teorik në fillim, “qyteti gjithëpërfshirës” është shndërruar në parimin themelor të punës dhe synimin e përgjithshëm të EC Ma Ndryshe. Vizioni i qytetit gjithëpërfshirës përkthehet në ambient fizik përmes projektimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit pjesëmarrës. Projektimi gjithëpërfshirës ua mundëson njerëzve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që të marrin pjesë në hartim dhe të vlerësojnë projektet. Planifikimi pjesëmarrës është paradigmë e planifikimit urban që mëton përfshirjen e gjithë bashkësisë në proceset strategjike dhe menaxhuese të planifikimit urban. Qasja fillestare të projektimit gjithëpërfshirës është që të binden anëtarët e bashkësisë që të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e strategjive të herëshme dhe planifikimin e projekteve për qytetin e tyre.

Ne në EC Ma Ndryshe vazhdojmë të punojmë për nxitjen e ndjenjës së përkatësisë dhe të përgjegjësisë së grupeve të komunitetit ndaj mjedisit të tyre jetësor. Për të arritur këtë, organizata angazhohet në ridefinimin e raportit të qytetarit me qytetin. Ne besojmë se ndryshimi esencial që duhet arritur në këtë rast ka të bëjë me shndërrimin e qytetarit nga një marrës (pranues) pasiv i shërbimeve publike në qytetarin pjesëmarrës për definimin dhe rregullimin e mjedisit jetësor dhe në kontribuesin kryesor për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e atij mjedisi. Përmes metodologjisë së “qytetit gjithëpërfshirës”, EC Ma Ndryshe ofron një model konkret për ridefinimin e këtij raporti, i cili në të njëjtën kohë është edhe mundësi për të nxitur praktikë demokratike të qeverisjes lokale në fushën e planifikimit urban. Gjatë viteve 2013 dhe 2014, bashkë me grupet e komunitetit, ne kemi ofruar një dëshmi të qartë se modeli i “qytetit gjithëpërfshirës” është i mundshëm dhe mbi të gjitha është i nevojshëm për të patur qytete më të mira dhe më demokratike.

Ky është viti i dytë që përmes përmbledhjes së gjithë punës hulumtuese dhe komunitare gjatë vitit në një dokument përfundimtar, EC Ma Ndryshe tenton të ofrojë alternativa të politikave publike, si edhe të përçojë thirrjen për qeverinë lokale dhe qytetarët për të konceptuar qytetin si hapësirë të përgjegjësisë së përbashkët, e cila duhet të ndërtohet mbi parimet e demokracisë dhe zhvillimit.

Ne besojmë se qyteti (Prizreni) mund të bëhet. Për këtë tashmë kemi edhe dëshmi të mira.

II. Metodologjia e projektit

“Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” është projekt tre-vjeçar i EC Ma Ndryshe, i cili synon të artikulojë nevojat e grupeve të komunitetit dhe t’i përkthejë ato në plane të zbatueshme urbane të komunës së Prizrenit. Projekti përkrahet nga Olof Palme International Center dhe ka filluar së zbatuari në muajin janar 2013. Grupet e komunitetit me të cilat po punohet në këtë projekt janë: gratë, të moshuarit, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, banorët e lagjeve të varfra, kultura dhe mjedisi. Me secilin grup të komunitetit, gjatë një viti të projektit organizohen fokus grupe dhe debate publik, ndërsa paralelisht zhvillohet procesi i avokimit dhe bashkëpunimit me komunën e Prizrenit dhe Drejtorinë e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor për të siguruar përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në planifikimin urban të qytetit.

Planifikimi urban në Kosovë është një aktivitet teknik dhe i udhëhequr nga ekspertët, që kryesisht bazohet në të dhënat ekzistuese dhe ka pak ndërlidhje me mjedisin (kontekstin) për të cilin hartohet. Kjo praktikë kryesisht prodhon plane që janë jashtë kapacitetit realizues të qeverisë lokale dhe për më tepër, ajo nuk e reflekton realitetin në terren, me ç’rast qytetarët nuk kanë ndjenjë përkatësie. Pjesëmarrja e qytetarëve kufizohet brenda një periudhe të caktuar disa-ditore dhe kryesisht disa ditë para miratimit përfundimtar të planeve.

Ekziston një nevojë imanente për përfshirjen e interesave dhe aspiratave që qytetarëve në planet urbane, e sidomos të atyre grupeve që jetojnë janë të prvuara nga infrastruktura dhe shërbimet adekuate publike. Pjesëmarrja e gjerë e qytetarëve është qenësore që planet urbane të jenë relevante dhe të zbatueshme. Planifikimi urban gjithëpërfshirës ndihmon edhe procesin e demokracisë lokale, duke inkurajuar përfshirjen qytetarë në të gjitha nivelet e procesit. Kjo qasje e re e urbanizmit (Urbanizmi i Ri) sfidon modelin aktual në Kosovë (planifikimin socialist të qyteteve), i cili ofron shumë pak hapësirë për qytetarin.

Projekti do të synojë përmbushjen e këtyre objektivave specifike: [a] Të zhvillojë metodologji dhe qasje gjithëpërfshirëse në planifikimin urban, [b] Të sigurojë lidhjen e munguar mes qytetarëve dhe planerëve urban, [c] Të zhvillojë ndjenjën e përkatësisë së qytetarëve për mjedisin rrethues të jetesës, [d] Të përkthejë interesat dhe nevojat e qytetarëve në plane të zbatueshme urbane, [e] Të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të grupeve të disfavorshme dhe të marginalizuara të shoqërisë, [f] Të promovojë qasjen e integruar të planifikimit urban (social, ekonomik, mjedisor dhe kulturor)

Gjatë secilit vit, metodologjia e projektit parasheh realizimin e fokus grupeve me shtatë grupe të komunitetit, aksioneve / performansave publike me qëllime avokimi (iniciativa komunitare), anketimeve me qytetarë të Prizrenit mbi planifikimin urban, debateve publike dhe raporteve specifike për secilin grup të komunitetit. Në pjesën e fundit të vitit, këto raporte do t’i dorëzohen komunës së Prizrenit dhe fillon faza e avokimit për përfshirjen e shqetësimeve dhe nevojave të qytetarëve në planet urbane të komunës.

III. Koncepti i “qytetit gjithëpërfshirës”

Për Ali Madanipour-in, qyteti “ofrohet dhe menaxhohet nga autoritetet publike”, dhe “shfrytëzohet dhe ndahet nga të gjithë anëtarët e bashkësisë”. Ai është “bota e përbashkët institucionale dhe materiale, hapësirë e ndërmjetme që lehtëson bashkëprezencën dhe rregullon marrëdhëniet ndërpersonale”.¹ Si hapësirë që ndahet barabartë nga të gjithë anëtarët e bashkësisë, dhe si produkt i demokracisë, qyteti poashtu përkufizon dhe shtron rregulla të mirësjelljes dhe respektit për tjetrin.

Konceptet e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes janë dy koncepte cilësore që shfrytëzohen shpesh në diskutet e fushës së planifikimit dhe zhvillimit. Programi i UN Habitatit e përkufizon qytetin gjithëpërfshirës si qytet që promovon zhvillimin me drejtësi. Qyteti gjithëpërfshirës “është vendi ku të gjithë, pavarësisht mundësive të tyre ekonomike, racës, gjinisë, etnisë apo fesë, mund të marrin pjesë plotësisht në të gjitha mundësitë shoqërore, ekonomike dhe politike që i ofron qyteti”. Sipas këtij programi drejtësia është një nga tri shtyllat e qëndrueshmërisë, dhe më e rëndësishmja që është thelbësore në krijimin e të ardhmës urbane të qëndrueshme dhe të përbashkët. (UN-Habitat, 2001)

Vizioni i qytetit gjithëpërfshirës përkthehet në ambient fizik përmes projektimit gjithëpërfshirës dhe planifikimit pjesëmarrës. Projektimi gjithëpërfshirës ua mundëson njerëzve nga grupe të ndryshme shoqërore dhe ekonomike që të marrin pjesë në hartim dhe të vlerësojnë projektet. Planifikimi pjesëmarrës është paradigmë e planifikimit urban që mëton përfshirjen e gjithë bashkësisë në proceset strategjike dhe menaxhuese të planifikimit urban. Qasja fillestare të projektimit gjithëpërfshirës është që të binden anëtarët e bashkësisë që të luajnë rol të rëndësishëm në hartimin e strategjive të herëshme dhe planifikimin e projekteve për qytetin e tyre. Me anë të përfshirjes së gjithë bashkësisë, problemet e vërteta, burimi i tyre dhe zgjidhjet potenciale parashtrihen dhe diskutohen në punëtori të ndryshme. Projektet dhe idetë që rrjedhin nga një punë e tillë me bashkësinë zakonisht janë të lidhura me kontekstin, dalin nga nevojat dhe kultura e bashkësisë dhe mjedisi në të cilin ato ekzistojnë. Falë pjesëmarrje të madhe, bashkësia do të kenë një sens të fortë pronësie dhe përkushtimi ndaj projektit.

Në manualin “Qyteti gjithëpërfshirës” Goltsman and Iacofano e paraqesin planifikimin gjithëpërfshirës të qytetit si zgjidhje “të bazuar në politikën e ndjeshme ekonomike, shoqërore, mjedisore dhe kulturore që ua lejojnë të gjithëve të përmirësohen ekonomikisht bashkë me përmirësimin e hapësirës ku jetojnë”. Ata theksojnë se qytetet kanë nevojë për mënyrë planifikimi që e njeh të drejtën e përfshirjes të secilit njeri në proceset zhvillimore: “përmes pjesëmarrjes, njerëzit mund t’i japin formë mjedisit të tyre për t’i përmbushur nevojat e tyre.” Grupet me të prekura zakonisht rrallë përfshihen në proceset planifikuese meqë u mungojnë shkathtësitë, dija dhe informata. Kjo krijon pastaj rrezikun e mospërfshirjes së nevojave të tyre në planifikimin urban, që më tutje pasqyrohet me keqësimin e mjedisit të tyre jetësor. Për t’i adresuar këto problem, autorët e lartpërmendur sugjerojnë procesin e projektimit gjithëpërfshirës të bazuar në tri kategori: funksionalitet (projektim që ngërthen të gjithë tipet e individëve), ndjeshmëri kontekstuale (harmonia me mjedisin rrethues) dhe impakt të drejtësisë për të “zvogëluar impaktin shoqëror dhe njerëzor tek anëtarët më të prekur të shoqërisë”.²

¹ Madanipour, Ali, (2003) *Public and Private Spaces of the City*, Routledge

² Goltsman, S, Iacofano, D, (2007), *The Inclusive City: Innovative Solutions for Buildings, Neighborhoods, and Urban Spaces*, MIG Communications).

IV. Të moshuarit dhe planifikimi urban në Prizren

Infrastruktura fizike dhe shërbimet publike

Shkruar nga, Fisnik Minci

Përmbledhje ekzekutive

Planifikimi urban është një proces dinamik që synon përmirësimin e mirëqenies së njerëzve duke krijuar vendbanime më të përshtatshme, më të shëndetshme, më të barabarta, më efektive dhe më tërheqëse për të tashmen dhe gjeneratat e ardhshme. Planifikimi i tillë i mundëson vendimmarrësve, bizneseve, shoqërisë civile por edhe grupeve të qytetarëve që të luajnë rol të rëndësishëm në krijimin e komuniteteve që përmirësojnë jetesën e njerëzve. Pra, planifikimi i mirë, ndihmon krijimin e komuniteteve që ofrojnë zgjidhje më të mira për atë se ku dhe si duam të jetojmë. Planifikimi i ndihmon komuniteteve që të përfytyrojnë të ardhmen e tyre, duke gjetur baraspeshën e duhur mes zhvillimeve të reja dhe shërbimeve thelbësore, mbrojtjes së mjedisit dhe ndryshimit që sjell risi³.

Madje edhe planifikimi urban për të gjitha grupmoshat është një parim që nuk guxon të shkellet, por që në praktikë planifikuesit shpesh herë nuk i kanë kushtuar rëndësi të domosdoshme grupmoshave të caktuara. Në këtë pikëpamje, të moshuarit si kategori shoqërore kanë nevojë për konsideratë të veçantë gjatë hartimit të politikave, sepse ata kanë kërkesa më specifike në krahasim me grupmoshat e tjera.

Qyteti që krijon ambient miqësor për të moshuarit është qytet gjithëpërfshirës. Duke i marrë për bazë shumëllojshmërinë e nevojave të të moshuarve krijohen dobi edhe për grupmoshat tjera, si fëmijët, të rinjtë, familjet, punëtorët, ndërmarrësit, etj. Qyteti miqësor për të moshuarit mund të ndërtohet vetëm në koordinim me të moshuarit. Ata duhet të jenë pjesë aktive e definimit të prioriteteve dhe projekteve⁴.

Në këtë mënyrë, një vendbanim është vend i mirë vetëm atëherë kur i shërben të gjithë banorëve përgjatë ciklit të tyre jetësor⁵. Planifikimi i mirë urban me gjithëpërfshirje dhe vizion të qartë mund të ndihmojë në jetësimin e këtij qëllimi.

EC Ma Ndryshe duke i parë zhvillimet në këtë sektor në Prizren është angazhuar në stimulimin e konsultimit publik në mënyrë që me pjesëmarrjen qytetare të rinovohen Planet Rregullative Urbane të qytetit, për të sjellë një dinamikë të re të planifikimit të qëndrueshëm, për të balancuar interesat e komunitetit dhe biznesit, por edhe për të ruajtur traditën arkitektonike dhe trashëgiminë kulturore. Për të siguruar gjithëpërfshirjen në procesin e konsultave, kjo organizatë ka përfshirë edhe të moshuarit.

Gjatë takimeve, debateve dhe anketimeve, të moshuarit kanë vënë në pah një mori ankesash, kërkesash, sugjerimesh dhe rekomandimesh kundruall urbanizmit dhe planifikimit hapësinor.

³ Përkufizim i Shoqatës Amerikane të Planifikimit, i publikuar në:

<https://www.planning.org/aboutplanning/whatisplanning.htm>, qasur në nëntor 2014

⁴ "CRITERIA FOR THE ELDERLY PEOPLE CITY? SIMPLIFY THE COMPLEXITY TO ACT IN CONCRETE TERMS", dokument nga Marcello Martinoni, Alma Sartoris, i publikuar në: http://www2.arc.usi.ch/ris_ist_icup_pub_urbaging_02.pdf, qasur në nëntor 2014

⁵ "IMPROVING THE QUALITY OF LIFE OF ELDERLY AND DISABLED PEOPLE IN HUMAN SETTLEMENTS", Libër i burimeve, Vëllimi i parë, UN Habitat, Nairobi, 1993, i publikuar në:

<http://ww2.unhabitat.org/programmes/housingpolicy/documents/HS-284.pdf>, qasur në nëntor 2014

Të gjeturat kryesore:

- Meqë gjatë këtij viti në fokus ka qenë shëndetësia në raport me planifikimin urban, ndër brengat kryesore që janë adresuar nga të moshuarit ka qenë cilësia e shërbimeve mjekësore që marrin, ngase sipas tyre nuk ka trajtim të veçantë për ta. Furnizimi me barna në farmacitë publike është tejet i dobët sipas të moshuarve dhe ata kanë nevojë për lehtësimin e transportit deri tek objektet shëndetësore.
- Ky grup i komunitetit kërkon ndërtimin dhe funksionalizimin e Shtëpisë së Pleqve, Qendrës Kulturore për të Moshuarit dhe krijimin e Muzeut të Mësuesit.
- Të moshuarit janë të bindur se Planet Urbanistike në Prizren nuk po respektohen. Nga komuna është kërkuar që ato objekte që bien ndesh me kriteret urbanistike dhe ambientin e Prizrenit të mos legalizohen, në mënyrë që të ruhet imazhi i qytetit. Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për ndërtim, sipas kësaj kategorie të shoqërisë, është i domosdoshëm dhe për këtë duhet aktivizim i inspektoratit, që duhet të sanksionojë shkelësit e ligjeve. Në të kundërtën, duhet të merren masa ndaj inspektorëve.
- Siguria në trafik ka vazhduar të dominojë si njëra prej brengave kryesore e të moshuarve. Në lidhje me transportin urban është kërkuar që të ketë reformim të linjave dhe kontroll të çmimoreve të taksive.
- Si katër preokupime kryesore të kësaj popullate kanë dalë të jenë: 1) Bllokimi i trotuareve me makina 69.7%, 2) Vendtakimi për pensionistë/hapësira rekreative 51.5%, 3) Ndërtimet pa leje 42.4% dhe 4) Mungesa e hapësirave të gjelbëruara me 33.3%.
- Në hulumtimin me organizata të ndryshme dhe përfaqësues të moshuarve si çështje kryesore janë cekur: 1) Mungesa e vendtakimeve për pensionistë me 97.1%, 2) Mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 47.1% dhe 3) Ndërtimet pa leje me 47.1%.

Rekomandimet kryesore:

- Komuna e Prizrenit duhet të sigurojë kushte jetese që iu përshtaten qytetarëve të të gjitha grupmoshave dhe gjatë planifikimit urban duhet t'i marrë parasysh nevojat e të moshuarve.
- Autoritetet komunale duhet të promovojnë konsultimin publik në të gjitha politikat, duke u përkujdesur që palë e përfshirë të jetë edhe komuniteti i personave të moshuar.
- Të aplikohen praktikat që mundësojnë që kujdesi shëndetësor parësor në nivel komuniteti për të moshuarit të jetë efektiv në promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe për të menaxhuar sëmundjet kronike. Urgjentisht të përmirësohen shërbimet mjekësore për të moshuarit.
- Pushteti lokal i Prizrenit duhet të ndërmarrë hapa drejt themelimit të një komiteti apo trupi këshilldhënës të përbërë nga qytetarët që gëzojnë autoritet në komunitet, në mesin e të cilëve do të kishte numër të theksuar të të moshuarve, të cilët do të shqyrtonin dhe ofronin këshilla rreth politikave të caktuara publike, që prekin kategori të ndryshme të popullatës.
- Organet përgjegjëse lokale duhet të hartojnë dhe të miratojnë një rezolutë që do të promovonte përkrahjen aktive dhe angazhimin drejt një qyteti që do të ketë politika dhe hapësira miqësore ndaj të të moshuarve.
- Komuna e Prizrenit duhet të aktualizojë dhe të fusë në agjendën institucionale projektet për ndërtimin dhe funksionalizimin e Shtëpisë së Pleqve dhe të Qendrës Kulturore për të Moshuarit dhe Muzeut të Mësuesit.

Hyrje

Plakja e popullsisë është njëra prej triumfeve më të mëdha të njerëzimit. Po ashtu, është njëra prej sfidave më të mëdha që shton kërkesat e natyrës ekonomike dhe shoqërore në të gjitha shtetet. Në mbarë botën, përqindja e njerëzve mbi moshën 60 vjeçare është duke u rritur dhe do të vazhdojë të rritet me një shpejtësi më të madhe se cilado grupmoshë tjetër për shkak të rënies së natalitetit dhe

rritjes së jetëgjatësisë. Numri i njerëzve të moshuar mbi moshën 60 vjeçe në botë parashihet që të rritet nga rreth 600 milionë në vitin 2000 në mbi 2 miliardë në vitin 2050⁶.

Personat e moshuar shpesh herë përkufizohen si qytetarë që arrijnë moshën e pensionimit, ndërkohë që mosha e pensionimit ndryshon nga shteti në shtet. Shumë njerëz me të hyra të ulëta, por edhe tregtarë punojnë përtej moshës së pensionimit për arsye të ndryshme. Megjithatë, Plani Ndërkombëtar i Veprimit mbi Plakjen i miratuar nga Asambleja Botërore mbi Plakjen ka aplikuar termin “i moshuar” për personat mbi moshën 60 vjeçare⁷.

Mosha e pensionimit në Kosovë është 65 vjeç. Të dhënat demografike që kanë dalë nga regjistrimi i fundit i popullsisë në Kosovë në vitin 2011, të moshuarit i klasifikon nga mosha 65 vjeçare e tutje. Sipas këtij regjistrimi nga 177.781 banorë të Prizrenit, 11.404 janë të moshuar, ku 6.499 sosh jetojnë në zona urbane dhe 4.905 në ato rurale⁸. Pra, 6.41 për qind të banorëve të Prizrenit janë qytetarë që kanë arritur moshën e pensionimit.

Ky grup i komunitetit për shkak të nevojave që lidhen me moshën kërkon konsideratë të veçantë gjatë hartimit të politikave, sepse të moshuarit kanë nevojë për të hyra adekuate, mundësi të punësimit të dinjitetshëm nëse vendosin që të jenë akoma aktiv dhe qasje të duhur në shërbimet shëndetësore dhe ato sociale, duke përfshirë dhe kujdesin afatgjatë mjekësor.

Madje edhe planifikimi urban për të gjitha grupmoshat është një parim që nuk guxon të shkellet, por që në praktikë planifikuesit shpesh herë nuk i kanë kushtuar rëndësi të domosdoshme grupmoshave të caktuara. Në rast se të moshuarit nuk do të dalloheshin në karakter dhe në lloj nga grupmoshat e tjera, atëherë nuk do të kishte nevojë edhe që të trajtohen si grup i veçantë, që meritojnë konsideratë të veçantë në kontekstin e planifikimit të vendbanimeve të qëndrueshme⁹.

Pra plakja e popullatës dhe urbanizimi kanë qenë kulmi i zhvillimit të suksesshëm njerëzor në shekullin e kaluar. Por, njëkohësisht mbeten sfida shumë të mëdha për këtë shekull.

Për të qenë të qëndrueshme, qytetet duhet të ofrojnë struktura dhe shërbime që i mundësojnë banorëve mirëqenie dhe produktivitet. Të moshuarit kanë nevojë për hapësira jetese përkrahëse, ku mund të përmbushin nevojat fizike dhe sociale që kanë të bëjnë me plakjen¹⁰. Madje kjo domosdoshmëri është njohur edhe si njëra nga tre drejtimet kryesore të Planit Ndërkombëtar të

⁶ “Strengthening Older People’s Rights: Towards a UN Convention”, Publikim i përgatitur nga nëntë organizata të ndryshme, i publikuar në: <http://social.un.org/ageing-working-group/documents/Coalition%20to%20Strengthen%20the%20Rights%20of%20Older%20People.pdf>, qasur në nëntor 2014

⁷ “IMPROVING THE QUALITY OF LIFE OF ELDERLY AND DISABLED PEOPLE IN HUMAN SETTLEMENTS”, Libër i burimeve, Vëllimi i parë, UN Habitat, Nairobi, 1993, i publikuar në: <http://ww2.unhabitat.org/programmes/housingpolicy/documents/HS-284.pdf>, qasur në nëntor 2014

⁸ Regjistrimi i Popullsisë, Ekonomive Familjare dhe Banesave në Kosovë, 2011, Të dhënat demografike sipas komunave, ASK, i publikuar në: <http://ask.rks.gov.net/rekos2011/repository/docs/Te%20dhenat%20kryesore%20demografike%20sipas%20komunave.pdf>, qasur në nëntor 2014

⁹ “Planning and an aging population”, Raport nga Zyrtarët e Shoqatës Amerikane të Planifikimit, i botuar në vitin 1961, i publikuar në <https://www.planning.org/pas/at60/pdf/report148.pdf>, qasur në nëntor 2014

¹⁰ “Global Age-friendly Cities”, Udhëzues i përgatitur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, i publikuar në: http://www.who.int/ageing/publications/Global_age_friendly_cities_Guide_English.pdf, qasur në nëntor 2014

Veprimi të Madridit mbi Plakjen e që është miratuar edhe nga Kombet e Bashkuara¹¹. Prandaj bërja e qytetit më miqësor ndaj të moshuarve nuk është vetëm një nevojë, por edhe reagim logjik për të promovuar mirëqenien dhe kontributin e banorëve më të moshuar¹².

Siç është cekur edhe në Deklaratën mbi Plakjen të Braslias të Organizatës Botërore të Shëndetësisë, “të moshuarit e shëndoshë janë një pasuri për familjet e tyre, komunitetin dhe ekonominë”¹³. Për ta realizuar këtë objektiv, duhen shërbime të qasshme dhe cilësore shëndetësore për të moshuarit, në përputhje me specifikat që ka kjo kategori e shoqërisë. Parakusht për këtë është planifikimi i duhur, i cili do t’iu mundësonte të moshuarve marrjen e shërbimeve të domosdoshme shëndetësore në përputhje me kërkesat e tyre, por edhe krijimin e ambientit të mirë jetësor, me hapësira adekuatë të banimit dhe publike që do të ndikonin në vlerësimin, fuqizimin dhe përkrahjen e të moshuarve dhe cilësinë e jetesës së tyre.

Një shembull të mirë në këtë drejtim ka dhënë qyteti i Otavës (Kanadë), i cili në vitin 2009 ka nisur procesin e hartimit të Planit për të Moshuarit, derisa në vitin 2011 e ka përcaktuar këtë Plan të Veprimit (2012-2014) si njërin prej prioriteteve strategjike të pushtetit lokal, duke nisur zbatimin e veprimeve konkrete të përshkruara në plan. Plani për të Moshuarit i Otavas ka qenë produkt i hulumtimeve të gjata dhe dialogut të hapur me komunitetin. Plani ka mbuluar shërbimet kryesore që janë kompetencë e komunës si infrastruktura, ndërtesat dhe hapësirat publike, transporti, aktivitetet rekreative, shëndetësia dhe mirëqenia sociale si dhe shërbime të tjera përkrahëse, përmes të cilave është intervenuar në përmirësimin konkret të cilësisë së jetesës së të moshuarve¹⁴.

Situata aktuale

Për dallim prej praktikave që përdoren në shtetet e zhvilluara, në komunën e Prizrenit përfshirja e të moshuarve në planifikim urban vazhdon që të jetë e ulët, madje që shkon deri në nivele shqetësuese, ngase nëse përjashtohen nismat e shoqërisë civile, atëherë del se institucionet as që e kanë në agjendë përfshirjen e kësaj kategorie gjatë hartimit të politikave publike të kësaj fushe. Pasi që pjesëtarët e kësaj kategorie nuk janë përfshirë në konsultimet publike lidhur me planet urbane të komunës së Prizrenit, atëherë edhe shumë sfida me të cilat ata ballafaqohen mbeten ende të pazgjidhura.

Vlen të përkujtohet se autoritetet e planifikimit hapësinor para se t’i finalizojnë të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor përmes njoftimit publik duhet t’i ftojnë qytetarët dhe të zhvillojnë konsultime dhe shqyrtime publike. Në të njëjtën kohë duhet që të sigurojnë pjesëmarrjen e publikut gjatë hartimit dhe zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor¹⁵.

Udhëzimi Administrativ 54/2005 i MMPH-së për zbatimin e ligjit për planifikim hapësinor lidhur me procedurën e shqyrtimit publik për planet hapësinore dhe urbanistike thekson se “duke promovuar

¹¹ “Report of the Second World Assembly on Ageing”, Madrid, 8–12 prill 2002, nga Kombet e Bashkuara, publikuar në http://www.un.org/en/ga/search/view_doc.asp?symbol=A/CONF.197/9, qasur në nëntor 2014

¹² “Global Age-friendly Cities”, Udhëzues i përgatitur nga Organizata Botërore e Shëndetësisë, i publikuar në: http://www.who.int/ageing/publications/Global_age_friendly_cities_Guide_English.pdf, qasur në nëntor 2014

¹³ “Brasilia Declaration on Ageing”. Organizata Botërore e Shëndetësisë, 1997, publikuar në: http://www.un.org/esa/socdev/ageing/documents/regional_review/Declaracion_Brasilia.pdf, qasur në nëntor 2014

¹⁴ “OLDER ADULT PLAN 2012-2014”, Plani i Veprimit i qytetit të Otavës, publikuar në: <https://ottawa.ca/sites/default/files/migrated/files/cap290801.pdf>, qasur në nëntor 2014

¹⁵ Ligji për Planifikimin Hapësinor, Neni 20, publikuar në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/Ligji%20per%20planifikimin%20hapesinor.pdf>, qasur në nëntor 2014

qeverisjen e mirë, Ministria dhe Komunitat do të marrin parasysh nevojat e veçanta të PAK-ve, të moshuarve, grave, minoriteteve dhe të rinjve¹⁶ dhe se do të inkurajojnë pjesëmarrjen transparente publike.

Ndërkaq, komunitat janë të obliguara t'i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik, siç rregullohet me statutin e komunës¹⁷. Po ashtu Kuvendi i Komunës, komitetet dhe komisionet e tij, para miratimit të rregulloreve komunale duhet të mbajnë konsultime publike, duke i ofruar publikut informata të nevojshme për propozime¹⁸.

Gjatë këtij viti, Komuna e Prizrenit ka organizuar disa debate publike, në të cilat ka dështuar që të marrë masa adekuate për t'i përmbushur kërkesat ligjore të konsultimit publik në raport me grupin e të moshuarve. Komuna në këto debate publike i ka ftuar qytetarët për pjesëmarrje me shpallje publike, mirëpo nuk ka bërë përpjekje për të siguruar pjesëmarrjen dhe dialogun me publikun, e aq më pak me grupet e veçanta të komunitetit, siç është ai i të moshuarve.

Të moshuarit, të mbledhur nën ombrellën e Organizatës Komunale të Pensionistëve dhe Invalidëve të Punës dhe Shoqatës së Veteranëve të Arsimit, kanë shprehur gatishmërinë që të marrin pjesë në konsultimet publike, që organizohen nga autoritetet, qoftë në hapësirat e komunës qoftë në ambientet tjera, në mënyrë që të adresojnë propozimet dhe shqetësimet e tyre, me qëllim të kapërcimit të vështirësive urbanistike, me të cilat ballafaqohen në jetën e përditshme.

Gjatë periudhës dyvjeçare, "EC Ma Ndryshe" i ka kushtuar rëndësi përfshirjes së të moshuarve në planifikimin urban, me ç'rast krahas organizimit të fokus grupeve, debateve, anketave e hulumtimeve ka ftuar të moshuarit përmes sms-ve dhe ftesave personale në të gjitha debatet publike të organizuara nga Komuna e Prizrenit, që kanë pas të bëjnë me politika të ndryshme të publike, nga buxheti e deri te planet rregullative.

Të gjeturat

EC Ma Ndryshe, në kuadër të projektit "QYTETI GJITHËPËRFSHIRËS – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren", gjatë vitit 2014, ka organizuar dy fokus grupe dhe një debat publik me komunitetin e personave të moshuar, ndërkohë që ata i ka përfshirë edhe në hulumtimin përmes anketimit, që ka shërbyer si bazë për hartimin e analizës mbi preokupimet e qytetarëve në lidhje me çështjet urbanistike në qytetin e Prizrenit. Të gjeturat në kuadër të këtyre aktiviteteve kanë shpalosur sfidat, problemet dhe kërkesat me të cilat ballafaqohen të moshuarit në raport me urbanizmin dhe planifikimin hapësinor.

Shqyrtimi i sfidave të urbanizmit të Prizrenit në konsultat me të moshuarit gjatë këtij viti në fokus të veçantë ka pasur shëndetësinë. Të moshuarit janë deklaruar se gëzojnë përkrahje nga institucionet vendore dhe paqeruajtësit turq për kontrolle sistematike rutinore. Megjithatë, në këtë pikë ka pasur ndasi në mendime, ngase është thënë se kontrollet rutinore nuk mjaftojnë për të moshuarit, pasi që ata

¹⁶ Udhëzimi Administrativ 54/2005 i MMPH, Neni 3, paragrafi 4, publikuar në: http://mmp-h-rks.org/repository/docs/UA_54_2005.pdf, qasur në nëntor 2014

¹⁷ Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Neni 68, publikuar në: http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf, qasur në nëntor 2014

¹⁸ Statuti i Komunës së Prizrenit, Neni 91, publikuar në: http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/Home/satuti_komunes_tetor_2008_04_12.pdf.aspx, qasur në nëntor 2014

përballen me probleme më të theksuara shëndetësore. Të moshuarit kanë kërkuar nga autoritetet që të gjejnë zgjidhje të qëndrueshme për këto halle. Në përgjithësi janë pajtuar se shërbimi parësor mjekësor, në aspektin hapësinor është afër dhe se komuna në këtë drejtim ka përmbushur shumicën e obligimeve, me përjashtim të ndonjë lokaliteti të caktuar. Por kanë shprehur brengë sa i përket cilësisë së shërbimeve që marrin, ngase sipas tyre nuk ka trajtim të veçantë për të moshuarit dhe se ata futen në 'një thes' me moshat më të reja. Gjithashtu kanë bërë të ditur se furnizimi me barna në farmacitë publike është tejet i dobët, prandaj dhe të moshuarit janë të detyruar që shpesh barnat t'i paguajnë nga xhepi. Kanë kërkuar edhe lehtësimin e transportit deri tek objektet shëndetësore.

Lidhur me shëndetin dhe mirëqenien e tyre, të moshuarit kanë kërkuar që institucionet të punojnë në gjetjen e fondeve për ndërtimin dhe funksionalizimin e Shtëpisë së Pleqve, ku do të gjenin strehë të moshuarit e vetmuar, sikurse edhe Qendrën Kulturorë për të Moshuarit, që do të shërbente për takimet ditore. Ndërsa përfaqësues të Shoqatës së Veteranëve të Arsimit, që prej kohësh kanë mbetur pa zyrë dhe përkrahje, kanë propozuar krijimin e Muzeut të Mësuesit (në shtëpinë e mësuesit Lazër Lumezi), i cili brenda vetes do të kishte kthina për takimet ditore të të moshuarve.

Kërkesë tjetër nga të moshuarit ka qenë themelimi i një qendre për hulumtime shkencore në shëndetësi, që do të përbëhej nga njohës eminentë të shkencave të mjekësisë. Sipas tyre, kjo qendër në sajë të hulumtimeve do të mund të ndihmonte komunën gjatë hartimit të programeve zhvillimore.

Në grupin e të moshuarve ka pasur edhe diskutime të tjera. Gjatë fokus grupeve dhe debatit është cekur se Planet Urbanistike në Prizren nuk po respektohen. Sipas tyre, edhe pse Plani Urbanistik parasheh ndërtime të objekteve me etazhitet P+5, në realitet lejohen ndërtime me më shumë etazhe. Në të njëjtën kohë, sipas të moshuarve, këto objekte me tejkalime në etazhitet nuk e respektojnë proporcionin 40 për qind ndërtesë dhe 60 për qind ambient të gjelbër, derisa për parkingje as që mund të flitet. Është kërkuar nga DUPH-ja dhe DI-ja veprim më rigoroz dhe ato objekte që bien ndesh me kriteret urbanistike dhe ambientin e Prizrenit të mos legalizohen, në mënyrë që të ruhet imazhi i qytetit. Zbatimi i ligjeve dhe rregulloreve për ndërtim sipas kësaj kategorie të shoqërisë është i domosdoshëm dhe për këtë duhet aktivizim i inspektoratit, që duhet të sanksionojë shkelësit e ligjeve. Në të kundërtën, në rast të mos veprimit, atëherë, sipas të moshuarve, duhet të penalizohen edhe vetë inspektorët.

Vërejtja tjetër ka pas të bëjë me objektet pa fasada që qëndrojnë ashtu me vite të tëra, edhe pas përfundimit të punimeve ndërtimore, ndërkohë që ka pasur edhe kërkesa për fasadimin e objekteve të banimit kolektiv të ndërtuara dekada më parë.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, të moshuarit kanë paraqitur disa shqetësime të natyrave të ndryshme. Siguria në trafik ka dominuar si brengë kryesore. Konkretisht është përmendur rruga në afërsi të Shtëpisë së Kulturës, ku këmbësorët e kanë të vështirë të qarkullojnë, te një kthesë përballë këtij objekti. Po ashtu është përmendur rruga Faik Emrushit, ku këmbësorët përballen me probleme të njëjta. Pastaj parkimi i veturave në vendet e palejuara, veçmas trotuare është theksuar si çështje shqetësuese. Edhe bllokimi i trotuareve me tavolina të kafiterive është vlerësuar si veprim i shëmtuar, për të cilin duhet të veprojë Inspektorati i komunës. Në aspektin e rritjes së sigurisë në trafik për këmbësorët është kërkuar angazhim më i shtuar edhe nga Policia. Është apeluar për vendosjen e shenjave të komunikacionit. Gjithashtu është kërkuar që të bëhet një lidhje mes transiteve, në mënyrë që të eliminohen kamionët dhe autobusët nga rrugët qendrore të qytetit.

Në lidhje me transportin urban është kërkuar që të ketë reformim, të linjave, ngase përshkrimi qarkor i qytetit nuk përputhet me nevojat e qytetarëve. Gjithashtu është kërkuar që te taksitë të bëhet kontrollimi i çmimore në mënyrë institucionale.

Të moshuarit në kuadër të diskutimeve edhe një herë janë shprehur kundër propozimit për ndërtimin e shkallëve lëvizëse për në Kalanë e Prizrenit, pasi që sipas tyre kjo do të dëmtonte kontekstin historik të këtij monumenti dhe kanë bërë thirrje që të riparohen rrugët ekzistuese që çojnë në Kala.

Po ashtu, të moshuarit kanë kërkuar nga autoritetet që gjatë planifikimit të projekteve të parashohin edhe krijimin e një shtegu për biçikleta, sikurse edhe intervenimin në riparimin e ndriçimit publik. Po ashtu kanë kërkuar ndërtim të çerdheve publike dhe furnizim të rregullt me ujë.

Ndërkaq grupi i të moshuarve është përfshirë edhe në hulumtimin me anketim, me ç'rast nga 250 të intervistuar 12.9 për qind kanë qenë personat mbi moshën 65 vjeçare.

Në përgjithësi analiza e të dhënave të anketimit tregon se katër çështjet kryesore për qytetarët e Prizrenit janë: 1) Bllokimi i trotuareve me makina 64.3%, 2) Ndërtimet pa leje 44.6%, 3) Mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit 41.8% dhe 4) Shkatërrimi i Qendrës Historike të Prizrenit me 35.3%.

Në këtë hulumtim, nga intervistat me personat mbi moshën 65 vjeçare si katër preokupime kryesore të kësaj popullate kanë dalë të jenë: 1) Bllokimi i trotuareve me makina 69.7%, 2) Vendtakimi për pensionistë/hapësira rekreative 51.5%, 3) Ndërtimet pa leje 42.4% dhe 4) Mungesa e hapësirave të gjelbëruara me 33.3%. Çështje tjera të identifikuar janë mungesa e mirëmbajtjes së hapësirave publike, ndërtimet e larta brenda qytetit, mungesa e ndriçimit publik, qasja në institucione, gjendja e parqeve publike dhe mungesa e lidhjeve të transportit.

Në hulumtimin me organizata të ndryshme dhe përfaqësues të moshuarve janë intervistuar 34 pensionistë dhe si çështje kryesore të përmendura nga ata kanë qenë: 1) Mungesa e vendtakimeve për pensionistë me 97.1%, 2) Mungesa e mirëmbajtjes së trotuareve gjatë dimrit me 47.1% dhe 3) Ndërtimet pa leje me 47.1%. Çështje të tjera të identifikuar janë bllokimi i trotuareve me makina, ndërtimet e larta brenda në qytet, hapësirat e gjelbëruara, mungesa e ndriçimit publik, parqet publike, mungesa e lidhjeve të transportit dhe qasja në institucionet shëndetësore.

Rekomandimet

Rekomandimi 1: Komuna e Prizrenit duhet të sigurojë kushte jetese që i përshtaten qytetarëve të të gjitha grupmoshave. Gjatë planifikimit urban duhet t'iu kushtojë kujdes të veçantë nevojave të të moshuarve dhe ato t'i përkthejë në veprime konkrete gjatë zbatimit të të gjitha projekteve publike.

Rekomandimi 2: Autoritetet komunale përgjegjëse për planifikimin hapësinor e urban, por edhe dikasteret e tjera duhet të promovojnë konsultimin publik, që ngërthen në vete edhe mendimin strategjik, hulumtimet, analizat, propozimet, etj, që vijnë nga shoqëria civile dhe bizneset, duke u përkujdesur që palë e përfshirë të jetë edhe komuniteti i personave të moshuar.

Rekomandimi 3: Pushteti lokal i Prizrenit të ndërmarrë hapa drejt themelimit të një komiteti apo trupi këshilldhënës të përbërë nga qytetarët që gëzojnë autoritet në komunitet, në mesin e të cilëve do të

kishte numër të theksuar të të moshuarve, të cilët do të shqyrtonin dhe ofronin këshilla rreth politikave të caktuara publike, që prekin kategori të ndryshme të popullatës.

Rekomandimi 4: Organet përgjegjëse lokale të hartojnë dhe të miratojnë një rezolutë, që do të promovonte përkrahjen aktive dhe angazhimin drejt një qyteti që do të ketë politika dhe hapësira miqësore ndaj të të moshuarve.

Rekomandimi 5: Në konsultim me të gjithë akterët shoqërorë, pushteti lokal i Prizrenit të hartojë një plan të veprimit që do të ofronte përgjigje në mënyrë të strukturuar për të gjitha çështjet e identifikuar nga të moshuarit. Plani i veprimit duhet të publikohet dhe aktivitetet e realizuara duhet të përcillen bashkë me rezultatet që ato i sjellin komunitetit të të moshuarve.

Rekomandimi 6: Komuna e Prizrenit të aktualizojë dhe të fusë në agjendën institucionale projektet për ndërtimin dhe funksionalizimin e Shtëpisë së Pleqve dhe të Qendrës Kulturore për të Moshuarit. Të ndajë fonde nga buxheti komunal apo edhe të gjejë donatorë përkatës. Paraprakisht, të krijojë një ekip ekspertësh, që në konsulta me komunitetin e të moshuarve iu ndihmojnë organeve përgjegjëse komunale në marrjen e vendimit të duhur lidhur me lokacionin për këto dy objekte të rëndësishme për të moshuarit. Gjithashtu të shqyrtohet mundësia për adoptimin e shtëpisë së Lazër Lumezit në “Muze të Mësuesit”, brenda të cilit do të kishte kthina për takimet ditore të të moshuarve.

Rekomandimi 7: Të ndërmerren masa urgjente për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve shëndetësore që ofrohen për të moshuarit, duke marrë parasysh specifikat që i ka kjo kategori shoqërore. Gjithashtu të ofrohen lehtësira për transportin deri te objektet shëndetësore. Furnizimi me barna në farmacitë publike të realizohet konform kërkesave ligjore të të moshuarve.

Rekomandimi 8: Të aplikohen praktikat që mundësojnë që kujdesi shëndetësor parësor në nivel komuniteti për të moshuarit të jetë efektiv në promovimin e shëndetit, parandalimin e sëmundjeve dhe për të menaxhuar sëmundjet kronike.

Rekomandimi 9: Të shqyrtohen mundësitë që në koordinim me nivelin qendror të themelohet një qendër për hulumtime shkencore në shëndetësi, që do të përbëhej nga njohës eminentë të shkencave të mjekësisë, e cila do të ndihmonte komunën gjatë hartimit të programeve zhvillimore. Në kuadër të universiteteve publike të aftësohen kuadrot për sigurime pensionale dhe shëndetësore.

Rekomandimi 10: Të ndërmerren masat e duhura që të gjitha projektet urbane që zbatohen në komunën e Prizrenit të sigurojnë se hapësirat e jashtme dhe të brendshme publike janë të këndshme, të sigurta dhe të qasshme për të moshuarit.

Rekomandimi 11: Të ketë vëmendje të posaçme që ndërtesat e banimit të jenë të dizajnuara në mënyrë të përshtatshme edhe për të moshuarit. Fasadat e ndërtesave të vjetra kolektive të rinovohen. Objektet private të obligohen që të fasadohen.

Rekomandimi 12: Rrugët dhe trotualet të jenë të qasshme dhe të mirëmbajtura në çdo stinë të vitit, në mënyrë që t’i mundësohet lëvizja e lirë dhe qarkullimi i sigurt në trafik të moshuarve. Të ndërmerren masa adekuate për rritjen e sigurisë në trafik brenda qytetit të Prizrenit. Të planifikohet krijimi i shtigjeve për biçikleta.

Rekomandimi 13: Të shqyrtohen mundësitë e reformimit të linjave të transportit urban për ta përshtatur atë me nevojat e përditshme të qytetarëve të Prizrenit. Te taksitë të bëhet kontrollimi i çmimores në mënyrë institucionale.

Rekomandimi 14: DUPH-ja dhe DI-ja të veprojnë më rigorozisht në zbatim të ligjit. Ato objekte që bien ndesh me kriteret urbanistike dhe ambientin e Prizrenit të mos legalizohen, në mënyrë që të ruhet imazhi i qytetit historik. Në rast të mos veprimi të penalizohen edhe vetë inspektorët.

Rekomandimi 15: Komuna duhet të angazhohet që nga rritja e të hyrave vetanake të krijojë Fondin e Zhvillimit Urbanistik të qytetit të Prizrenit, i cili do të trajtonte çështjet prioritare të planifikimit urban në tërë territorin e komunës.

V. Gratë dhe planifikimi urban në Prizren

Gratë e punësuar

Shkruar nga, Rozafa Basha

Përmbledhje ekzekutive

Qytetet kanë mundësinë për të ofruar diçka për të gjithë, vetëm sepse dhe vetëm atëherë kur krijohen nga të gjithë. Jane Jacobs¹⁹

Qytetet duhet të prodhohen duke pasur parasysh parimin e barazisë dhe drejtësisë për të gjithë dhe kjo nënkupton se duhet të jenë vende të qasshme, të krijuara dhe të menaxhuara përmes proceseve gjithëpërfshirëse. Pjesëmarrja qytetare është komponenta thelbësore e proceseve gjithëpërfshirëse, e cila ia mundëson qytetarit që të kontribuojë në vendimmarrje për qytetin. Kur flasim për vendimet që merren gjatë procesit të planifikimit të qytetit, në një proces gjithëpërfshirës të planifikimit, krahas ekspertëve të fushës, janë pikërisht qytetarët jo-ekspertë që duhet të përfshihen, meqë një qytet popullohet nga banorë jo-ekspertë, të cilët, me përvojat e përditshmërisë, mund të kontribuojnë në identifikimin e problemeve dhe gjetjen e zgjidhjeve në qytet.²⁰

Në shoqëritë demokratike presim që zëri i qytetarit të përfaqësohet në proceset e vendimmarrjes për qytetin përmes përfaqësuesve të zgjedhur në këshillat e qytetit. Në realitet, këta përfaqësues në të shumtën e rasteve nuk e përfaqësojnë zërin e grupeve të marginalizuara, të cilat janë jashtë proceseve politike. Për këtë arsye, duhet të krijohen mundësitë që qytetarët të kontribuojnë dhe të komunikojnë aktivisht që t'i kthejnë proceset e ndryshimeve urbane në favor të përmirësimit të jetës së tyre në qytet. Për më shumë, është e nevojshme që të emancipohet një qytetari aktive, përkatësisht një qytetar aktivist²¹, i cili, më parë se të presë prej institucioneve që ta bëjnë ndryshimin, me përkushtimin që e ka ndaj komunitetit dhe mjedisit urban, e udhëheq ndryshimin në mënyrë të pavarur dhe e shtyn komunitetin të përfshihet aktivisht në proceset vendimmarrëse.²²

Grupet e marginalizuara, që në shumicën e rasteve janë komunitete pa përfaqësim, apo me përfaqësim simbolik politik, ekonomik, por edhe kulturor, janë shpeshherë ata qytetarë të cilët jeta e përditshme i lidh për hapësirën/vendin që e jetojnë dhe të cilët më së shumti e ndjejnë padrejtësinë, barrën dhe gabimet e vendimeve të marra në lidhje me hapësirën urbane që e jetojnë.

Përkundër ekzistimit të legjislacionit, i cili mes tjerash mbron dhe vendos barazinë gjinore, si dhe i siguron mundësitë e barabarta për pjesëmarrje të të dy gjinive në zhvillimin politik, ekonomik, social dhe kulturor, gratë në Kosovë vazhdojnë të jenë me përfaqësim simbolik në proceset vendimmarrëse në qeverisjen urbane. Prania e gruas ëshë gati se e padukshme edhe në diskutimet e komunës me qytetarë, meqë në emër të saj flet një burrë i familjes apo i lagjes. Sa mund t'i nxjerrë në pah një përfaqësim i tillë nevojat dhe problemet e përditshmërisë së gruas në hapësirën urbane? Qytetet që sot i jetojmë janë

¹⁹ Jacobs, J., *The Death and Life of Great American City*, fq 238, Random House, New York, 1961, cituar nga Ellin Nan, *Good Urbanism – Six Steps to Creating Prosperous Places*, fq. 33, IslandPress, Washington, 2013 (Amazon Kindle edition)

²⁰ Urban trends, BMW Guggenheimlab, <http://www.bmwguggenheimlab.org/100urbantrends/#!/new-york-city>, (qasur më 10.12.2014, ora 14:00)

²¹ Po aty.

²² Po aty.

përfaqësim i supozimeve të rrënjësura thellë mbi rolin e gruas në shoqëri. Atyre iu është dhënë formë nga sistemi i planifikimit urban dhe fuqive vendimmarrëse të mbizotëruara nga profesionistë burra²³. Janë pak gra që janë në pozitë të kontribuojnë në qeverisjen urbane. Akterët kryesorë në qeverisjen lokale lidhen me ‘elitat’ e qeverisë dhe akademisë, me konsulentët, media dhe biznes. Pikërisht ky lloj partneriteti iu jep formë hapësirave të qytetit²⁴, dhe i ngre barrierat me të cilat përballen gratë përditë.

Ky raport përmbledh nevojat dhe pengesat në përditshmërinë e gruas në hapësirën urbane të Prizrenit, si dhe mëton të rekomandojë zgjidhje për përmirësimin e saj. Raporti është prodhim i diskutimeve të dy fokus grupeve dhe të një debati me gra të punësuar dhe aktiviste për të drejta të grave të qytetit të Prizrenit, të mbajtura këtë vit, në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” të mbështetur nga Olof Palme International Center, Suedi.

Hyrje

Burrat dhe gratë e përjetojnë qytetin ndryshe në raport me banimin, përdorimin e transportit, punësueshmërinë dhe përgjegjësitë mbi strehimin dhe kujdesin shtëpiak²⁵. Për shkak të një ndarjeje gjinore pothuajse universale të punës, gratë janë ato që marrin, në shumicën e rasteve, barrën e kujdesit dhe detyrave riprodhuese në familje dhe në komunitet.

Sipas Helen Jarvis, qytetet funksionojnë si hapësira themelore të prodhimit, konsumit dhe riprodhimit të normave gjinore dhe identitare²⁶. Njëkohësisht, qytetet janë vetë të formësuara nga personifikimet gjinore dhe realitetet sociale të rutinave të përditshme – në shtëpi, në publik dhe gjatë lëvizjes.²⁷

Qytetet që sot i jetojmë janë përfaqësim i supozimeve të rrënjësura thellë mbi rolin e gruas në shoqëri. Atyre iu është dhënë formë nga sistemi i planifikimit urban dhe fuqive vendimmarrëse të mbizotëruara nga profesionistë meshkuj. Janë pak gra që janë në pozitë të kontribuojnë në qeverisjen urbane. Akterët kryesorë në qeverisjen lokale lidhen me ‘elitat’ e qeverisë, akademisë, konsulentët, media dhe biznes. Pikërisht ky lloj partneriteti iu jep formë hapësirave të qytetit.²⁸

Sipas Dolores Hayden, botëkuptimi se “vendi i gruas është në shtëpi” ka qenë një nga parimet kryesore të projektimit arkitektonik dhe planifikimit urban në shekullin XX në SHBA²⁹. Nuk ishte ndryshe qasja në planifikim urban as në Europë. Në SHBA, kjo qasje prodhoi strukturën karakteristike

²³ Greed, C. Planning the Non-sexist City: the Eurofem Initiative and Beyond, <http://www.gendersite.org/case-studies/planning-the-non-sexist-city-the-eurofem-initiative-and-beyond.html>, (qasur më 10.12.2014, në ora 14:02)

²⁴ Jarvis, H. with Cloke, J., Kantor, P., Cities and Gender, Kindle loc. 4495, Routledge critical introductions to urbanism and the city, Routledge, New York, 2009 (Amazon Kindle edition)

²⁵ Jarvis, H. with Cloke, J., Kantor, P., Cities and Gender, Kindle loc. 17, Routledge critical introductions to urbanism and the city, Routledge, New York, 2009 (Amazon Kindle edition)

²⁶ Jarvis, H. with Cloke, J., Kantor, P., Cities and Gender, Kindle loc. 206, Routledge critical introductions to urbanism and the city, Routledge, New York, 2009 (Amazon Kindle edition)

²⁷ Po aty.

²⁸ Jarvis, H. with Cloke, J., Kantor, P., Cities and Gender, Kindle loc. 306, Routledge critical introductions to urbanism and the city, Routledge, New York, 2009 (Amazon Kindle edition)

²⁹ Hayden, D., What would a Non-Sexist City be like? fq. 170, Speculations on Housing, Urban Design and Human Work, Signs, Vol. 5, nr. 3, pp. 170 – 187, Supplement, Women and American City, (spring 1980), <file:///C:/Users/User/Desktop/Hayden%20-%20Non-Sexist%20City.pdf>

të qytetit, të përbërë nga bërthama e qytetit me vende të punës, që ishte destinacion kryekëput i burrit dhe zonat e periferive, kryesisht zona banimi si domene ku “gruaja rrinte në shtëpi” dhe kryente obligimet e riprodhimit dhe kujdesit – punën e papaguar. Në Europën e shekullit XX, qytete të tëra u zgjeruan sipas parimeve të zonimit të bazuar në planifikimin modernist, ku lagjet e banimit u planifikuan larg zonave të punës dhe një sistem i ndërlikuar transporti ua mundësonte burrave që i ngisnin makinat të arrinin me kohë në punë. Kjo mënyrë e planifikimit, që për arsyetim kishte shëndetin publik dhe efikasitetin, në të vërtetë iu shkonte shumë për shtati botëkuptimeve tradicionale dhe historike mbi “vendin e duhur” të gruas në qytetin e burrave³⁰, që është e ndarë dhe “në shtëpi”. Sot shumë gra punojnë dhe krahas punës profesionale ato vazhdojnë të bëjnë punën e kujdesit ndaj fëmijës, shtëpisë dhe blerjet. Zonimi modernist i qytetit iu shkon ndesh modeleve të lëvizjes dhe nevojave të gruas së punësuar.

Disa urbaniste feministe pajtohen se vizioni i një qyteti, që do të ishte më i përshtatshëm për nevojat e grave, është qyteti jo-gjinor, apo qyteti “i jetës së përditshme”. Ky qytet do të ishte qytet i distancave të shkurtra, me shpërndarje të gjerë të shërbimeve të shumta, dyqaneve, shkollave dhe çerdheve lokale. Si i tillë do ta zvogëlonte nevojën për udhëtim dhe do të ndihmonte në krijimin e qyteteve të qëndrueshme, të qasshme dhe të drejta. Në mikro nivel, ky qytet do t’ua mundësonte grave dhe burrave të udhëtojnë me transport publik, të ecin në këmbë dhe të udhëtojnë me biçikletë; transporti publik do të ishte më i qasshëm dhe hapësira publike nuk do të kishte barriera fizike as për prindër që shtyejnë karrocet me fëmijë, e as për persona me nevoja të veçanta, që lëvizin me ndihmesa, etj.³¹

Për ta krijuar një qytet jo-gjinor, politikat e planifikimit duhet të rishikohen nga perspektiva gjinore dhe jo vetëm ato që ndërlidhen me kujdesin për fëmijën, apo sigurinë personale të gruas, por edhe politikat që kanë të bëjnë me planifikimin e transportit, punësimit, sportit, kulturës, të cilat deri vonë janë trajtuar si çështje ekskluzivisht burrash.³²

Sot, në epokën e shqetësimeve që lidhen me ndotjen e mjedisit, burimet në zhdukje të energjisë, numrit të madh të popullsisë urbane si dhe problemeve ekonomike dhe sociale që burojnë nga to, por edhe të ardhmen jo fort të ndritshme që tanë këto zhvillime po na e projektojnë, ideja mbizotërouese, në të cilën duket se të gjithë kërkojnë shpëtim, është ajo që përmbledhet brenda nocionit të qëndrueshmërisë. Vizioni i qytetit jo-gjinor, apo qytetit të jetës së përditshme, i cili në fokus të veçantë ka qasjen dhe përfaqësimin e të drejtave të të gjithëve përmes proceseve gjithpërfshirëse, por edhe promovimin e hapësirës urbane më të koncentruar dhe me përmbajtje mikste, si dhe të transportit publik dhe mënyrave të shëndetshme të mobilitetit, duket se është në përputhje të plotë me frymën e zhvillimit të qëndrueshëm – ndërsa gratë janë promovuese të tij.

Situata aktuale

Përkundër ekzistimit të legjislacionit, i cili mes tjerash mbron dhe vendos barazinë gjinore, si dhe i siguron mundësitë e barabarta për pjesëmarrje të të dy gjinive në zhvillimin politik, ekonomik, social dhe kulturor, gratë në Kosovë vazhdojnë të jenë me përfaqësim simbolik në proceset vendimmarrëse në qeverisje urbane. Sipas nenit 1.3 të ligjit për barazi gjinore nr. 2004/02, garantohet mënjanimi i të gjitha

³⁰ Greed, C. Planning the Non-sexist City: the Eurofem Initiative and Beyond, <http://www.gendersite.org/case-studies/planning-the-non-sexist-city-the-eurofem-initiative-and-beyond.html>,)qasur më 10.12.2014, në ora 14:00)

³¹ Po aty.

³² Po aty.

pengesave për të realizuar barazinë gjinore, që nënkupton pjesëmarrjen e barabartë (e cila konsiderohet si e tillë, kur pjesëmarrja e një gjinie është së paku 40%) e grave dhe burrave në organet e të gjitha nivelet e pushtetit ligjvënës, ekzekutiv, gjyqësor dhe institucionet publike.

Kur flasim për pjesëmarrjem në nivel lokal, sipas ligjit të lartpërmendur, zyrat lokale për barazi gjinore duhet të hartojnë politika për të promovuar barazinë gjinore në pjesëmarrje qytetare, të ndihmojnë përmes masave dhe aktiviteteve të ndryshme për të krijuar mundësi të barabarta për të dy gjinitë në punësim, arsim, përfaqësim politik, ekonomik dhe kulturor. Një plan të tillë për barazi gjinore (2012 – 2014) ka hartuar edhe Komuna e Prizrenit, sipas të cilit Komuna obligohet që të ketë qasje afirmative në punësimin e grave, në ofrimin e mundësive për zhvillim të bizneseve si dhe përfshirjen e grave në planifikimin edhe zhvillimin e politikave të Komunës.³³ Mirëpo, në praktikë gratë vazhdojnë të mos jenë pjesë e këtyre proceseve, siç nuk janë pjesë as e planifikimit urban. Këtë e vërtetojnë edhe të dhënat e hulumtimit të tretë mbi çështjet urbanistike në Prizren, në kuadër të projektit “Qyteti gjithpërfshirës”, i cili u krye në qershor të vitit 2014, dhe në të cilën morën pjesë 300 respondentë. Prej numrit të përgjithshëm të respondentëve, janë 64% gra që nuk kanë informatë se mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve, rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin. Përqindje e ngjashme konfirmohet edhe nga rezultatet e hulumtimit mbi çështjet urbanistike të kryer në vitin e kaluar në Prizren me 249 respondentë.³⁴

Në përgjithësi, është numër i vogël i qytetarëve që marrin pjesë në diskutime publike në lidhje me problemet urbane. Është një numër i vogël i qytetarëve që e marrin informatën për diskutimet publike, për shkak se format e përzgjedhura për informim nga ana e komunës shpeshherë nuk mbërrijnë te qytetarët, por edhe kur mbërrijnë nuk arrijnë t’i mobilizojnë ata. Për mungesë informimi adekuat, por edhe mobilizimi, prania e gruas ëshë gati se e padukshme në diskutimet e komunës me qytetarë dhe shpesh në emër të saj flet një burrë i familjes apo i lagjes. Sa mund t’i nxjerrë në pah një përfaqësim i tillë nevojat dhe problemet e përditshmërisë së gruas në hapësirën urbane? Cilat janë mënyrat për rritjen e pjesëmarrjes, por edhe të aktivizimit të gruas për t’i artikuluar nevojat dhe zgjidhjet që do të kontribuonin në përmirësimin e mjedisit fizik për të dhe për gjithë qytetarët e tjerë?

Është viti i dytë që, në kuadër të projektit “Qyteti gjithpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren” dhe me qëllim të artikulimit të nevojave, problemeve dhe pengesave të përditshmërisë së qytetarëve të Prizrenit, EC Ma Ndryshe zhvillon disa cikle fokus grupesh dhe debatesh me qytetarë të Prizrenit. Qytetarët e targetuar për të marrë pjesë në këto fokus grupe iu takojnë komuniteteve interesat e të cilëve janë më pak të përfaqësuar në qeverisje lokale. Janë pesë komunitete të ndryshme që përfshihen në fokus grupe dhe me secilin u realizuan nga dy fokus grupe dhe një debat publik. Qytetarët e ftuar në debate, kishin rastin të shpalosin shqetësimet dhe idetë e tyre për qytetin përballë zyrtarëve dhe përfaqësuesve të tjerë të qeverisë lokale të komunës së Prizrenit.

Ky raport është prodhim i diskutimeve të dy fokus grupeve dhe të një debati me gra të punësuar dhe aktiviste për të drejta të grave të qytetit të Prizrenit. Fokus grupi i parë u mbajt më 18 shkurt 2014. Në të

³³ Gashi, E., Gratë dhe planifikimi urban, Përmbledhje raportesh “Qyteti gjithpërfshirës”, EC Ma Ndryshe, fq. 15, janar 2014, http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Qyteti_Gjithperfs hires.pdf, (qasur më 09.12.2014, ora 21:00)

³⁴ EC Ma Ndryshe, Analizë e shkurtë “Planifikimi Urban për Qytetarët”, Prizren, shtator 2013, http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/ANALIZA_Planifikim_urban_per_qytetaret.pdf, (qasur më 09.12.2014, ora 21:00)

morën pjesë 12 gra të profileve të ndryshme profesionale dhe aktiviste nga OJQ-të për të drejtat e grave. Temat e diskutuara në këtë fokus grup kishin të bënin me infrastrukturën fizike në qytet, punësimin, shëndetësinë dhe shërbimet publike³⁵. Fokus grupi i dytë u mbajt më 23 qershor 2014 dhe në të morën pjesë 11 gra, ndërsa temat e diskutuara kishin të bënin me edukimin, sigurinë publike, kulturën dhe ambientin³⁶. Në shtator u mbajt debati përmbyllës i ciklit të diskutimit në fokus grupe me gratë, me ç’rast gratë e punësuara dhe aktivistet patën rastin të shpalosin nevojat dhe idetë e veta përballë përfaqësueses të Drejtorisë së Urbanizmit në Komunën e Prizrenit.³⁷

Të gjeturat

Të gjeturat e diskutimeve në fokus grupe dhe në debatin përmbyllës të komunitetit të grave të punësuara dhe aktiviste janë të përmbledhura në dy grupe kryesore: zona urbane e qytetit të Prizrenit dhe zona rurale e Komunës së Prizrenit. Përbrenda këtyre grupeve, problemet dhe diskutimet e tjera janë grupuar në temat në të cilat është zhvilluar diskutimi.

1. Qyteti i Prizrenit

Hapësira publike

Sipërfaqet publike - trotuaret:

Lëvizja e lirë e këmbësorëve në trotuare është e penguar nga makinat e parkuara në rrugë dhe në trotuare. Sipas pjesëmarrëseve të fokus grupeve, kjo është pasojë e numrit të vogël të parkingjeve në qytet.

Trotuaret dhe rrugët janë me sipërfaqe të dëmtuara, me shumë gropa, por edhe të zaptuara me mallra dhe objekte të vëna nga lokalet e afërta. Këto krijojnë pengesa në qarkullimin e prindërve me karroca të fëmijëve, lëvizjen e PNV-ve, etj.

Trotuaret pranë shkollave mes tjerash zaptohen edhe nga shitës ambulatorë, të cilët ngushtojnë në masë kritike, ose pengojnë krejtësisht lëvizjen e fëmijëve gjatë rrugëtimit të tyre prej/ për në shkollë. Fëmijët detyrohen të ecin në rrugë, duke e ekspozuar veten rrezikut të aksidentimit nga makinat. Për shkak të kësaj, prindërit nuk ndihen rehat t’i lënë fëmijët të shkojnë vetë në shkollë dhe i sjellin ata me makina. Në oraret e fillimit dhe mbarimit të mësimit gjithmonë është rrëmujë nga makinat, shitësit dhe prindërit përpara shkollave.

Sipërfaqet e gjelbra – parqet:

Pjesëmarrësit në fokus grupe, e vlerësuan rritjen e sipërfaqeve të gjelbra në qytet në vitet e fundit, por e quajnë shqetësues faktin se gjithmonë pranë atyre sipërfaqeve hapet një aktivitet shërbyes, i cili, sipas tyre, e degradon dhe pengon funksionin publik dhe shfrytëzimin e lirë të atij gjelbrimi. Në zonat e gjelbëruara enden qen endacakë, por edhe qytetarë me qen të mëdhenj që nuk kanë maska mbrojtëse. Ky fenomen rrit ndjenjën e pasigurisë të qytetarët për t’i frekuentuar ato zona.

³⁵ Basha, R., Raporti i fokus grupit të parë “Gratë dhe qyteti”, projekti Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren, EC Ma Ndryshe, shkurt 2014

³⁶ Basha, R., Raporti i fokus grupit të dytë “Gratë dhe qyteti”, projekti Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren, EC Ma Ndryshe, qershor 2014

³⁷ Selimi, V. Basha, R., Raporti i debatit “Gratë dhe qyteti”, projekti Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren, EC Ma Ndryshe, shtator 2014

Shërbimet publike

Transporti publik:

Ndonëse zyrtarët komunalë deklarojnë se transporti publik në Prizren është i rregulluar mirë, në qytet nuk shihet një numër i madh i njerëzve që e shfrytëzojnë atë. Qyteti i Prizrenit ka një shtrirje të gjerë gjeografike, por edhe rrethinë me mbi 70 fshatra. Fakti që janë shumë qytetarë që për distanca të vogla brenda qytetit përdorin makinat, që kontribuojnë në mbingarkim të rrugëve dhe trotuare të zaptuara me makina të parkuara, tregon që transporti publik në Prizren duhet të jetë më i shtrirë dhe më cilësor.

Largimi i mbeturinave:

Në lagje të caktuara, sidomos pranë objekteve të pashfrytëzuara, mbeturina të shumta derdhen nga qytetarë të papërgjegjshëm. Ato nuk largohen nga autoritetet komunale dhe si pasojë e gjithë kësaj, te banorët e lagjeve ekziston bezdia nga kundërmimi, minjtë, qentë endacakë si dhe shqetësimi për paraqitjen e ndonjë sëmundjeje ngjitëse.

Për shkak të kamionëve të papërshtatshëm për largimin e mbeturinave, në shumë lagje, zbrazja e kontejnerëve bëhet asisoj që të gjitha mbeturinat fillimisht hidhen në tokë dhe pastaj përmes lopatës hidhen në kamionë. Mbeturinat e lëngshme dhe produktet e fermentuara në kontejnerë, në shumicën e rasteve, mbeten në sipërfaqe të rrugëve, kundërmimi i të cilave u pengon jashtë mase banorëve të atyre lagjeve.

Derdhja e ujërave të zeza:

Në disa lagje, ujërat e zeza derdhen në rrugë, me ç'rast banorët shqetësohen për kushtet e përgjithshme higjienike dhe nga kundërmimi i rëndë në lagje.

Mirëmbajtja e varrezave:

Në diskutime u ngrit edhe çështja e gjendjes së keqe të varrezave të qytetit dhe u kërkua nga Komuna që të ndërmarrë masa për rregullimin e tyre.

Edukimi

Infrastruktura shkollore:

Në qytetin e Prizrenit nuk ka shkolla të mjaftueshme për ta përballur numrin e lartë të nxënësve. Për këtë arsye ka shkolla në qytet që ndiqen nga një numër jashtëzakonisht i madh i nxënësve. Kjo ngarkesë i bën prindërit të shqetësohen për mirëmbajtjen adekuate të ndërtesave të shkollës dhe nivelin e përgjithshëm të higjienës në mjediset e shkollave. Në fokus grupin e parë u diskutua mbingarkesa e shkollës fillore 11 Marsi, me ç'rast gratë pjesëmarrëse në diskutim u shprehën se ndërtimi i një shkolle tjetër në atë lagje është më se i domosdoshëm.

Cilësia e mësimdhënies:

Në fokus grupin në të cilin u diskutua edukimi, u vlerësua se cilësia në mësimdhënie në përgjithësi është në rënie si pasojë e reformave të ndryshme dhe të shpeshta. Sipas grave pjesëmarrëse në diskutim, cilësia e dobët në mësimdhënie është edhe pasojë e cilësisë së dobët të mësimdhënësve, që sipas tyre punësohen në baza partiake e jo në bazë të kualifikimeve, etj.

Siguria e fëmijëve në shkolla:

Siguria e fëmijëve në shkolla (në rrugë për/prej shkollë, në oborr) është brengë shumë e madhe për prindërit. Shqetësim për siguri është dikuria e ngacmimit të vajzave dhe adoleshenteve në rrugë dhe në oborre të shkollave, por edhe dukuria e dhunës me armë të ftohta ndër fëmijë të shkollave fillore dhe të mesme, që për pasojë ka lëndime dhe vdekje të fëmijëve brenda shkollës. Një tjetër çështje që lidhet me sigurinë e fëmijëve është edhe numri i madh i qenve endacakë në rrugë në orët e mbrëmjes, që rrezikojnë fëmijët e vegjël që kthehen në atë kohë nga shkolla në shtëpi.

Punësimi

Është numri i vogël i grave që punësohen, e sidomos në pozita vendimmarrëse. Në diskutime në fokus grupe u kërkua që kjo dukuri të problematizohet. Sipas pjesëmarrësve në diskutime, kjo ndodh sepse gratë ndonjëherë zgjedhin të mos konkurrojnë në pozita vendimmarrëse për shkak të obligimeve në familje. Mungesa e çerdheve dhe kujdesit adekuat për fëmijë, si dhe shërbimeve të tjera që do t'i lehtësonin grave me obligimet e kujdesit ndaj fëmijës dhe shtëpisë, kontribuojnë në masë të madhe që ato të mos përzgjedhin punë në pozita vendimmarrëse. Një arsye tjetër për numrin e vogël të grave në këto pozita, sipas shumicës së grave të përfshira në diskutim, është edhe mosdhënia e shanseve të barabarta grave në konkurse. Edhe ato pak gra në ato pozita, vendosen aty vetëm nëse janë anëtare të ndonjë partie politike dhe si të tilla janë të instrumentalizuara politikisht.

Pjesëmarrja në diskutime publike

Një çështje tjetër që u diskutua në fokus grupe është edhe mospjesëmarrja e grave në diskutimet publike të planeve urbane. Janë të shumta arsye pse gratë janë në numër të vogël në këto diskutime, por prej më të rëndësishmëve janë: informimi joefikas nga ana e komunës, mosbesimi në qeverisjen lokale, neglizhenca e qytetarëve, etj.

Kultura

Trashëgimia kulturore:

Trashëgimia kulturore e qytetit të Prizrenit shihet si pasuria dhe krenaria e gjithë qytetarëve. Pjesëmarrëset e në diskutime u ankuan, që shpeshherë kur duan t'iu tregojnë objektet e trashëgimisë mysafirëve vendorë apo të huaj, objektet i gjejnë të mbyllura dhe përgjegjësit e tyre nuk gjenden.

Ndotja e mjedisit

Rrezatimi i rrezikshëm:

Antenat e telefonisë mobile të vendosura gjithandej rrezikojnë popullsinë nga rrezatimi i rrezikshëm.

Kulmet e asbestit:

Ka shumë kulme në qytetin e Prizrenit që janë të mbuluara me tjegulla "Sallonit" (nga fibra të asbestit), të cilat janë jashtëzakonisht të rrezikshme, e sidomos nëse janë më të vjetra se 25 vjet. Pjesëmarrëset e diskutimeve kërkuan që komuna sa më shpejt të angazhojë ekipe specialistësh që do t'i largojnë/zëvendësojnë dhe asgjësojnë këto materiale. Nuk rekomandohet që njerëzit e paspecializuar t'i largojnë vetë ato kulme, sepse ekziston rreziku i lartë i inhalimit të fibrave kancerogjene të asbestit.

Gazrat toksike:

Automekanikët në disa lagje banimi të Prizrenit i ngjyrosin makinat me llaqe pa i ndërmarrë masat mbrojtëse të nevojshme, si dhe disa furrtarë në furrrat e tyre djegin goma dhe me këtë ndotin ajrin me avuj dhe tym që përmbajnë helme të dëmshme për mjedisin dhe njeriun.

2. Zonat rurale – rrethet në Komunën e Prizrenit

Infrastruktura rrugore pranë shkollave:

Mungojnë trotuaret përreth shkollave por edhe përgjatë rrugëve nëpër të cilët detyrohen fëmijët të kalojnë gjatë rrugëtimit për në shkollë. Si pasojë e kësaj, kohëve të fundit një numër i fëmijëve janë aksidentuar prej makinave, disa prej të cilave kanë rezultuar me vdekje.

Infrastruktura shkollore:

Është gjendje shqetësuese për higjenën në mjediset e shkollave, me theks të veçantë në tualete. Shumë nga këto shkolla kanë tualete me bide, shfrytëzimi i të cilave paraqet rrezik për bartjen e sëmundjeve ngjitëse të fëmijët.

Pajisja me tualete dhe ndihmesa tjera për PNV:

Shkollat e rretheve nuk kanë tualete për PNV, por edhe pjerrina e ndihmesa të tjera për këtë komunitet.

Mungesa e kanalizimeve dhe ndotja e ujërave të përroskave dhe lumenjve prej ujërave të zeza:

Disa fshatra kanë shtëpi me gropa septike, të cilat nuk janë të realizuara si duhet. Të tjerët ujërat i shkarkojnë në lumenj (p.sh. fshati Krushë gjithë kanalizimet i shkarkon në lumin Drini i Bardhë).

Infrastruktura shëndetësore:

Në ato pak qendra të mjekësisë familjare që gjenden në rrethe, mjekët dhe infermierët nuk e respektojnë orarin e punës. Gratë e këtyre rretheve, për shkak të stafit jo të pranishëm në këto objekte detyrohet të udhëtojë në Prizren për vizita mjekësore.

Punësimi:

Grave nuk iu jepen mundësi të barabarta në konkurse për pozita vendimmarrëse. Në konkurset për drejtorë të shkollave, përkundër paraqitjes së grave me shkollim dhe përvojë adekuate në konkurs, përzgjedhen vetëm burra.

Rekomandime

Infrastruktura rrugore – të insistohet që autoritetet lokale të veprojnë më shumë për lirim të trotuareve nga makinat, nga pengesat e tjera, por edhe t'i lirojnë të njëjtat pranë shkollave nga shitësit ambulantë. Në zonat rurale të ndërtohen trotuare pranë shkollave, por edhe të sigurohet rrugë e sigurt për nxënësit e këtyre zonave.

Zonat e gjelbra – i rekomandohet Drejtorisë së urbanizmit që pranë zonave të gjelbruara dhe parqeve të kenë sa më pak aktivitete komerciale që do ta pengonin funksionin publik dhe shfrytëzimin e lirë të këtyre hapësirave nga qytetarët.

Të merren masa që të largohen qentë endacakë nga parqet dhe sipërfaqet e gjelbra të qytetit, si dhe t'iu kërkohet pronarëve të qenve që t'i pajisin ata me maska mbrojtëse, për të evituar rrezikun e kafshimit.

Largimi – pastrimi i mbeturinave - të rregullohet mënyra e zbrazjes së kontejnerëve në rrugët e qytetit. Të synohet në pajisjen e ndërmarrjes së pastrimit të qytetit me kamionë të specializuar.

Cilësia në mësimdhënie - të kërkohet me këmbëngulësi te drejtoria komunale përkatëse, që punësimi i mësimdhënësve të bëhet në bazë të kualifikimeve e jo në baza partiake. Praktika e deritanishme e punësimit po ndikon dukshëm në cilësinë e mësimdhënies.

Siguria e fëmijës në shkollë - të ndërmerren masa nga organet kompetente ndaj dukurisë gjithnjë e më brengosëse të pasigurisë së fëmijëve në shkolla (në rrugë për/prej shkolle, në oborr dhe brenda saj), në veçanti ndaj dhunës me armë të ftohta ndër fëmijë të shkollave të mesme dhe fillore.

Punësimi – në diskutime në fokus grupe u kërkua që të rritet numri i grave të punësuar si dhe të përfshihen sa më shumë gra në poste vendimmarrëse. Kërkohet zbatimi në përpikëri i ligji për barazi gjinore, si dhe planveprimi komunal për këtë të fundit. Në nivelin qendror, kërkohet rishqyrtimi i ligjit të punës, i cili, me kushtet aktuale, ua vështirëson grave të ndjekin karrierën profesionale paralelisht obligimeve familjare. Duhet krijuar kushte (hapja e më shumë çerdheve publike, rregullimi i transportit publik, etj.) për t’ua mundësuar grave nëna të punojnë.

Trashëgimia kulturore – u kërkohet drejtorive përkatëse (drejtorisë së kulturës dhe asaj të turizmit) që ta bëjnë të mundshme që objektet e trashëgimisë të jenë të hapura dhe të qasshme për vizitorë çdo ditë.

Kulmet e asbestit - rekomandohet që komuna të financojë zëvendësimin e kulmeve të sallonitit në tërë qytetin, si dhe të krijojë një ekip të specializuar për largimin e këtyre kulmeve (për të evituar largimin e këtyre të fundit nga qytetarët apo punëtorëve e pakualifikuar)

Gazrat toksike - të ndalohet plotësisht apo të kontrollohet (me zbatimin e masave mbrojtëse) ngjyrosja me llaqe e makinave nga automekanikët në lagjet e banimit, për shkak të rrezikshmërisë së lartë të emetimit të toksinave nga këto ngjyra për njerëzit dhe ambientin. Të ndalohet djegia e gomave si lëndë djegëse nga furratarët e lagjeve.

Mjeku në zonat rurale – të insistohet në drejtorinë përkatëse, që në qendrat e mjekësisë rajonale në rrethe, orari i mjekëve dhe infermierëve të respektohet plotësisht (orar i plotë), por edhe të ketë më shumë specialistë, që gratë të mos të detyrohen për vizita të udhëtojnë për në Prizren.

Pjesëmarrja në diskutime publike - në ndërlidhje me pjesëmarrjen e ulët të grave në diskutime publike rreth çështjeve urbanistike, nga pjesëmarrësit e fokus grupeve u sugjerua që për një pjesëmarrje më efektive do të duhej bërë fushatë më të koncentruar informimi. Përpos mënyrave të informimit që tashmë përdoren nga komuna (posterët, TV, radio, etj), duhet gjetur forma të mobilizimit të grave përmes OJQ-ve dhe shoqatave rreth të cilave organizohen gratë e lagjeve, të rrugëve të caktuara, etj. Për të qenë sa më frytdhënëse këto diskutime, duhet të organizohen në njësi – fokus grupe të vogla diskutimi (fokus grup i grave të hyrjes, bllokut, mëhallës, etj.) Grupet e vogla të diskutimit janë më lehtë të mblidhen dhe informohen, por edhe diskutimi më lehtë fasilitohet.

Në përmbyllje, duke iu referuar autorëve, Goltsman dhe Iacofano, për t’i ndihmuar një komuniteti që të jenë pjesëmarrës aktivë në shoqëri, duhet që fillimisht të binden rreth rolit dhe kontributit të tyre në atë shoqëri dhe pastaj të inkurajohen që aktivisht të marrin pjesë në të gjitha fazat e përpilimit të strategjive dhe planifikimit të qytetit.³⁸ Për më shumë, është e nevojshme që të emancipohet një qytetari aktive,

³⁸ Goltsman, S, Iacofano, D, (2007), The Inclusive City: Innovative Solutions for Buildings, Neighborhoods, and Urban Spaces, MIG Communications), marrë nga Basha, R., “Qyteti dhe PNV-të”, në Përmbledhje raportesh “Qyteti

përkatësisht një qytetar aktivist³⁹, i cili, më parë se të presë prej institucioneve që ta bëjnë ndryshimin, me përkushtimin që e ka ndaj komunitetit dhe mjedisit urban, e udhëheq ndryshimin në mënyrë të pavarur dhe e shtyn komunitetin të përfshihet aktivisht në proceset vendimmarrëse.⁴⁰ Me participim të gjerë, komuniteti do t'i forcohet ndjenja e pronësisë dhe e përkatësisë ndaj një projekti të caktuar dhe ndaj qytetit të tyre në përgjithësi.⁴¹ Ky lloj angazhimi e vë në rrënjë të ndryshimeve urbane qytetarin.

gjithpërfshirës”, EC Ma Ndryshe, fq. 26, janar 2014,

http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Qyteti_Gjithperفشires.pdf

³⁹ <http://www.bmwguggenheimlab.org/100urbantrends/#!/new-york-city>, qasur më 10.12.2014, në ora 14:00

⁴⁰ Po aty.

⁴¹ The Inclusive City, Inclusive Design Criteria and Policies,

<http://www.inclusivecity.com/Content/10002/InclusiveCityDesignCriteriaandPolicies.html>, (qasur më 01.11.2013),

marrë nga Basha, R., “Qyteti dhe PNV-të”, në Përmbledhje raportesh “Qyteti gjithpërfshirës”, EC Ma Ndryshe, fq.

27, janar 2014, http://www.ecmandryshe.org/repository/docs/Qyteti_Gjithperفشires.pdf

VI. Personat me nevoja të veçanta dhe planifikimi urban në Prizren

Arsimi, Shëndetësia dhe Punësimi

Shkruar nga, Dea Pallaska O'Shaughnessy

Përmbledhje ekzekutive

Numri i personave me aftësi të kufizuara është në rritje, ndërkaq që qasja sipas të drejtave të njeriut ndaj këtij komuniteti është kurorëzuar me miratimin e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (KDKPAK). E drejta për arsim, shëndetësi e punësim, zë vend të rëndësishëm në KDKPAK, po edhe në Deklaratën e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut,⁴² zbatimi i së cilës garantohet me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.⁴³

Disa nga parimet e përgjithshme të KDKPAK janë “respekti për dinjitetin, autonominë individuale, përfshirë lirinë për të bërë zgjedhjet personale, dhe pavarësinë e personit... pjesëmarrjen dhe përfshirjen e plotë dhe efektive në shoqëri,”⁴⁴ prandaj edhe qyteti gjithëpërfshirës do të duhej t'i promovonte pikërisht këto vlera, krahas mos diskriminimit, barazisë gjinore, qasjes, mundësive të barabarta për të gjithë, etj.

Të gjeturat tregojnë se personat me aftësi të kufizuara marrin pjesë shumë pak në jetën e qytetit, ndërkaq që edhe më pak marrin pjesë në proceset vendimmarrëse që kanë të bëjnë me zhvillimin e qytetit. Arsyeja për këtë përjashtim të personave me aftësi të kufizuara nga jeta urbane janë barrierat fizike ose arkitektonike, institucionale, në informim apo komunikim dhe barrierat kulturore (të qasjes). Çështjet kryesore që i preokupojnë qytetarët me aftësi të kufizuara janë bllokimi i trotuareve me makina, mungesa e lidhjeve të transportit publik, mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve, problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuara, mungesa e parqeve publike dhe hapësirat rekreative, që janë të gjitha edhe brenga të të gjithë qytetarëve të tjerë të anketuar. Kjo e dëshmon edhe një herë se qytetarët me aftësi të kufizuara i ndajnë të njëjtat brenga me të gjithë dhe duhet të gjithëpërfshihen në të gjitha proceset që kanë të bëjnë me bërjen e një qyteti më të mirë për të gjithë.

Përmirësimi i qytetit dhe me këtë i jetës së qytetarëve është një proces progresiv i pandalshëm, prandaj edhe rekomandimet që janë paraqitur duhet të shihen si rezultat i të gjeturave aktuale, në ndërkohë që mund të dalin rekomandime specifike të reja nga qytetarët. Rekomandimet janë ndarë në rekomandime të përgjithshme, që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen e qytetarëve me aftësi të kufizuara në të gjitha proceset e zhvillimit të qytetit dhe në rekomandimet specifike që kanë të bëjnë me përmirësimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse në arsim, shëndetësi dhe punësim. Rekomandimet specifike janë: të krijohet një bazë e të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim që janë të përfshirë dhe të përjashtuar nga arsimi; të hartohet një plan i veprimit për rritjen e qasshmërisë në arsim; të eliminohen barrierat e qasjes në shërbimet shëndetësore; të rritet vetëdija e punëtorëve shëndetësorë dhe personelit tjetër ndaj aftësisë së kufizuar; të krijohet një bazë e të dhënave të personave me aftësi të kufizuara që janë të interesuar për punësim; të promovohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara.

⁴² Asambleja e Përgjithshme e OKB. (1948). *Deklarata e Përgjithshme mbi të Drejtat e Njeriut*. New York. Tërhequr më 5.10.2014 nga http://www.ohchr.org/en/udhr/documents/udhr_translations/aln.pdf

⁴³ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Kushtetuta e Republikës së Kosovës*. Tërhequr më 5.10.2014. nga <http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Kushtetuta.e.Republikes.se.Kosoves.pdf>

⁴⁴ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. (2006). *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar*. New York. Tërhequr më 5.10.2014 nga http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf

Hyrje

“Personat me aftësi të kufizuar përfshijnë individët me dëmtime fizike, mendore, intelektuale apo shqisore aftagjata, të cilat në ndërveprim me barriera të ndryshme mund të pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri njësoj si pjesa tjetër e shoqërisë.”⁴⁵

“Qyteti gjithëpërfshirës promovon rritjen me barazi. Është një vend ku çdo kush, pavarësisht kushteve ekonomike, gjinisë, racës, etnisë apo religjionit, është i aftësuar dhe i fuqizuar për të marrë pjesë plotësisht në mundësitë sociale, ekonomike dhe politike që qytetet kanë për të ofruar. Planifikimi dhe vendimmarrja me pjesëmarrje janë në zemër të Qytetit Gjithëpërfshirës.”⁴⁶

Numri i personave me aftësi të kufizuar është në rritje e sipër, pjesërisht për shkak të rritjes së jetëgjatësisë dhe pjesërisht për shkak të përhapjes së madhe të sëmundjeve kronike, ndërkaq llogaritet që ky komunitet aktualisht përbën afër 15% të popullatës botërore.⁴⁷ Bazuar në parashikimin e popullsisë së Kosovës, deri në vitin 2061, popullsia mbi 65 vjeç do të përbëjë 23.6-40.6% të popullsisë së përgjithshme⁴⁸, që do të thotë se qytetet kosovare, ndërtimet dhe shërbimet, duhet të planifikohen me aftësinë e kufizuar, respektivisht me qytetarët e moshuar në mendje.

Aftësia e kufizuar është shumëllojshme, vetëm disa nga format e saj janë të dukshme dhe rrjedhimisht jo të gjithë personat me aftësi të kufizuar ballafaqohen me të njëjtat pengesa. Përveç kësaj, barrierat e shumta kulturore dhe qëndrimet stigmatizuese ua pamundësojnë personave me aftësi të kufizuara që haptazi të bisedojnë për aftësinë e kufizuar që kanë.

Nuk ekziston një koncept i qartë i urbanizmit dhe jetës urbane në Shkencat mbi Aftësinë e Kufizuar, mirëpo ajo që haset më së shpeshti është një përzierje e nënkuptuar e ideve se çfarë kuptimi mund të ketë urbanizmi për gjithëpërfshirjen në komunitet, kohezionin social, qytetarinë dhe mundësitë për vetëzhvillim.⁴⁹ Autorë të ndryshëm nënvizojnë aspekte të ndryshme të gjithëpërfshirjes sociale, të cilën duhet ta realizojnë qytetet. Prince vë theksin te *mobiliteti*, dhe sipas tij, “lëvizja gjeografike mes dy vendeve, programatike mes shërbimeve dhe e zhvillimit mes fazave dhe moshave të ndryshme jetësore, në një kontekst përkrahës, i kontribuon kontinuitetit, ndjenjës së përkatësisë dhe integritimit social” për personat me aftësi të kufizuar.⁵⁰ Ndërkaq, Hall përcakton gjashtë fusha të rëndësishme për realizimin e gjithëpërfshirjes sociale të një personi: 1) të jesh i/e pranuar si individ përtej aftësisë së kufizuar; 2) të kesh marrëdhënie personale të rëndësishme dhe reciproke; 3) të jesh i/e angazhuar në aktivitete; 4) të jesh i/e punësuar; 5) të kesh vendbanim të përshtatshëm; dhe 6) të marrësh përkrahje formale dhe joformale.⁵¹

⁴⁵ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. (2006). *Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar*. New York. Neni 1. Tërhequr më 5.10.2014 nga

http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf

⁴⁶ UN-Habitat. (2001). *Inclusive cities initiative: The way forward*. Nairobi: UN Habitat. Tërhequr më 5.10.2014 nga

http://ww2.unhabitat.org/campaigns/governance/docs_pubs.asp#Inclusive%20Cities

⁴⁷ World Health Organization & The World Bank. (2011). *World Report on Disability*. Malta. Tërhequr më 5.10.2014 nga

http://www.who.int/disabilities/world_report/2011/en/

⁴⁸ Agjencia e Statistikave të Kosovës. (2013). Parashikimi i popullsisë së Kosovës 2011-2061. Prishtinë. Tërhequr më

5.10.2014 nga http://ask.rks-gov.net/publikimet/cat_view/8-popullsia

⁴⁹ Prince, Michael J. (2008). *Inclusive City Life: Persons with Disabilities and the Politics of Difference*. *Disability Studies Quarterly*, 28 (1). Tërhequr më 5.10.2014 nga

<http://dsq-sds.org/article/view/65/65>

⁵⁰ Po aty.

⁵¹ Hall, Sarah A. (2009). The social inclusion of people with disabilities: A qualitative meta-analysis. *Journal of Ethnographic & Qualitative Research*, 3 (3), 162-173.

Hyryra në fuqi e Konventës për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara, ka qenë shtytëse që shumë qeveri të miratojnë strategji, politika e ligje që promovojnë jetë sa më gjithëpërfshirëse për personat me aftësi të kufizuara, mirëpo jetësimi i gjithëpërfshirjes në praktikë vazhdon të mbetet sfidë, rëndom gjithëpërfshirja fizike është më e lehtë se ajo sociale. Martin dhe Cobigo, sugjerojnë se “nevojitet një definicion më i qartë i gjithëpërfshirjes dhe matjes së gjithëpërfshirjes, në mënyrë që vendimmarrësit dhe ofruesit e shërbimeve të mund ta definojnë natyrën e përgjegjësive, veprimeve dhe ta vlerësojnë efektivitetin e tyre në arritjen e gjithëpërfshirjes.”⁵²

Duke marrë të gjitha këto parasys, sigurisht që në vitet e ardhshme duhet përcjellë me vëmendje zhvillimet në fushën e urbanizimit dhe përpjekjeve për t’iu përgjigjur nevojës së qytetarëve me aftësi të kufizuara për të jetuar jetë të dinjitetshme, të pavarur dhe kualitative. Në ndërkohë që disa nga shembujt për model, janë:

Christchurch, Zelandë e Re⁵³ – Pas tërmetit të viti 2011, humbjes së 185 jetëve dhe dëmeve të mëdha materiale, autoritetet për rimëkëmbje nga tërmeti, në bashkëpunim me autoritetet lokale dhe qendrore, morën vendim që të rindërtojnë Christchurch në një qytet me barazi dhe qasje për personat me aftësi të kufizuara. Qytetarët me aftësi të kufizuara ishin pjesëmarrës në identifikimin e fushave prioritare për intervenim, kanë ofruar ekspertizën e tyre në planifikimin e ndërtimeve të qasshme, janë krijuar mundësi punësimi për ta pikërisht në punët që kishin të bëjnë me rimëkëmbjen e qytetit, kanë ndihmuar në dizajnimin e përgjigjeve më efektive në emergjencë për personat me aftësi të kufizuara. Të gjitha këto janë bërë të mundura, sepse ka ekzistuar besimi në vlerat e njëjta për një jetë më të mirë, bashkërendimi mes institucioneve të niveleve dhe sektorëve të ndryshme dhe pjesëmarrja e qytetarëve me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat e procesit.

Mooresville, SHBA – Në vitin 2012, Bordi i Komisionarëve të Mooresville ka marrë vendim që ky të bëhet “qytet model” për të adresuar nevojat e personave me aftësi të kufizuara.⁵⁴ Ky vendim u pasua me themelimin e Këshillit të Kryebashkiakut për Aftësinë e Kufizuar. Në fillim u aprovuan rregulloret dhe u identifikuan gjashtë fusha kryesore të fokusit: infrastruktura, vetëdija publike, kultura dhe rekreacioni, zhvillimi i fuqisë punëtore, arsimit publik dhe kujdesi shëndetësor. Pas kësaj pasuan hulumtimet për të identifikuar praktikën më të mira dhe u përpiluan rekomandimet për veprimet e ardhshme afat-shkurtra dhe afat-gjata. Ndër intervenimet e para ishin ato që nuk kishin apo kishin më pak implikime buxhetore, për t’i lënë radhën më vonë intervenimeve që kërkojnë buxhet më të konsiderueshëm.

⁵² Martin L, Cobigo V. (2011). Definitions Matter in understanding social inclusion. Journal of Policy and Practice in Intellectual Disabilities. 8(4). 276-282.

⁵³ Tërhequr më 5.10.2014 nga

<http://www.ccc.govt.nz/thecouncil/policiesreportsstrategies/policies/groups/community/equityandaccessforpeoplewithdisabilities.aspx#jumplink19>

⁵⁴ Tërhequr më 5.10.2014 nga <http://ci.mooreville.nc.us/DocumentCenter/View/1015>

Situata Aktuale

“Asnjë personi nuk guxon t’i mohohet e drejta për arsim.”⁵⁵

“Qëllimet e arsimit parauniversitar janë zhvillimi i personaliteti, talentit dhe aftësisë mendore e fizike të nxënësit deri në potencialin e tij të plotë.”⁵⁶

“Të gjithë qytetarët dhe banorët kanë të drejtë të qasjes së barabartë në kujdesin shëndetësor.”⁵⁷

“Zbatimi i këtij ligji do të bëhet duke respektuar dinjtetin, të drejtat dhe liritë themelore të njeriut të përcaktuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, dhe me marrëveshjet dhe instrumentet ndërkombëtare...”⁵⁸

“Organet e administratës shtetërore, punëdhënësit e sektorit privat dhe publik si dhe organizatat joqeveritare obligohen që, me kushtet e përshtatshme të punës, t’i punësojnë personat me aftësi të kufizuara.”⁵⁹

“Çdo punëdhënës është i obliguar të punësojë një person me aftësi të kufizuara në çdo pesëdhjetë (50) punëtorë.”⁶⁰

“Çdo komunë mban periodikisht, së paku dy herë në vit, takime publike në të cilat mund të marrë pjesë secili person apo organizatë me interes në komunë.”⁶¹

“Përveç takimeve publike të cekura më lart, komunat janë të obliguara t’i informojnë qytetarët e komunës për çfarëdo planesh apo programesh të rëndësishme me interes publik...”⁶²

Përkundër infrastrukturës ligjore që promovon shërbime gjithëpërfshirëse dhe pjesëmarrjen e qytetarëve, pasqyra nga tereni lë për të dëshiruar. Gati gjysma (49.3%) e të anketuarve kanë deklaruar se nuk kanë njohuri apo informatë nëse qyteti i Prizrenit ka plane urbane, mbi 60% kanë deklaruar se nuk kanë informatë nëse qytetarët mund të marrin pjesë në zhvillimin e planeve dhe rregulloreve të ndryshme që kanë të bëjnë me qytetin, ndërkaq që vetëm 1.3 % kanë deklaruar se kanë marrë pjesë në debate publike (Ec ma Ndryshe, 2014). Në po këtë anketë, personat me aftësi të kufizuara janë shprehur se, sipas tyre, çështjet kryesore me problematike janë: bllokimi i trotuareve me makina (66.70%), mungesa e lidhjeve të transportit publik (33.40%), mungesa e mirëmbajtjes së rrugëve (33.30%), problemet e qarkullimit për persona me aftësi të kufizuara (33.30%), mungesa e parqeve publike (16.70%) dhe hapësirat rekreative (16.70%).

Mungojnë të dhëna të sakta për numrin e fëmijëve me nevoja të veçanta të përfshirë në sistemin e arsimit në Kosovë, por disa raporte sugjerojnë që ky numër është prej 1.3-2%.⁶³ Së fundi ka pasur deklarata nga zyrtarë të arsimit se në nivel të Kosovës, në vitin shkollor 2014/2015 janë regjistruar gjithsej 6.049 nxënës me nevoja të veçanta, prej të cilëve 4.871 në klasat e rregullta dhe 528 në kasat e

⁵⁵ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2011). *Ligji Nr. 04/L-032 Për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës*. Neni 3(1). Tërhequr më 5.10.2014 nga http://www.masht.gov.net/advCms/documents/1_Ligji_per_arsimin_Parauniversitar.pdf

⁵⁶ Po aty. Neni 1(2)2.1.

⁵⁷ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2006). *Ligji Nr.04/L-125 Për shëndetësi*. Neni 4(2). Tërhequr më 5.10.2014 nga <http://msh-ks.org/wp-content/uploads/2013/11/Ligji-per-shendetesi-2013.pdf>

⁵⁸ Po aty. Neni 4(1).

⁵⁹ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji Nr. 03/L-019 Për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara*. Neni 12(1). Tërhequr më 5.10.2014 nga http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2008_03-L-019_al.pdf

⁶⁰ Po aty. Neni 12(2).

⁶¹ Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji Nr. 03/L-040 Për vetëqeverisjen lokale*. Neni 68(1). Tërhequr më 5.10.2014 nga http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L040_al.pdf

⁶² Po aty. Neni 68(3).

⁶³ Save the Children. (2013). *Kosovo Child Rights Situation Analysis (CRSA)*. fq.63. Prishtinë.

bashkëngjitura, si dhe 652 në Qendra Burimore.⁶⁴ Këto shifra janë të ulëta krahasuar me synimet në Planin Strategjik të Arsimit në Kosovës 2011-2016.⁶⁵

Nuk ekzistojnë hulumtime që kanë bërë ekzaminimin e përvojës së personave me aftësi të kufizuara në sistemin e shëndetësor dhe nuk ka të dhëna për numrin e personave me nevoja të veçanta që janë punësuar dhe për përvojën e tyre.

Një dokument me rëndësi për fushën është Strategjia Nacionale për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023⁶⁶, e cila është përpiluar mbi bazën e të drejtave të garantuara me Konventën për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara⁶⁷ dhe ka 5 objektiva strategjike, që kanë të bëjnë me shëndetin, mirëqenien dhe sigurinë sociale, gjithëpërfshirjen në arsim, qasjen e barabartë në mbrojtje ligjore dhe krijimin e kushteve të barabarta në qasje, informim, komunikim pjesëmarrje dhe krijimin e një sistemi të unifikuar të të dhënave për personat me aftësi të kufizuara.

Të gjeturat

Gjetjet tregojnë se qytetarët më aftësi të kufizuar ballafaqohen me lloje të ndryshme të barrierave, të cilat i pengojnë ata në pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri në mënyrë të njëjtë me të tjerët, duke i penguar kështu për të bërë një jetë të pavarur, të dinjitetshme dhe të vetëkënaqshme.

*“Unë nuk mund as të imagjinoj se si duket një autobus lokal, sepse nuk kam pasur kurrë rastin të vozitem me të!”
(EC Ma Ndryshe, Fokus Grup 2014)*

Barrierat fizike apo arkitektonike – Nënkuptojnë aspektet e ndërtesave apo hapësirave që paraqesin pengesa për personat me aftësi të kufizuara. Zakonisht janë barrierat që evidentohen më së lehti, sepse e pengojnë qasjen fizike, respektivisht e pengojnë lëvizjen e lirë të personave më aftësi të kufizuar. Të këtilla barriera të identifikuar janë:

- bllokimi i trotuareve nga veturat, duke pamundësuar lëvizjen e lirë të qytetarëve në përgjithësi dhe të qytetarëve me aftësi të kufizuar në veçanti (shfrytëzuesit e karrocave, personat e verbër, shfrytëzuesit e shëtitoreve);
- mungesa e plotë e pjerrinave, apo pjerrina me pjerrtësi të papërshtatshme për shfrytëzuesit e karrocave në shkolla, banka, sallën e sportit, shtëpinë e kulturës, dhe objekte të tjera publike;
- mungesa e sipërfaqeve taktore dhe shenjëzimi me ngjyra kontraste të forta për të mundësuar lëvizjen e të verbërve, respektivisht të personave me të pamur të dobësuar;

⁶⁴ Evropa e Lirë. (2014). *Përfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në sistemin arsimor*. Tërhequr më 5.10.2014 nga <http://www.evropaelire.org/content/article/26564437.html>

⁶⁵ Republika e Kosovës, Ministria e Arsimit, Shekncës dhe Teknologjisë. (2011). Planin strategjik i arsimit në Kosovë 2011-2016. Tërhequr më 5.10.2014 nga <http://www.uni-pr.edu/getattachment/b0997082-4539-497d-9622-a706294c9307/Plani-strategjik-i-arsimit-ne-Kosove-2011-2016.aspx>

⁶⁶ Zyrja e Kryeministrit të Republikës së Kosovës. (2013). *Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar në Republikën e Kosovës 2013-2023*. Tërhequr më 5.10.2014 nga http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/STRATEGJIA_NACIONALE_PER_TE_DREJTAT_E_PERSONAVE_ME_AFTESI_TE..._Shq+Ser+Ang.pdf

⁶⁷ Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara. (2006). *Konventa për të drejtat e personave me aftësi të kufizuar dhe protokoli opsional*. New York. Tërhequr më 5.10.2014 nga http://www.un.org/disabilities/documents/convention/crpd_albanian.pdf

- mungesa e plotë apo zënia nga të tjerët e parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar në afërsi të Kuvendit Komunal, Shtëpisë së Bardhë dhe objekteve të tjera publike;
- mungesa e plotë e ashensorëve, ose e ashensorëve funksionalë në shkolla, ndërtesën e Kuvendit Komunal, spital, etj.;
- tualetet e papërshtatshme (shumë të ngushta) për shfrytëzuesit e karrocave dhe shëtitoreve në shkolla dhe objekte të tjera publike;
- parkingjet shumë të ngushta për vozitësit shfrytëzues të karrocave;
- transporti publik urban dhe ndërrurban i paqasshëm për shfrytëzuesit e karrocave dhe mjeteve të tjera ndihmëse për lëvizje;
- mungesa e hapësirave të përshtatshme për përdorues të karrocës në shtëpi të kulturës;
- gjerësia e shkallëve në objektet publike jo e përshtatshme për shfrytëzuesit e shëtitoreve, patericave apo të shkopit të bardhë;
- sportelet dhe bankomatet të vendosura në lartësi të madhe për personat shtatshkurtër apo përdorues të karrocës;
- ndriçimi i dobët në lagje të caktuara, veçanërisht për personat me të pamur të dobësuar.

Barrierat institucionale – Kanë të bëjnë me politikat dhe praktikat që i diskriminojnë personat me aftësi të kufizuar. Këto barrierë mund të jenë: mungesa e legjislacionit, legjislacioni diskriminues, moszbatim i ligjit, mospërfshirja e nevojave të komunitetit të personave me aftësi të kufizuar në planet zhvillimore komunale, planifikim buxhetor pa objektiva që adresojnë nevojat e qytetarëve me aftësi të kufizuara, mosalokimi i mjeteve të mjaftueshme buxhetore për të mbështetur shërbimet për personat me aftësi të kufizuar, etj. Nga fokus grupet janë identifikuar këto barrierë institucionale:

- mungesa e zbatimit të legjislacionit relevant veçanërisht gjatë ndërtimeve të reja (Ligji Nr. 04/L-110 për Ndërtim, respektivisht Udhëzimi Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara);
- mungesa e transportit për fëmijët me nevoja të veçanta nga shtëpia deri në shkollë dhe anasjelltas (Ligji Nr. 04/L-032 për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës);
- mungesa e personelit profesional dhe mbështetës për arsimimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta;
- mungesa e buxhetit për ofrimin e shërbimeve të caktuara personave me aftësi të kufizuara (transportit, shëndetësore, komunale, etj.).

Barrierat në informim apo komunikim – Ndodhin atëherë kur personat me aftësi të kufizuar nuk mund ta kuptojnë informatën me lehtësi. Varësisht nga aftësia e kufizuar, personat komunikojnë duke përdorur mjete të ndryshme, si alfabeti i Braille, gjuha e shenjave, teksti me shtyp të madh, teksti në formatin e lexueshëm lehtë, etj. Disa nga këto barrierë të identifikuar janë:

- mungesa e informatave në autobusët e transportit publik dhe në stacione në alfabetin Braille për persona të verbër, në format të lexueshëm lehtë për personat me aftësi të kufizuara intelektuale, me shkronja të mëdha të shtypit për personat me pengesa në të pamur;
- mungesa e informacionit orientues në format të qasshëm në shtëpi të shëndetit, spital dhe gjetiu;
- mungesa e interpretit në gjuhën e shenjave për personat e shurdhër në institucionet për ofrimin e shërbimeve shëndetësore, komunale, etj.;
- mungesa e shenjëzimeve adekuate në vendet e caktuara nëpër spitale, e objekte të tjera publike.

Barrierat kulturore (të qasjes) – Janë ndër barrierat më të vështira për t'u njohur, për t'u adresuar dhe rëndom marrin afat kohor më të gjatë për t'u tejkaluar. Barrierat kulturore paraqesin normat dhe pritjet që individët kanë për personat me aftësi të kufizuara. Për shembull, të menduarit se personat me aftësi të kufizuara janë më inferiorë, apo supozimi se personi me pengesa në të folur nuk kupton. Këto ndjenja individuale, mendime dhe sjellje, bëhen veçanërisht problematike nëse janë tipar i punëtorëve që punojnë në ofrimin e shërbimeve, sepse ndikojnë në cilësinë e shërbimit që iu ofrohet personave me aftësi të kufizuara. Shembuj të këtyre barrierave të gjetura janë:

- zënia e parkingjeve të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara nga të tjerët me supozimin se nuk ka persona me aftësi të kufizuara vozitës të veturës;
- mospunësimi i personave me aftësi të kufizuara me paragjykimin se ata nuk dinë të punojnë, apo nuk janë punëtorë të mirë;
- bllokimi i hyrjes/pjerrinës në Kuvendin Komunal nga vetë punonjësit komunalë;
- mosfeksionimi i ashensorit për personat me aftësi të kufizuara;
- sjellja jo korrekte e disa punonjësve në shërbime publike ndaj personave me aftësi të kufizuara;
- ngacmimi i personave me aftësi të kufizuara nga qytetarët e tjerë.

Rekomandimet

Rekomandimet e përgjithshme:

- **Të përvetësohet qasja e bazuar mbi të drejtat e njeriut.** – Sipas kësaj qasjeje, qytetarët janë bartësit e të drejtave, ndërkaq autoritet e vetëqeverisjes lokale janë bartësit e detyrave për të siguruar këto të drejta. Të drejtat e njeriut, përfshirë të drejtën për arsim, shëndetësi dhe punësim, janë të drejta universale dhe të patjetërsueshme, që do të thotë se vetëqeverisja lokale duhet të sigurojë që shërbimet që i ofron janë të qasshme për të gjithë qytetarët e saj pa dallim.
- **Të përvetësohet qasja e “udhëve binjake” (“twin-track”).** – Kjo qasje nënkupton që autoritetet komunale duhet t'i adresojnë në të njëjtën kohë çështjet që e shqetësojnë komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, po edhe të sigurohen që veprimet që ndërmerren me qëllim të shërbimit të qytetarëve në përgjithësi (drejtpërdrejt nga komuna, apo kur kontrahohen kompani private me para publike), të jenë të qasshme edhe për qytetarët me aftësi të kufizuara.
- **Të rritet pjesëmarrja qytetare në bërjen e qytetit.** – Pjesëmarrja qytetare është një nga elementet bërthamë të qyteteve gjithëpërfshirëse, prandaj komuna duhet të sigurojë që strategjia e saj komunikuese me qytetarë t'i arrijë veçanërisht qytetarët e marginalizuar. Kjo nënkupton se përpjekjet e komunës duhen orientuar për të rritur pjesëmarrjen e qytetarëve me aftësi të kufizuara në të gjitha fazat nga informimi mbi të drejtat e tyre, organizimi i dëgjimeve publike të qasshme (gjuha, prezantimi vizuel apo audio, koha, vendi), realizimi i programeve dhe shërbimeve e deri te monitorimi dhe vlerësimi i tyre.
- **Të mundësohet qasja në të gjitha sistemet e zakonshme.** – Qytetarët me aftësi të kufizuara nuk janë më ndryshe nga qytetarët e tjerë, edhe ata shkojnë në shkollë, martohen, kanë familje, punojnë, paguajnë tatime, bëjnë pazar, votojnë, planifikojnë e ëndërrojnë. Kjo do të thotë që edhe ata i ndajnë të njëjtat brenga me qytetarët e tjerë, prandaj duhet të jenë pjesë e diskutimeve për të gjitha çështjet që i preokupojnë të gjithë qytetarët dhe duhet siguruar që shërbimet që kanë për qëllim publikun e gjerë të mos i përjashtojnë personat me aftësi të kufizuara.
- **Të sigurohet financim i duhur për shërbimet për personat me aftësi të kufizuara.** – Personat me aftësi të kufizuara mund të kenë nevojë për shërbime specifike, mbështetëse, rehabilituese, trajnuese e që mund të përmirësojnë jetën e tyre. Prandaj, gjatë përpilimit të planeve buxhetore

duhet marrë parasysh nevojat e këtij komuniteti, dhe duhet bërë një buxhetim/financim adekuat dhe të qëndrueshëm të shërbimeve publike për të shmangur barrierat financiare për qasje dhe për të siguruar ofrimin e shërbime cilësore.

- **Të aprovohet një strategji komunale për aftësi të kufizuar.** – Strategjia nacionale për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara në Republikën e Kosovës 2013-2023 ekziston dhe në përputhje me këtë strategji komuna duhet që, në bashkëpunim me palët e tjera të interesit, të hartojë dhe të adaptojë një strategji komunale për aftësinë e kufizuar, të përcjellë me një plan të detajuar të veprimit dhe me buxhet të duhur. Qytetarët me aftësi të kufizuara duhet të jenë në qendër të këtij procesi, përmes pjesëmarrjes së drejtpërdrejtë, apo përmes organizatave përfaqësuese.
- **Të involvohen personat me aftësi të kufizuara në zhvillimin e qytetit.** – Personat me aftësi të kufizuara duhet të involvohen dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në përpilimin e rregulloreve komunale, planeve strategjike dhe zhvillimore të komunës, si dhe në monitorimin e implementimit të tyre, përmes pjesëmarrjes në dëgjime publike, komitete, komisione dhe grupe të tjera punuese. Personat me aftësi të kufizuara kanë të drejtë kontrolli mbi jetën e tyre dhe duhet të konsultohen mbi çështjet që i preokupojnë ata drejtpërdrejt.
- **Të përmirësohen kapacitetet e burimeve njerëzore.** – Kjo mund të arrihet duke bërë edukimin, trajnimin dhe rekrutimin efektiv, që do të thotë se personeli i punësuar nga komuna, përfshirë edhe profesionistët e fushave të ndryshme, duhet të trajnohen lidhur me aftësinë e kufizuar dhe parimet e të drejtave të njeriut.
- **Të rritet vetëdijesimi publik dhe të kuptuarit për aftësinë e kufizuar.** – Për të realizuar një qytet dhe shoqëri gjithëpërfshirëse duhet të ekzistojë respekti dhe mirëkuptimi i ndërsjellë mes të gjithë qytetarëve, prandaj komuna duhet të angazhohet në përmirësimin e kuptimit të aftësisë së kufizuar nga pjesëtarët e tjerë të shoqërisë.
- **Të përmirësohet qasja dhe kualiteti i të dhënave për aftësinë e kufizuar, dhe të nxitet analiza dhe hulumtimi i këtyre të dhënave.** – Që të mund të bëhet një planifikim i mirëfilltë i intervenimeve në fushën e aftësisë së kufizuar në nivel komunal, komuna duhet të angazhohet në përmirësimin e bazës së të dhënave për qytetarët me aftësi të kufizuar, për intervenimet që ndërmerren në këtë fushë, dhe për progresin që po bëhet në implementimin e politikave.

Rekomandimet specifike në arsim:

- **Të krijohet një bazë e të dhënave për fëmijët me nevoja të veçanta në arsim që janë të përfshirë dhe të përjashtuar nga arsimi.** – Të dhënat për këtë bazë të të dhënave mund të mblidhen nga punëtorët arsimorë në institucionet parashkollore, shkolla dhe qendra burimore, qendrat për punë sociale, institucionet shëndetësore dhe organizatat joqeveritare të personave me aftësi të kufizuara. Të dhënat statistikore janë qenësore për të llogaritur shkallën e përjashtimit të fëmijëve me nevoja të veçanta nga sistemi arsimor dhe për të ndërmarrë masa për gjithëpërfshirjen e tyre në arsim.
- **Të hartohet një plan i veprimit për rritjen e qasshmërisë në arsim.** – Filloni me hartëzimin e qasshmërisë së shkollave, duke filluar nga vlerësimi i qasjes fizike (pjerrinat, tualetet, klasat, laboratorët), qasja në informacionin e ofruar (të folur, të shkruar) deri te qasja për pjesëmarrje aktive në procesin mësimor. Në bazë të të gjeturave dhe në bashkëpunim me komunitetin e personave me aftësi të kufizuara, ekspertëve në arsimin gjithëpërfshirës dhe palëve të tjera të interesit, krijoni një plan të veprimit për përmirësimin e qasjes në arsim. Fokusohuni në rritjen e gjithëpërfshirjes në shkollat e rregullta.

Rekomandimet specifike në shëndetësi:

- **Të eliminohen barrierat e qasjes në shërbimet shëndetësore.** – Në radhë të parë eliminojini barrierat fizike, duke siguruar parkingje të rezervuara për persona me aftësi të kufizuara në afërsi të institucioneve shëndetësore, pjerrina sipas standardeve, sipërfaqe taktile, ashensorë funksionalë, shenjzime adekuate vizuale dhe akustike. Ndërkaq duhet të angazhoheni edhe në eliminimin e barrierave në informim, duke prodhuar informacione në format të qasshëm, siç janë informacioni i thjeshtëzuar, shtypi i madh, alfabeti i Braille, interpretim në gjuhën e shenjave, videoinformacion në gjuhën e shenjave, audioincizime, etj.
- **Të rritet vetëdija e punëtorëve shëndetësorë dhe personelit tjetër për aftësinë e kufizuar.** – Kjo nënkupton ofrimin e trajnimeve dhe njohurive lidhur me kompetencën dhe vetëdijesimin lidhur me aftësinë e kufizuar dhe përgjegjësinë që kanë për të vepruar në përputhje me ligjin për shëndetësi dhe mosdiskriminim. Ky veprim kontribuon në eliminimin e barrierave kulturore (të qëndrimeve) ndaj aftësisë së kufizuar që ekzistojnë brenda sistemit të shëndetësisë. Për të krijuar një shërbim shëndetësor të qasshëm, është e nevojshme që të gjithë, nga roja e punëtori i mirëmbajtjes deri të infermierët dhe mjekët të reflektojnë këtë mendësi. Mjekët dhe infermierët, mund të kenë nevojë për trajnime shtesë sa i përket të kuptuarit dhe trajtimit të gjendjeve specifike që mund të lidhen me aftësi të caktuara të kufizuara.

Rekomandimet specifike në punësim:

- **Të krijohet një bazë e të dhënave të personave me aftësi të kufizuara që janë të interesuar për punësim** – Inkurajojini personat me aftësi të kufizuara që të regjistrohen me qendrën rajonale për punësim, për të krijuar një bazë të të dhënave të personave me aftësi të kufizuara, me kualifikimet dhe shkathtësitë e tyre. Për më tepër ofroni trajnime që do të përmirësonin mundësitë e tyre për punësim.
- **Të promovohet punësimi i personave me aftësi të kufizuara.** – Komuna mund të bëjë këtë duke qenë vetë punëdhënëse i personave me aftësi të kufizuara, duke ndërmjetësuar takimet mes punëdhënësve potencialë dhe personave me aftësi të kufizuara, duke promovuar tregimet e suksesit të personave me aftësi të kufizuara dhe punëdhënësve të tyre, duke ofruar informata për adoptimet që mund të bëhen në vende të punës me qëllim të rritjes së efikasitetit të personave me aftësi të kufizuara, etj.

VII. Të rinjtë dhe planifikimi urban në Prizren

Fëmijëria e hershme dhe nxënësit e shkollave fillore

Shkruar nga, Zana Sokoli

Përmbledhje ekzekutive

Çka e fuqizon më së shumti një komunitet, ku qytetarët e rëndomtë krijojnë vende më të mira, e transformojnë jetën e tyre dhe atyre që kanë pranë, duke zgjidhur në këtë mënyrë problemet e përditshme të jetës publike? Planifikimi gjithëpërfshirës është përgjigjja. Planifikimi ka filluar t’iu japë zë po ashtu fëmijëve dhe rinisë, grupe të cilat janë zakonisht të marginalizuara dhe të përjashtuara nga ky proces. Shpesh, planerët, qytetarët dhe të tjerë bartës të procesit të planifikimit kanë opinione stereotipa për kapacitetin që të rinjtë kanë për të qenë pjesëmarrës në ideimin e qyteteve të tyre.⁶⁸

Ndonëse të drejtat e fëmijëve për pjesëmarrje dhe gjithëpërfshirje garantohen dhe obligohen me konventa të shumta ndërkombëtare, zëri i tyre vazhdon të mos dëgjohet. Beteja më e madhe me të cilën ky grup ballafaqohet është padukshmëria. Fëmijët janë asgjë përderisa dikush s’i vë në pah vlerat e tyre, përderisa nuk vlerësohet prezenca e tyre në këtë shoqëri dhe përderisa dikush t’iu tregojë se janë të vlefshëm dhe mund të jenë kontribuues në jetën publike të vendit ku ata jetojnë. Planifikimi urban në radhë të parë është vizionim i qyteteve tona të ardhshme dhe e ardhmja janë pikërisht fëmijët të cilët 20 vite pas do të jenë bartësit kryesorë të zhvillimeve në vend. Rinia është potenciali më i madh që Kosova ka, është faktor kyç dhe katalizator i jashtëzakonshëm për ta orientuar zhvillimin e saj të qendrueshëm në ekonomi të dijes.

Në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, që realizohet me 7 grupe të ndryshme të komunitetit, mes tjerash janë zhvilluar edhe tri debate, ku në fokus të komunitetit të të rinjëve ka qenë fëmijëria e hershme dhe shkollat fillore.

Epilog i këtyre debateve janë shqetësime dhe brenga të shumta që fëmijët kanë për ambientin dhe lagjet ku jetojnë, shkollat ku mësojnë, vendet ku luajnë dhe relaksohen apo mënyrën dhe vështirësitë e lëvizjes që kanë brenda qytetit. Mbi të gjitha shqetësuese është mosdijenja e tyre për ekzistencën e planeve rregulluese në qytetin e Prizrenit. Megjithatë, krahas shqetësimeve, debatet kanë rezultuar edhe me rekomandime të shumta për adresimin e nevojave dhe kërkesave që fëmijët kanë, e që janë të përmbledhura në këtë raport.

Ky raport parasegjithash vë theksin mbi nevojën imediate të përfshirjes së të rinjëve në planifikim. Siç thekson edukatori George Wood, është jetike që rinia të kyçet në fazat e hershme të vizionimit në procesin e planifikimit. Sipas tij, procesi ideal i planifikimit realizohet atëherë kur:

- a) Rinia ka forma dhe mundësi të ndryshme për t’i shprehur çështjet që e brengosin
- b) Kur ata përjetojnë një vetëkënaqësi me faktin që kanë qenë pjesëmarrës në proces
- c) Ata e dijnë që kanë pasur ndikim në çështjet që janë qenësore në përmirësimin e kualitetit të jetës së komunitetit të tyre
- d) Ata bëhen partnerë të sinqertë të ‘ekspertëve’ të planifikimit.

⁶⁸ Youth Engagement in Planning, Ramona Mullahey - Tools and techniques, fq.6

Kur të arrihen këto qëllime, të rinjtë do të zhvillojnë ndjenjën e përkatësisë, shpirtin e tyre demokratik si qytetarë aktivë, e që rrjedhimisht do të ndikojë në përgjegjësi sociale për të mirën shoqërore, në të drejtën mbi qytetin.⁶⁹

Hyrje

“Qytetet kanë aftësinë për të siguruar diçka për të gjithë, vetëm sepse, dhe vetëm atëherë, kur ato janë të krijuara nga të gjithë” - Jane Jacobs

Për Michael Rodriguez, arsyeja kryesore se pse planerët zakonisht hasin në pjesëmarrje publike të dështuara qëndron në faktin se qytetarët nuk e mësojnë planifikimin dhe rregullat bazike të tij në shkollë. Sipas tij, nuk mjafton aftësia për të lexuar një hartë gjeografie. Fjalori i dizajnit që përfshin shkallën, ritmin, ecjen, apo fjalori social që përfshin mobilitetin, sensin e vendit, vlerat e komunitetit, apo barazinë, janë esenciale në procesin e planifikimit. Këto nuk janë koncepte që mësohen dhe kuptohen intuitivisht; shkollat tona e kanë për obligim të na i mësojnë.⁷⁰

Idetë e gjithëpërfshirjes ka gjysmë shekulli që promovohen dhe nxiten gjithandej nëpër botë. Pionierët e kësaj lëvizjeje si Kevin Lynch, Jane Jacobs, Jan Gehl e të tjerë dhe kontributi i tyre në këtë drejtim sot është pjesë përbërëse e programeve dhe platformave të organizatave të ndryshme botërore si UNESCO, UN-HABITAT etj; të cilat po tentojnë të krijojnë vizione për qytetet e së ardhmes të cilat dëgjohet zëri i gjithsecilit individ. E tillë është iniciativa “Qyteti për fëmijë - drejt qytetit që ne kemi nevojë”, nga UN-Habitat dhe World Vision International. Ajo çka tentohet përmes kësaj platforme interaktive është organizimi i asambleve të fëmijëve nga vende të ndryshme, ku ata me anë të metodave të kapshme për ta do të arrijnë t’i shfaqin idetë e tyre për qytete të barabarta për të gjithë. Për t’i prezantuar pikëpamjet e tyre në qytetin që ata e ëndërrojnë, fëmijët: a) **Do të vizatojnë**, ‘Qyteti i ëndrrave të mia’, b) **Do të debatojnë**, draftimi i një karte mbi dëgjimin e të drejtave të tyre dhe c) **Do të ndërtojnë një lagje**, duke përdorur Lego lodrat. Organizimi i këtyre asambleve që synohet të jetë i përvitshëm ka për qëllim t’iu japë përgjigje këtyre pyetjeve:

- Si mund t’iu japin fëmijët formë qyteteve të së ardhmes, në idenë e arritjes së qëndrueshmërisë urbane?
- Cilat janë mënyrat që zëri i tyre të dëgjohet dhe ata të jenë të përfshirë në procesin e planifikimit, në mënyrë që të rezultojmë me qytete më të barabarta?, dhe
- Cilat janë mesazhet kryesore që fëmijët bartin përmes këtyre debateve?⁷¹

Në anën tjetër është edhe organizata UNESCO, e cila promovon udhëzuesin ‘Të rritesh në qytete’, të inspiruar nga libri i Kevin Lynch, me po të njëjtin titull. Kjo organizatë konsideron se qytetet sot po dështojnë në përmbushjen e nevojave që fëmijët dhe familjet e tyre kanë. Udhëzuesi tenton të përgjigjet në pyetjet si:

- Si ndikon procesi i urbanizimit në jetën e të rinjëve?
- Për ta, çka e bën një lagje urbane vend të këndshëm për t’u rritur në të?
- A mund të jenë sot qytetet vende pozitive për të rinjtë - vende që e përkrahin dhe e ushqejnë zhvillimin e tyre konstruktiv, si kontribuues të ardhshëm të shoqërisë civile?

⁶⁹ Po aty

⁷⁰ Let's Teach Children Planning, <http://www.planetizen.com/node/40827> (qasur më 08.10.14)

⁷¹ <http://worldurbanforum7.org/Media/Default/PDF/Children's%20Assembly-eng-1.pdf> (qasur më 14.10.14)

Ky projekt është iniciativë globale që tenton rekrutimin e energjive, ideve, shpresës që të rinjtë kanë për të vlerësuar vetë situatën, për t'i definuar prioritetet e tyre dhe më e rëndësishmja për ta bërë ndryshimin! Gjithashtu promovon zbatimin e principeve të Habitat Agenda, Agenda 21, dhe konventën për të drejtat e fëmijëve.⁷² Vlen të përmenden edhe iniciativa tjera si 'Box City and Kids City', 'New York Academy of Urban Planning', 'The Garden Campaign – Urbana Youth etj.'⁷³ Është organizata Save the Children, në Kosovë, ajo që përmes fushatave si "Gjithëpërfshirja është e drejtë", thirrje për arsimim të fëmijëve me nevoja të veçanta, apo "Pjesëmarrja e fëmijëve", po tenton të sensibilizojë shoqërinë kosovare për rolin e fëmijëve në të ardhmen e qyteteve tona.

Situata aktuale

Në ligjin Nr. 04/L-174 për planifikim hapësinor në Kosovë, është neni 4 ai që përcakton parime si promovimin e interesave të përbashkëta të qytetarëve të Kosovës, promovimin e procesit demokratik të pjesëmarrjes publike dhe përfshirjen ndërsektoriale, apo sigurimin e qasjes publike në të gjitha dokumentet e planifikimit hapësinor.⁷⁴ Tutje është neni 11 i po këtij ligji që në përgjegjësi të autoritetit komunal për planifikim dhe menaxhim hapësinor vë edhe inkurajimin dhe sigurimin e pjesëmarrjes publike në procesin e hartimit dhe të zbatimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor. Gjithashtu parasheh njoftimin dhe shqyrtimin publik të planeve para se ato të finalizohen.⁷⁵ Në anën tjetër, në nivel komunal është ligji NR. 03/L-040 për vetëqeverisje lokale ai që në nenin 45 të tij përcakton se takimet e kuvendit të komunës dhe të gjitha komisioneve të tij janë të hapura për opinion. Anëtarëve të publikut u lejohet pjesëmarrja në takime.⁷⁶ Megjithatë, nga analizat dhe debatet në kuadër të projektit 'Qyteti Gjithëpërfshirës' të organizatës EC Ma Ndryshe, situata në Prizren del të jetë shqetësuese. Gjysma e qytetarëve nuk kanë dijeni se komuna ka plane urbane, 60% e tyre nuk e dinë që mund të marrin pjesë në debate publike, kurse nga hulumtimet del se vetëm 14% e tyre kanë pranuar ftesën për debat publik dhe vetëm 12.6% e tyre janë deklaruar se kanë marrë pjesë në ndonjërin prej tyre.⁷⁷

Grupi i të rinjëve që është në fokus të këtij raporti, konkretisht fëmijët e shkollave fillore të Prizrenit janë deklaruar në kuadër të debateve me ta, se nuk kanë fare njohuri se si duket dhe çka përmban një plan rregullues. Ata madje nuk kanë qenë në dijeni as për ekzistencën e këtyre planeve dhe të drejtën që kanë për t'u përfshirë në hartimin e tyre. Vazhdon të jetë ekzekutivi ai që përcakton nevojat e të rinjëve prizrenas, çka dëshmon për mospërfillje totale të këtij grupi të ndjeshëm të komunitetit. Deri më tash, mënyra se si ky grup i marginalizuar i shoqërisë i ka shprehur shqetësimet dhe nevojat e veta në raport me qytetin e Prizrenit, ka qenë duke marrë pjesë në analiza dhe hulumtime kryesisht të organizatave joqeveritare. Në studimin e EC Ma Ndryshe, për perceptimin e qytetarëve të Prizrenit mbi çështjet e urbanizmit, janë një mori çështjesh që e shqetësojnë rininë prizrenase. Me theks të veçantë mungesa e hapësirave rekreative e kulturore, bllokimi i trotuareve nga makinat, mungesa e hapësirave të gjelbëruara në qytet, ndërtimet pa leje, çerdhet për fëmijë, mungesa e parqeve publike, etj.⁷⁸ Aktualisht sfidat më të mëdha në relacion me të rinjtë janë gjetja e metodave të duhura që përfshirja e tyre të jetë efikase. Ndonëse mospjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes është produkt që lidhet direkt me

⁷² <http://www.heartfoundation.org.au/SiteCollectionDocuments/Dr-Karen-Malone-Child-friendly-cities.pdf> (qasur me 15.10.14)

⁷³ Youth in Action: The Incorporation of Urban Youth in Planning-Related Practices, May, 2011

⁷⁴ Ligji Nr. 04/L-174, PËR PLANIFIKIMIN HAPËSINOR, fq.5

⁷⁵ Po aty, fq.13

⁷⁶ LIGJI NR. 03/L-040 PËR VETËQEVERISJEN LOKALE, fq.15

⁷⁷ EC Ma Ndryshe, Planifikim urban për qytetarët 2 fq.25

⁷⁸ Studim mbi perceptimin e qytetarëve të Prizrenit mbi çështjet e urbanizmit_Qershor 2014 , fq.19

mentalitetin e shoqërisë dhe politikës aktuale në Prizren, komuna nuk duhet të shihet si e vetmja përgjegjëse. Përshfshirja e planifikimit në programet shkollore, aktivitetet extra-kurrikulare, punëtoritë e ndryshme në bashkëpunim Komunë-Shkollë-OJQ, ngritja e problemeve nga këshillet e nxënësve, si dhe përfaqësimi i tyre më i zëzhëm nga Këshilli i Veprimit Rinor Lokal, janë sfidat dhe njëkohësisht alternativat e mundshme, që në rast të funksionimit paralel do të luanin rol qenësor në avokimin e të drejtave që fëmijet kanë. Përderisa synohet gjithëpërfshirja, zyrtarët komunalë, planerët e urbanistët nuk duhet të kenë frikë që idetë dhe kreativiteti i të rinjve do të sfidojë kreativitetin e tyre. Përkundrazi, planifikimi është gjithëpërfshirje dhe përjashtimi i cilitdo grup të komunitetit nga procesi, është cenim i të drejtës themelore që ata kanë për qytetin ku jetojnë.

Të gjeturat

Praktika e mospërfshirjes së qytetarëve në procesin e planifikimit urban prodhon plane që nuk e reflektojnë situatën në terren, nuk i përmbushin nevojat e qytetarëve dhe gati gjithnjë janë jashtë kapacitetit realizues të qeverisë lokale. Është EC Ma Ndryshe ajo që përmes aktiviteteve të saj në qytetin e Prizrenit angazhohet të ridefinojë raportin e qytetarit me qytetin. EC-i konsideron se qyteti na takon të gjithëve, ne së bashku jemi përgjegjës për të dhe ndërtimi e funksionimi i tij duhet të bëhet mbi parimet e demokracisë. Në mesin e grupeve të komunitetit me të cilat punohet, hapësirë e veçantë u është dhënë gjithashtu të rinjve, kësaj here fëmijërisë së hershme dhe shkollave fillore. Duke qenë se fëmijët për moshën dhe shkollimin aktual që kanë nuk janë në gjendje ta kuptojnë procesin e planifikimit me gjithë kompleksitetin e tij, metodologjia e punës me ta ka qenë e bazuar në një plan lehtësues, me informata e pyetje ndihmëse, në mënyrë që ata të jenë të fokusuar në atë që është diskutuar.

EC Ma Ndryshe në kuadër të projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës...” i ka përfshirë të rinjtë në hulumtimin përmes anketimit dhe në tri fokus grupe të realizuara në periudha të ndryshme kohore gjatë vitit 2014. Në studimin e EC Ma Ndryshe për perceptimin e qytetarëve të Prizrenit mbi çështjet e urbanizmit, 48.4% e të rinjve deklarohen të kenë shqetësimin kryesor mungesën e hapësirave rekreative, 41.8% e tyre shfaqin shqetësim për bllokimin e trotuareve nga makinat, kurse 35.2% i brengos mungesa e hapësirave kulturore.⁷⁹

Në kuadër të debateve me fokus grupet, shqetësimi më i madh del të jetë mosdijenja e tyre për ekzistencën e planeve rregulluese në qytetin e Prizrenit. Në vijim do të paraqiten problemet dhe nevojat kryesore, që janë ngritur nga ky grup i të rinjve:

Infrastruktura rrugore/shkollore dhe siguria publike

- Ndërtimi i objekteve të reja shumëbanesore në afërsi të rrugës paraqet rrezik me rastin e ngushtimit të trotuareve duke privuar nxënësit nga lëvizja e lirë e tyre për në shkollë.
- Kufizimi i lëvizjes së nxënësve në të gjitha shkollat nga bllokimi me makina i trotuareve dhe hapësirave pranë e brenda shkollës.
- Mungesë e semaforëve (p.sh. te Tregu i Gjellbër dhe Q.Sportive ‘Sezai Surroi’), apo mosfunksionimi adekuat i tyre (tek qendra MiniMax).
- Tarifat e larta të transportit lokal të papërballueshme për rininë, paumndësia e ngasjes së biçikletave në mungesë të korsisë dhe vendparkimeve në pikat kyçe të qytetit.
- Mungesa e ndriçimit publik dhe prania e qenëve endacakë është shqetësim i madh, e sidomos për nxënësit që vijojnë mësimin në ndërrimin e tretë të ditës.

⁷⁹Perceptimet e qytetarëve mbi çështjet e urbanizmit në Prizren 1, OJQ EC Ma Ndryshe fq.19

- Siguria e ulët në ambientet shkollore, mungesa e shenjave për dalje emergjente, mospërdorimi i uniformave shkollore, mungesa e shkallëve emergjente dhe pjerrinave për personat me nevoja të veçanta.
- Mungesa e infrastrukturës mësimore (laboratorët e kimisë, biologjisë, gjuhës angleze, TIK dhe hartat e gjeografisë) janë mungesë pothuajse e secilës shkollë në Prizren.
- Prania e hapësirave të gjelbërta në shkolla, por mostrajtimi i tyre adekuat i pamundëson nxënësit ta shfrytëzojnë oborrin gjatë pushimeve të gjata që kanë.
- Infrastruktura e dëmtuar shkollore me theks të veçantë në toaletet e shkollave.
- Mungesë bashkëpunimi i KVRL-së me shkollat përkatësisht përfaqësuesit e shkollave fillore e të mesme në Prizren.

Ambienti

- Fëmijët konsiderojnë se Prizreni është qytet 50% i papastër, pikërisht nga moskujdesi i qytetarëve. Kjo shkakton edhe ndotjen e lumit, parqeve dhe hapësirave të tjera publike të qytetit. Përtej kujdesit është edhe mungesa e konteinerëve gati në tërë lagjet e qytetit që i detyron fëmijët t'i hedhin mbeturinat në vende joadekuate.
- Ndërtimet e reja shumëbanesore të ndërtuara pa kritere, rezultojnë me mungesë të hapësirave gjelbëruese dhe rekreative. Afërsia mes vete privon edhe depërtimin e rrezeve të diellit nëpër banesat e qytetarëve, çka rezulton me mungesë të vitaminës D tek fëmijët sidomos.
- Lagjet si “Rexhep Kabashi”, “Ortakoll”, “Rambuqe” apo rrugët “Ismet Jashari Kumanova”, “Nexhat Matranci” etj, karakterizohen për mungesë të hapësirave të mirëfillta gjelbëruese, rekreative e parqe publike. Ndotja akustike, pluhuri e papastërtia e madhe kanosin shëndetin e fëmijëve që e kalojnë kohën e tyre të lirë në këto lagje. Lagja “Arbana” është lënë në harresë nga komuna, rruga e paasfaltuar, ka mungesë kanalizimi dhe menaxhim të dobët të mbeturinave.
- Parqet ekzistuese në qytet nuk mirëmbahen, ka mungesë ndriçimi dhe lojrat nuk mund të shfrytëzohen nga fëmijët, ngase janë të dëmtuara.
- Dita e pazarit në Prizren çrregullon funksionimin normal të qytetit çdo javë, në mungesë të një hapësire të veçantë ku shitësit do të mund të vendoseshin. Kaosi në komunikacion, era e pakëndshme, bllokimi i trotuareve e mbeturinat e mbetura janë vetëm disa nga detajet që përtej ambientit, demtojnë edhe imazhin e qytetit.

Shëndetësia

- Në shkollat pjesëmarrëse të fokus grupeve, shkolla “Emin Duraku”, “Lidhja e Prizrenit” dhe “Lekë Dukagjini” evidentohet mungesa e mjekëve në fusha të ndryshme shëndetësore. Nxënësit kërkojnë praninë e stomatologut në shkolla, si dhe praninë e domosdoshme të psikologut, i cili do t'i dëgjonte brengat e tyre atëherë kur ato nuk mund të trajtohen nga stafi mesimor. Mjekët në shkolla do të evitonin po ashtu humbjen e orëve mesimore nga nxënësit, që trajtimin mos ta kërkojnë jashtë shkollës.

Kultura dhe Sporti

- Kërkesa themelore e të rinjve prizrenas është ruajtja e trashëgimisë kulturore dhe vetëdijesimi më i madh qytetar për vlerën që ajo ka. Ata kanë shfaqur shqetësim të vazhdueshëm për degradimin që po i bëhet qytetit dhe mbrojtjen joadekuate që po u bëhet monumenteve me vlerë.
- Infrastruktura teknike dhe pajisjet në shkollat e muzikës janë të mangëta (mungojnë instrumentet muzikore, kabinetet e muzikës, sallat e baletit, kompjuterët etj).
- Kinemaja ‘DokuKino’ ka çmim të lartë e të papërbalueshëm për xhepin e fëmijëve.

- Të rinjtë kërkojnë me doemos korsi biçikletash, për të rritur numrin e përdoruesve aktual dhe për t'i mbrojtur ata nga aksidentet e mundshme në komunikacion.
- Kërkojnë ndërtimin e një pishine olimpike, e cila aktualisht i mungon qytetit të Prizrenit.
- Terreneve sportive u mungon ndriçimi që e pamundëson shfrytëzimin e tyre natën. Po ashtu u mungon edhe inventari sportiv.

Rekomandimet

Gjithnjë duke u bazuar në të gjeturat e këtij raporti, të cilat janë rezultat i një procesi njëvjeçar intensiv e bashkëpunues me fëmijët dhe përfaqësues të tjerë të shoqërisë dhe institucioneve, në vijim jepen rekomandime konkrete të cilat do të shërbejnë si udhëzues për qeverinë lokale që në hartimin dhe zbatimin e planeve urbane ta ketë edhe komponenten rini.

- Nga praktikat e qyteteve të tjera, planifikimi urban ka rezultuar i suksesshëm atëherë kur zëri i freskët i fëmijëve dhe grupeve tjera të marginalizuara është dëgjuar. Fëmijët duhet ta njohin të drejtën e tyre për pjesëmarrje në procesin e planifikimit. Duke qenë se janë të rinj në moshë, komuna duhet të ofrojë forma alternative të bashkëpunimit me ta, në mënyrë që rezultatet të jenë frytëdhënëse dhe konsultimi me ta të mos jetë vetëm formalitet. Vizionimi i qyteteve do të mund të realizohet nëpër vetë shkollat e qytetit. Punëtori, konkurse, vizatime e shkrime të shumta nga nxënësit mund të nxejrrin në dritë vizionin e ardhshëm të qytetit të Prizrenit.
- Përfshirja e planifikimit urban në kurrikulat shkollore. Kompleksiteti i këtij procesi duhet të fillojë të zërthehet që në fëmijëri me forma dhe metoda të kapshme për fëmijët. Propozohet të ndiqen praktikat dhe udhëzues tashmë të suksesshme nga organizata të ndryshme botërore të cekura në këtë raport.
- Ruajtja e trashëgimisë kulturore të Prizrenit. Komuna duhet t'iu kushtojë kujdes ndërtimeve të reja, të parandalohet degradimi i qytetit dhe të shmanget kaosi urbanistik, sëmundje që ka përfshirë pothuajse të gjitha qytetet kosovare. Bëhet po ashtu thirrje që kur shkollat të organizojnë ekskursione ta kenë parasysh përpilimin e një agjende të mirëfilltë për vizitimin e objekteve dhe vlerave tjera kulturore të një qyteti. Kjo ndikon që nxënësit përveç që e njohin vendin dhe pasurinë që ai posedon, po ashtu i bënë ata më të përgjegjshëm ndaj tij, duke rritur edhe ndjenjën e përkatësisë.
- Të krijohen bashkësi lokale nëpër lagje është shumë e nevojshme dhe e gjithë kjo do të lehtësonte paraqitjen e problemeve dhe kërkesave të lagjes, në këtë rast të komunitetit të të rinjve të përfaqësuesi i bashkësisë lokale ose lagjes.
- Gjelbërimi i qytetit, veçanërisht i hapësirave të gjelbërta brenda shkollave, brenda lagjeve dhe përmiresimi i kushteve në parqet aktuale të qytetit. Hapësirat publike janë të pranishme brenda qytetit megjithatë shfrytëzimi i tyre vihet në pikëpyetje. Debate me banorët dhe fëmijët e lagjeve për të shikuar mundësitë e krijimit të hapësirave rekreative. Arkitektët, artistët e të tjerë profesionistë të thirrur në këtë lëmi, e kanë për obligim që t'i vetëdijësojnë qytetarët se si një hapësirë publike e lënë pas dore mund të rifunksionalizohet.
- Mirëmbajtja e Lumbardhit dhe hapësirave të tjera publike në qytet. Pastrimi i lumit vetëm një herë gjatë vitit konsiderohet i pamjaftueshëm. Përveç pajisjes me kotejnerë, po ashtu kërkohet vetëdijësim i qytetarëve për mbrojtje të ambientit.
- Konfiskimi i makinave, apo dënimi me gjobë i të gjitha makinave që parkohen në trotualet në afërsi të shkollave apo kudo tjetër në qytet.
- Nevoja e menjëhershme për korsi biçikletash. Lëvizja më e madhe me këtë mjet transportues ekologjik do të ndikonte në shëndetin e qytetarëve dhe do të dekurajonte përdorimin e makinave. Natyrisht e gjithë kjo rezulton me mbrojtjen e ambientit.

- Të krijohen rregulla të reja sa i përket transportit urban, duke i pasur parasysh çmimet e biletave për nxënësit/studentët dhe krijimin e biletave mujore ose semestrare për ta.
- Të ofrohen çmime të përbalueshme për nxënësit dhe studentët në kinemanë e qytetit dhe në të tjera aktivitete kulturore.
- Qytet i qasshëm dhe në shërbim të të gjithëve, pra ofrimi i kushteve adekuate për personat në nevoja të veçanta, sidomos përmirësimi i qasjes së tyre në objektet publike, në rastin konkret nëpër shkolla.
- Zgjidhje e menjëhershme e problemit me qentë endacakë. Nxënësit e ndërrimit të tretë nëpër shkolla janë në rrezik konstant nga bredhja e lirë e qenve.
- Të gjitha shkollat fillore në Prizren të kenë mjekun e përgjithshëm, stomatologun dhe psikologun e tyre.
- Aktivizimi i këshillave të nxënësve në shkolla, si mënyra më e mirë e vënies në pah të problemeve të shkollës dhe e artikulimit tek organet komunale. Funksionimi i mirëfilltë i këtyre këshillave është një shtytës që zëri i nxënësve të dëgjohej dhe artikulohej dhe në fund ky zë t'i vihet në dijeni jo vetëm organeve gjegjëse komunale, por edhe menaxhmentit më të lartë në Komunës.
- Bashkëpunim mes nxënësve dhe Policisë Rajonale të Prizrenit në raportimin e rasteve kur nxënësit konsumojnë dhe janë në posedim të duhanit dhe lëndëve tjera narkotike. Po ashtu rekomandohet menaxhim më i mirë i hapësirave përreth shkollave, largimi i kioskeve pa leje që shesin cigare dhe mbyllja e lokaleve në afërsi të shkollave të cilat ofrojnë vido-lojra e që ndikojnë në mungesën e nxënësve në mësim.
- Paisja e shkollave me infrastrukturë të duhur për funksionimin normal të mësimin (Laboratorët e kimisë, biologjisë, gjuhës angleze, TIK, instrumentet muzikore, sallat e baletit, sallat e sportit) etj.
- Bashkëpunimi i shkollës teknike me shkollat e tjera, komunitetin dhe komunën, për prodhimin e shportave të mbeturinave, parkingjeve për biçikleta, etj. me gjysëmçmimi. Ky aktivitet do t'i ndihmonte edhe shkollës edhe komunitetit, ndërsa edhe komuna do të shpenzonte më pak për investime të njëjta. Gjithashtu nxënësit do të ndiheshin krenarë për kontributin e tyre në të mirën e qytetit.
- Siguria e nxënësve në shkolla duhet të mbështetet te Policia e Kosovës, e cila duhet të ofrojë sigurinë publike që nxënësit e kanë nevojë. Assesi të mos detyrohen nxënësit të paguajnë për sigurinë e tyre.
- Paisja me ndriçim dhe inventar sportiv e të gjitha terreneve sportive në qytet. Po ashtu ndërtimi i një pishine olimpike të qytetit.
- Përmirësimi i funksionimit të të gjithë semaforëve të dëmtuar në qytet dhe vendosja e semaforëve të rinj sidomos në pikat të cilat më së shumti i frekuentojnë nxënësit në rrugën e tyre shtëpi-shkollë (tek Tregu i Gjelbër dhe Q.Sportive 'Sezai Surroi', te qendra MiniMax).
- Caktimi i një lokacioni të ri ku do të vendoseshin shitesit ambulantë, në mënyrë që të largohen nga rruga gjatë ditës së pazarit. Pajisja me infrastrukturën e duhur për funksionim normal të këtij tregu.

VIII. Lagjet e varfra/vendbanimet joformale dhe planifikimi urban në Prizren

Lagja Tusuz, Prizren

Shkruar nga, Nol Binakaj

Përmbledhje ekzekutive

Komunitetet që banojnë në vendbanimet joformale janë të marginalizuar sa i përket pjesëmarrjes në vendimmarrje. Nuk janë mjaft të përfshirë në vendimet e nivelit lokal për politikën zhvillimore që ndikojnë në komunitetin e tyre, apo vetëm janë të informuar për vendimet. Kjo qasje vlerësohet vetëm si përpjekje simbolike për t'i përmbushur kërkesat ligjore, pa krijuar mundësi që, nëpërmjet mekanizmave të përfshirjes, komuniteti të paktën të negociojë apo të bëjë kompromise për politikën zhvillimore që, në fund të fundit, hartohen për vetë komunitetin.

Për një proces të mirëfilltë të rregullimit urban, padyshim se komuniteti duhet të jetë pjesë e procesit që nga fillimi. Pjesëmarrja aktive e komunitetit është çdo proces në të cilin, nëpërmes përfshirjes dhe marrjes së informatave nga ata, arrihet deri te vendimmarrja, apo zgjidhja e problemit. Ky proces njëkohësisht cilësohet si informim, edukim, konsultim, pjesëmarrje dhe bashkëpunim që rezultojnë në përfshirjen e interesave të grupeve të veçanta, vlerave që ata i çmojnë dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e kushteve elementare në politikën për rregullim.

Në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, në lagjen “Tusuz”, u zhvilluan debate me grupe të ndryshme të interesit, në të cilat janë trajtuar tematikat dhe problemet, si dhe janë identifikuar mundësitë/prioritetet rreth planifikimit urban. Problemet kryesisht kanë të bëjnë me informalitetin e vendbanimit, mungesën e ujit të pijshëm, mungesën e rrjetit të kanalizimit, probleme me mungesat nga më bazike deri tek ato të cilat kanë të bëjnë me rritjen e mirëqenies së qytetarëve si shërbimi apo përkujdesja shëndetsore, arsimore, mungesa e hapësirave për rekreim, mungesa e ndriçimit publik dhe sigurisë së banorëve në përgjithësi.

Mënyra e rekomanduar e përmirësimit të gjendjes ekzistuese në lagjen “Tusuz” duhet të bazohet në përmirësimin, zhvillimin e infrastrukturës dhe përmirësimin e shërbimeve ekzistuese. Përparësi e kësaj qasjeje të trajtimit është se nuk e shqetëson jetën sociale dhe ekonomike të komunitetit. Vlerësohet lart dhe është më se e domosdoshme pjesëmarrja aktive e komunitetit në procesin e përmirësimit të vendbanimit, ndërkaq komuna duhet të fokusohet në legalizimin e ndërtimeve pa leje, përmirësimin e kushteve mjedisore, sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të infrastrukturës, shtimit të hapësirave publike, krijimit të qasjeve në shërbimeve bazike publike si shkollat, transporti publik, menaxhimin e mirë të mbeturinave, furnizimin me ujë, telefon, internet.

Hyrje

Për një proces të mirëfilltë të rregullimit urban, padyshim se komuniteti duhet të jetë pjesë e procesit që nga fillimi. Pjesëmarrja aktive e komunitetit është çdo proces në të cilin nëpërmes përfshirjes dhe marrjes së informatave nga ata arrihet deri te vendimmarrja apo zgjidhja e problemit. Ky proces njëkohësisht cilësohet si informim, edukim, konsultim, pjesëmarrje dhe bashkëpunim që rezultojnë në përfshirjen e interesave të grupeve të veçanta, vlerave që ata i çmojnë dhe sugjerimet e tyre për përmirësimin e kushteve elementare në politikën për rregullim.⁸⁰

⁸⁰ Doracak për përfshirjen e komunitetit në procesin e rregullimit të vendbanimeve joformale, MMPH, 2013

Pjesëmarrja e komunitetit në vendimmarrje përveç se është kërkesë ligjore, ndikon në ngritjen e kualitetit të vendimeve, shton përgjegjësinë si të autoriteteve lokale, poashtu edhe të vetë komunitetit në zbatimin e vendimeve, si dhe ndikon në arritjen e një qeverisje të mirë dhe transparente. Pjesëmarrja e komunitetit kontribuon në vendime më të mira dhe racionale, sepse vendimmarrësit janë të informuar për problemet, faktet, vlerat dhe pikëpamjet e publikut, posaçërisht kur kemi të bëjmë me trajtimin e vendbanimeve joformale. Vendimet apo planet e hartuara në këtë mënyrë janë reale dhe të zbatueshme, por edhe të matshme. Si rezultat i pjesëmarrjes së publikut çdo vendim është legjitim dhe i përkrahur dhe ka më pak mundësi të kundërshtohet nga publiku në fazën e implementimit.

Në vijim janë të përmendura disa nga rastet dhe modele të mira të cilat kanë rezultuar me zgjidhje konkrete për grupe të ndryshme të interesit. Këto modele janë aplikuar në shtete të rajonit dhe ato përfundimtare dhe duke pas parasysh kontekstin kosovar janë lehtë të implementueshme.

Shqipëri – Planifikimi lokal pjesëmarrës

Projekti i programit të përbashkët të KB-së “Fuqizimi i Komuniteteve të Ndjeshme Lokale në Shqipëri” synon të promovojë siguri njerëzore në mes të komunitetit RAE. Projekti është zbatuar nga autoritetet lokale të rajoneve të Durrësit, Elbasanit, Fierit dhe Tiranës në bashkëpunim me programin e përbashkët të KB-së.⁸¹

Planifikimi pjesëmarrës përbën një ndër tri komponentet e projektit. Si pjesë e procesit të planifikimit pjesëmarrës është themeluar një grup këshillues i përbërë nga komuniteti RAE, në grup ka pasur përfaqësim të balancuar gjinor. Detyra e grupit ka qënë identifikimi dhe priorizimi i nevojave lokale. Komunikimi në mes të grupit dhe nivelit lokal është bërë duke shfrytëzuar një person të moshuar. Problemet dhe prioritetet janë përfshirë në planin lokal zhvillimor dhe zbatimi i tyre është bërë në bashkëpunim me programin e KB-së. Projektet e dala nga këto prioritete janë rrugët, sistemet e kanalizimit dhe infrastruktura sociale. Kjo qasje aktualisht është duke u zgjeruar edhe në rajonet e tjera të Beratit, Korçës e Vlorës dhe financohet nga projekti i Unionit Europian “Përfshirja sociale e Komunitetit RAE në Shqipëri”.

Mali i Zi – hartimi i planeve lokale të veprimit për integrimin e komunitetit RAE

Hartimi i planeve lokale të veprimit për komunitetin RAE është inicuar nga OJQ Pocetak në Nikshiq në vitin 2007, duke mbledhur të dhëna me ndihmën e një eksperti dhe ka vazhduar në Herceg Novi dhe Tivat nga OJQ Mladi Romi në bashkëpunim me nivelin lokal. Plani në Nikshiq është mbështetur financiarisht nga ambasada e SHBA-ve në Podgoricë dhe planet në Tivat dhe Herceg Novi janë mbështetur nga Fondacioni Instituti për Shoqëri të Hapur.

Komuna Berane, Bijelo Polje, dhe Ulqin në vitin 2012 kanë themeluar grupet punuese të përbëra nga komunitetet RAE, stafit të administratës lokale, edukimit, shëndetësisë, mirëqenjes sociale dhe planifikimit urban. Detyrë e grupit punues ka qënë hartimi i planeve të veprimit lokal bazuar në përvojën e komunave të Tivatit, Herceg Novit dhe Nikshiqit.

Tsenkova, S., 2008. In Search for Sustainable Solutions for Informal Settlements in the ECE Region: Challenges and Policy Responses. Economic Commission for Europe, *Committee on Housing and Land Management*, Geneva, 22-23 September 2008.

⁸¹ Doracac për përfshirjen e komunitetit në procesin e rregullimit të vendbanimeve joformale, MMPH, 2013

Austri – Vjenë “Gratë-Puna-Qyteti”

Në kontekstin e zgjerimit të zonës urbane, në Vjenë është pilotuar me një pjesë të periferisë së qytetit, ku krahas punës me gra dhe femra, analizës së nevojave të tyre për zhvillimin sa më të lehtë të aktiviteteve të përditshme, elementet e planifikimit dhe dizajnit urban janë hartuar nga gratë eksperte të kësaj fushe.

Objektivi kryesor i kësaj qasjeje ka qenë në shndërrimin e aspekteve të shumanshme të jetës së përditshme të grave në kriter thelbësor të planifikimit dhe dizajnit. Për më tepër, angazhimi i arkitekteve për këtë projekt është motivuar nga pritjet që jeta e përditshme e tyre komplekse – e që është e ndryshme nga e burrave – të reflektojë pozitivisht në dizajnet e tyre.

Kjo qasje ka rezultuar në planifikim të mirëfilltë, që i ka mundësuar grave lehtësim të aktiviteteve të tyre të përditshme, duke filluar nga shkurtimi i rrugës për në stacionin e autobusëve, integrimin e funksioneve komplementare si qerdhe dhe qendër të mjeksisë familjare në afërsi, apo në vetë bllokun e banimit, parqe me qasje të lehtë dhe pa barriera. Gjithashtu është përmirësuar siguria në lagje duke investuar në ndriçimin publik dhe në shumë pjesë tjera të vendbanimit që më parë janë cilësuar si investime të panevojshme.⁸²

Situata aktuale

Vendbanimet joformale janë mjaft të përhapura në komunat e Kosovës. Ekzistojnë lloje të ndryshme të vendbanimeve joformale, mirëpo karakterizohen kryesisht me posedim joformal dhe jo të sigurt të pronës, qasje joadekuate në shërbimet themelore, mungesë të infrastrukturës fizike dhe sociale. Bazuar në hulumtimin e bërë nga Planet hapësinore dhe urbanistike të miratuara deri më tani si dhe rezultateve të puntorive regjionale për identifikimin e Vendbanimeve Joformale me komunat e Kosovës, janë identifikuar 174 vendbanime joformale.⁸³

Komunitetet që banojnë në vendbanimet joformale janë të marginalizuara sa i përket pjesëmarrjes në vendimmarrje. Nuk janë mjaft të përfshirë në vendimet e nivelit lokal për politikat zhvillimore që ndikojnë në komunitetin e tyre, apo vetëm janë të informuar për vendimet. Kjo qasje vlerësohet vetëm si përpjekje simbolike nga autoritetet lokale për të përmbushur kërkesat ligjore, pa krijuar mundësi që nëpërmjet mekanizmave të përfshirjes, komuniteti të paktën të negociojë apo të bëjë kompromise për politikat zhvillimore që, në fund të fundit, hartohen për vetë komunitetin. Gjithashtu deri më tani vërehet mungesa e një strategjie të unifikuar dhe udhërrëfyesi për inkuadrimin e komunitetit në procesin e planifikimit.

Në kuadër të rregullimit dhe zhvillimit të vendbanimeve joformale ekzistuese njëra ndër sfidat kryesore është kompletimi i legjislacionit me anë të hartimit të ligjeve dhe udhëzimeve administrative në mënyrë që të orientohet tregu i tokës si dhe të kontribuohet në zhvillimin kompakt të vendbanimeve. Aprovimi i Ligjit për Legalizimin e Ndërtësive pa Leje Ligji Nr. 04/L-188, i cili tashmë është miratur dhe, së bashku me udhëzimet administrative, cilësohet si një nga ligjet kryesore me anë të së cilës do të mundësohej rivlerësimi dhe kategorizimi i këtyre zonave dhe strukturave ekzistuese në to, si dhe krijimi i mundësive të zhvillimit nëpërmjet planifikimit të mirëfilltë, gjithmonë duke pasur parasysh kërkesat e komuniteteve. Një nga sfidat kryesore në nivelin komunal është implementimi i Ligjit për Planifikim

⁸² Frauen-Werk-Stadt - A Housing Project by and for women in Vienna Austria, <http://www.unesco.org>

⁸³ Strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale në Kosovë, MMPH 2010

Hapësinor Ligji Nr. 04/L-174, gjegjësisht harmonizimi i planeve të draftuara me kërkesat e ligjit të ri, revidimet e Planeve Zhvillimore Komunale dhe krijimin e hartave zonale, me anë të së cilës evidentohen zonat informale si prioritare për trajtim.

Nevojë imediate është përpilimi i profileve dhe krijimi i bazës së të dhënave për vendbanimet joformale nga komuna në mënyrë që të përcaktohen vendbanimet prioritare për rregullim. Rrjedhimisht, nga këto të dhëna do të paraqitet mungesat e infrastrukturës fizike dhe sociale në vendbanimet joformale, si bazë për hartimin e programeve komunale dhe parashikimin e buxhetit për përmirësimin e këtyre kushteve.

Të gjeturat

Në kuadër të projektit “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, në lagjën “Tusuz”, u zhvilluan debate me grupe të ndryshme të interesit, në të cilat janë trajtuar tematikat dhe problemet dhe mundësitë rreth planifikimit urban. Gjithsej u organizuan 7 diskutime me banorë me tematika të ndryshme, prej nga dolën problemet dhe kërkesat të cilat do të duhej të merren parasysh në fazën e planifikimit, e që njëherit paraqesin edhe pasqyrën e problemeve të të gjithë banorëve të Prizrenit, refleksion i dhënë gjatë anketës së zhvilluar me qytetarë:

Mungesa e ujit të pijshëm në lagje

Problemi më i theksuar, i shumëpërfolur dhe ende i pazgjidhur mbetet uji i pijes për banorët e kësaj lagjeje, respektivisht pjesës periferike që shtrihet mbi rrugën kryesore “Xhevat Berisha”, ku në disa prej shtëpive në këtë lagje fare nuk kanë ujë, konkretisht në pjesën e lagjes së UÇK-së. Edhe ato shtëpi që furnizohen me ujë, uji nuk është i përshtatshëm për pije, për pastrim, etj, ngase është evidente ngjyra e turbulltë e tij. Si rrjedhojë, shumica prej banorëve kanë hapur puse nëpër shtëpitë e tyre edhe pse nga pusët e hapura është vërtetuar se ky ujë nuk është i përshtatshëm për pije. Pavarësisht një lidhjeje të rrjetit që është marrë nga “Qeshmja e Pashës” dhe se faktit ka ujë me “bollëk”, ende mbetet si prioritet mungesa e ujit të pijes.

Mungesa e rrjetit të kanalizimit

Është potencuar si problematike edhe mungesën e rrjetit të kanalizimit në disa prej rrugëve dytësore në lagje, kështu që në masë të madhe ndotja e ambientit dhe kundërmimi është i padurueshëm.

Trotuaret e ngushta dhe të bllokuara

Kërkesë e herëpashershme e banorëve drejtuar inspektoratit komunal dhe policisë ka qenë bllokimi i trotuarëve, ku vetë banorët kanë uzurpuar pronën publike duke dalë me anekset e shtëpive, oborrin deri në rrugë dhe duke iu lënë hapësirë shumë të vogël të shfrytëzimit kalimtarëve, sikurse edhe parkimi me automjete vend e pa vend dhe rezikimi i banorëve nga vozitësitë e pandërgjegjshëm në mungesës të hapësirës së trotuarit, po rrezikon më së tepërmi fëmijët dhe të moshuarit e kësaj lagjeje.

Mungesa e ndriçimit publik

Në rrugët kryesore të kësaj lagjeje mungon ndriçimi publik, ose ndriçimi është preznet në një kohë shumë të shkurtër. Banorët më të rrezikuar nga mungesa e ndriçimit në lagje janë njerëzit e moshuar të cilët frekuentojnë xhaminë e lagjes, sikurse edhe nxënësit që vijnë rrugën për në shkollë - shtëpi dhe anasjelltas.

Mirëmbajtja e rrugëve

Kompania për pastrimin e lagjeve nuk përfshin në tërësi lagjen gjatë larjes së rrugës, kjo e fundit lë anash pjesën e lagjes së UÇK-së, pastrimi bëhet nga spitali i qytetit gjer te shkolla “Xhevat Berisha”.

Transporti Urban

Sikurse edhe problematikat e tjera të cekura për lagjen e UÇK-së, ngjashëm evidentohet edhe transporti urban, ku linja përshkruhet deri te shkolla e nga kjo e fundit deri te lagja e cekur që ka distancë rreth dy kilometrash deri në përfundim të lagjes, lihet anash pastrimi gjegjësisht larja e rrugëve.

Zyra e vendit

Është ndërtuar para disa vitesh në lagje dhe ende nuk është lëshuar në funksion për qytetarë. Dita ditës shkatërrohet nga tregtarët ruralë, duke shfytëzuar atë pjesë për kryerjen e punëve të përditshme deri sa tregtojnë mallin e tyre (deklarim i secilit në debat që përreth objektit lidhen kafshët deri sa ta përfundojnë tregun fshatarët që tregëtojnë në Prizren).

Ambulanta e lagjes

Ushtrimi i veprimtarisë në të mbahet me gjithsej pesë ditë gjatë javës për trajtimin e pacientëve, me mjekun dhe teknikët, kurse gjatë fundjavës është jashtë funksionit (kërkesë e bonorëve edhe gjatë takimeve në lagje, fokus grupeve, ka qenë që ambulanta të jetë funksionale edhe gjatë ditëve të vikendit).

Shtëpia e Kulturës

Gjatë debatit, banorët shprehën nevojën e tyre edhe për ndërtimin e një Shtëpie të Kulturës në lagjen e tyre, duke potencuar mundësinë e hapësirës ku mund të vendoset ky objekt (ekzistimit të hapësirës në periferi të lagjes) e cila do t’iu ndihmonte shumë në zhvillimin e aktiviteteve kulturore, takimeve të ndryshme, etj. Po ashtu është ndier më se e nevojshme edhe ndërtimi i një urë-lidhjeje që do t’i përfshinte lagjen e “Tusuzit” dhe atë të “Bajram Currit”, e në këtë formë do të kishte liruar shumë ngarkesa në komunikacion për shkak të ngushtimit të rrugëve në lagje.

Të pranishmit kërkuan nga përfaqësuesi i Komunës zotimin dhe nisjen e angazhimeve rreth haritmit të Planit Rregullues Urban për këtë lagje (Drejtorisë përkatëse, DUPH), ngase çdo ndërtim dhe rregullim në këtë pjesë të qytetit i jep kahun e kundërt, kur investimet e tilla sjellin probleme të ndryshme në investime dhe projekte pa planifikim të mirëfilltë dhe pa bazë ligjore.

Rekomandimet e dala nga takimi me banorët

- Komuna duhet të bëjë zgjidhje sa më parë problemit të ujit të pijës në këtë lagje,
- Të ndërhyjë në kompetencat e Hidroregjionit Jugor në mënyrë që t’i rikthehet uji i pijshëm lagjes,
- Mbulimi me ndriçim publik në tërë lagjen pa ndërprerje,
- Kycja e rrjetit të kanalizimit,
- Të funksionalizohet Zyra e Vendit (Bashkësia Lokale),
- Transporti urban të përfshijë tërë lagjen sikurse edhe mirëmbajtja e rrugëve,
- Ndërtimi i një Qendre të Kulturës,
- Ambulanta e lagjes të jetë në shërbim të qytetarëve edhe gjatë ditëve të fundjavës,
- Hapja e një rruge shtesë, ose ndërtimi i urës që do të lidhte lagjen e “Tusuzit” me lagjen e “Bajram Currit”,
- Të fillojë hartimi i Planit Rregullues të Hollësishëm për lagjen.

Rekomandimet

Duke u nisur nga ajo se secili banor duhet të kenë “të drejtën e tij për qytet”, do të thotë të drejtën për të pasur strehim, qasje në infrastrukturë, shërbime dhe mundësi të kontribuimit aktiv në procesin e planifikimit hapësinor dhe urbanistik, rrjedh se është e drejtë e patjetërsueshme e komunitetit të vendbanimeve joformale të përfshihen në procesin e rregullimit të tyre. Në këtë kuptim, ligjet, programet, politikat dhe praktiket duhet të harmonizohen si dhe të diskutohen publikisht, të përpilohen udhëzues për të arritur pjesëmarrjen e kënaqshme të banorëve në planifikimin hapësinor dhe urbanistik, pra të sigurohet legjitimiteti i politikave të menaxhimit urban.

Duke u bazuar në kërkesat e banorëve përgjatë debateve, mënyra e rekomanduar e përmirësimit të gjendjes ekzistuese në lagjen “Tusuz” duhet të bazohet në përmirësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës dhe shërbimeve ekzistuese. Përparësi e kësaj mënyre të trajtimit është se nuk e shqetëson jetën sociale dhe ekonomike të komunitetit. Vlerësohet lart dhe është më se e domosdoshme pjesëmarrja e komunitetit në procesin e përmirësimit të vendbanimit, ndërsa komuna duhet të fokusohet në përpilimin e Planit Rregullues të Hollësishëm, sipas tij dhe ligjit të aprovuar të legalizojë ndërtimet pa leje, të përmirësojë kushtet mjedisore, sociale dhe ekonomike përmes rregullimit të infrastrukturës, krijimit të hapësirave publike, të ofrojë shërbimeve bazike publike si shkollat, transporti publik, menaxhimi i mbeturinave, furnizimi me ujë, telefon etj.

Rregullimi nëpërmjet përmirësimit të gjendjes ekzistuese dhe zhvillimit të lagjes bazuar në nevojat dhe kërkesat e banorëve

Rregullimi i vendbanimeve joformale nëpërmjet përmirësimit dhe zhvillimit të lagjes karakterizohet përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse. Kjo qasje siguron që komuniteti është dëgjuar në tërësi dhe nevojat e tyre janë konsideruar, ndërkohë që niveli komunal dhe qendror duhet të vëzhgojë dhe analizojë ndikimin në zonë më të gjerë dhe t’i monitorojë ndërlikimet strategjike që mund të paraqiten gjatë procesit. Një avantazh kryesor që ka kjo qasje është se për çdo inkonsistencë, apo mospërputhje në nivelin politik dhe alokimet financiare, problemet identifikohet më herët dhe të njëjtat ballafaqohen që në fillim dhe ky fakt nxit një qasje më strategjike për të gjetur zgjidhje për mjedisin kompleks të informalitetit urban.

Krahas Planit Rregullativ Urban, praktiket e urbanistikës në përmirësimin e vendbanimeve joformale kanë identifikuar një proces të përbërë prej katër hapave deri në arritjen e zgjidhjes:

- Procesi duhet të iniciohet nga një punëtori gjithëpërfshirëse në mënyrë që të përcaktohet vizioni i qartë për këtë zonë.
- Hapi i dytë përfshin inkuadrimin e departamenteve komunale relevante për të promovuar transparencë të plotë të procesit dhe të raportimit të rezultateve.
- Së treti, duhet të krijohet një forum për përfshirjen e vazhdueshme të komunitetit në të gjitha fazat, në mënyrë që të sigurohet pronësia e procesit nga ana e përfituesve, dmth banorët e lagjes.
- Hapi i katërt është llogaridhënia e ekipit profesional dhe komunitetit në kuadër të projektit. Kjo thekson rëndësinë e shkëmbimit të informacionit dhe mbështetjen e njëri-tjetrit për t’u përballuar me ndryshimin.

Sa më e plotë që është kjo qasje e integruar, aq më shumë do të inkorporohet zhvillimi i infrastrukturës fizike dhe sociale, si një nga kushtet kyçe të përmirësimit të gjendjes së lagjes. Gjithashtu do të bëjë të mundshëm që implikimet financiare për përmirësimin e infrastrukturës të sigurohen nëpërmjet

partneritetit me komunitetin, duke pasur parasysh që kjo qasje e integruar përpos që ndërton relacione mes autoriteteve komunale dhe komunitetit, e bën të mundshëm dhe më të lehtë edhe komunikimin.

Buxhetet e vogla të komunave të Kosovës, nuk mund t'i përgjigjen në mënyrë adekuate nevojave të ndryshme për financimin e rregullimit dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, veçanërisht për vendbanimet joformale, rregullimi i të cilëve kërkon mjete të shumta financiare. Komunitat duhen të gjejnë forma alternative të financimit me anë të:

- Inkurajimit të partneriteteve publike private;
- Krijimin e mundësive për participimin e komunitetit në bashkëfinancimin e infrastrukturës bazike;
- Shfrytëzimit të fuqisë punëtore nga komuniteti i vendbanimeve joformale për zbatimin e projekteve infrastrukturore si dhe rregullimit të shtëpive në vendbanimet joformale;
- Inkurajimi i institucioneve mikrofinanciare për ofrimin e mënyrave për gjenerimin e mjeteve për të ofruar kredi;
- Hulumentit të partneriteteve me donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare për të zbatuar mekanizma të reja financiare për të mundësuar përmirësimin e vendbanimet joformale;
- Mobilizimit të burimeve financiare nga niveli qendror i qeverisë dhe nivelit lokal për financim të rregullimit të vendbanimeve joformale.

Regullimi përmes legalizimit

Legalizimi i ndërtesave pa leje nduhet të fillojë menjëherë, pasi aprovimi i Ligjit tashmë është bërë. Legalizimi ka të bëjë me dhënien e mandatit ligjor për banorët e vendbanimeve joformale, e që do të sjellë pasurinë e akumuluar në mënyrë joformale në tregun formal. Ky koncept forcohet edhe më shumë me mundësinë e rritjes së të ardhurave publike përmes vjeljes së tatimit në pronë.⁸⁴

Rëndësia e sigurimit të bartësve të pronësisë është e pamohueshme për shkak të përfitimit që ajo ofron për individët privatë, si dhe ndihmon dhe mbështet zhvillimin e tregut formal të pronës duke kontribuar kështu edhe në qytetin si tërësi.⁸⁵ Në aspekt të planifikimit, nëpërmjet legalizimit do të mundësohej rivlersimi dhe kategorizimi i këtyre zonave dhe strukturave ekzistuese në to, si dhe do të krijoheshin mundësitë e zhvillimit nëpërmjet planifikimit të mirëfilltë të qëndrueshëm, gjithmonë duke pasur parasysh kërkesat e komuniteteve.

Infrastruktura urbane dhe sociale

Hulumtimi i vendbanimet joformale në Kosovë tregon se 155 vendbanime, apo 88.91%, nuk kanë, ose kanë pjesërisht infrastrukturë urbane, njëkohësisht konsiderohet që këto vendbanime janë ndotës direkt të mjedisit. Ndërsa, 122 vendbanime, përkatësisht 70%, janë pa infrastrukturë sociale. Në këtë kontekst, komunitat në kuadër të programit për rregullimin e vendbanimet joformale në territorin e vet duhet të ofrojnë infrastrukturë fizike dhe sociale si dhe duhet përmirësuar shërbimet në mënyrë optimale. Në projekt buxhetet komunale për vitet vijuese, për projektet infrastrukturore, për

⁸⁴ Tsenkova, S., 2008. In Search for Sustainable Solutions for Informal Settlements in the ECE Region: Challenges and Policy Responses. Economic Commission for Europe, *Committee on Housing and Land Management*, Geneva, 22-23 September 2008.

⁸⁵ Fernandes, E., 2001. Regularizing informal settlements in Brazil: legalization, security of tenure and city management. Paper presented at the ESF/N-Aerus Annual Eorkshop, 23-26 May 2001. Leuven, Brussels.

vendbanimet joformale prioritare, duhet të parashihet buxhet i mjaftueshëm që të mundet të konkurojnë për përfitime të donacioneve si fonde shtesë për këtë çështje.⁸⁶

Në kuadër të kësaj pike rekomandimet kryesore, e që janë edhe refleksion i problemeve të qytetarëve, të shprehur nëpërmjet diskutimeve publike janë:

Përmirësimi i rrjeti i ujësjellësit dhe kanalizimit

Të bëhet planifikimi dhe shtrirja e rrjetit të furnizimit me ujë, kanalizimit fekal dhe atij atmosferik, sipas standardeve bashkëkohore, gjithmonë duke u bazuar në numrin e banorëve dhe funksioneve që zhvillohen në zonë, e të cilat dalin nga profili urban i gjendjes ekzistuese të lagjes, por gjithashtu duke i paraparë edhe trendet zhvilluese të lagjës bazuar në planin rregullues urban të zonës;

Përmirësimi i rrjetit të rrugëve dhe rritja e sigurisë së qytetarëve në komunikacion

Të bëhet sistemimi i rrugëve në zonë, të kategorizohen në bazë të frekuentimit të qytetarëve. Rrugët duhen të planifikohen në bazë të standardeve bashkëkohore dhe të dimensionohen në bazë të qarkullimit të automjeteve, gjithmonë të kompletuara me infrastrukturën përcjellëse, trotoare dhe brezat gjelbërues. Gjithashtu të shikohet mundësia alternative e shfrytëzimit të rrugëve. Në ato rrugë në të cilat nuk ka mundësi zgjerimi, e që cilësohen si kryesore, mund të shfrytëzohen vetëm për automjete, përderisa rrugët e tjera sekondare mund të shfrytëzohen vetëm për qarkullimin e banorëve në këmbë, apo biçikleta. Pra, të mendohet krijimi i arterieve që do të shfrytëzoheshin vetëm për këmbësorët dhe këto arterie të lidhin shkollën, qendrën e mjekësisë familjare/ ambulantën, dhe qendrën kulturore në të ardhmen. Rekomandohet gjithashtu përdorimi i sinjalistikës për rregullimin e komunikacionit. Të bëhet shenjzimi i rrugëve dhe shtëpive. Në kuadër të këtij rekomandimi si kërkesë specifike parashtrohet edhe hapja e një rruge shtesë, ose ndërtimi i urës që do të lidhte lagjen e Tusuzit me lagjen e Bajram Currit.

Rritja e sigurisë së banorëve në lagje

Në kuadër të kësaj pike duhet t'i kushtohet rëndësi ndriçimit publik, sidomos pjesëve që janë të frekuentuara më së shumti nga banorët dhe ato arterie të cilat lidhin pjesë të lagjeve me funksionet tjera sociale, si p.sh. shkollën, qendrën e mjekësisë familjare, zyren e vendit, etj. Në zonat ku janë rrugët kryesore dhe ku ka qarkullim të madh të trafikut të automjeteve të mendohet realizimi i barrierave fizike me anë të brezave të gjelbërimit, ku do të bëhet ndarje e qartë në mes automjeteve dhe këmbësorëve. Rekomandohet gjithashtu përdorimi i sinjalistikës për rregullimin e komunikacionit.

Përmirësimi i infrastrukturës sociale dhe rekreative

Zyra e vendit e ndërtuar rishtazi nga komuna duhet të funksionalizohet. Sipas informimit të dhënë gjatë debatit nga përfaqësuesi komunal, citon se Zyra në fjalë ka qenë pjesë e diskutimit në bordin e drejtorëve komunalë dhe se ky objekt do të jetë në funksion gjatë dy muajve me po atë destinim që është ndërtuar nga Komuna e Prizrenit. Ambulanta e lagjes duhet të ofrojë shërbime gjatë gjithë kohës, jo vetëm ditëve të punës. Kërkesë tjetër e banorëve është ndërtimi i një qendre kulturore për lagjen. Kjo ndërtesë duhet të jetë multifunksionale, me qëllim të krijimit të hapësirave të nevojshme për aktivitete të ndryshme për grupë moshë të reja dhe të vjetra. Gjithashtu, në mënyrë që ndërtimi i objektit të jetë racional nga aspekti hapësinor dhe financiar, një pjesë e ndërtesës do të duhej të shfrytëzohet edhe si qerdhe/kopsht për fëmijë si funksion i domosdoshëm për lagjen. Në kuadër të kësaj qendre të parashihen edhe fusha të sportit, të cilat do të mirëmbaheshin më mirë nga menaxhmenti i ndërtesës.

⁸⁶ Strategjia dhe plani i veprimit për parandalimin dhe rregullimin e vendbanimeve joformale në Kosovë, MMPH 2010

Përmirësimi i qasjes në transport publik

Gjatë përpilimit të Planit Rregullativ të Hollësishëm për zonën të kihet parasysh dhe t'i kushtohet rëndësi planifikimit të mirëfilltë të komunikacionit, rrjedhimisht sipas standardeve projektuese të parashihen shpërndarja e stacioneve të transportit publik në mënyrë sa më optimale dhe të krijohen qasje të lehta dhe të mjaftueshme për banorët e zonës.

IX. Mjedisi dhe planifikimi urban në Prizren

Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm

Shkruar nga, Eliza Hoxha

Përmbledhje ekzekutive

“Ne nuk do të kemi më shoqëri, nëse e shkatërrojmë mjedisin” - Margaret Mead

Të jetuarit në harmoni me natyrën nuk është koncept i ri në adresimin e çështjeve urbane. Njeriu, prej se di për veten, ka ndërtuar dhe ka krijuar duke e shfrytëzuar dhe duke u përshtatur me mjedisin përkatës në kuptimin gjeografik, kulturor dhe ekonomik. Qysh nga antika, shumica e ndërtesave i kanë shfrytëzuar materialet vendore dhe janë formësuar për t’iu përshtatur e adaptuar relacioneve midis shfrytëzueshmërisë dhe klimës nga e cila ndikoheshin. As Prizreni i vjetër nuk është përjashtim në këtë pikë.

Këto rregulla universale të ndërtimit në harmoni me natyrën i gjejmë në shembuj dhe libra të shumtë, si “Dhjetë librat për arkitekturën” nga Vitruvi, tekste e shtjellime të shumta deri në periudhën e Renesancës edhe nga Palladio dhe Serilo, duke na bërë të kuptojmë se shumë nga objektet e rëndësishme historike sot nëpër botë mbijetuan falë aplikimit të këtyre teorive. Por, sado të qëndrueshme të jenë këto lloj ndërtimesh, është një thënie që i vë në pikëpyetje në ditët e sotme: “Çfarë është një ndërtesë dhe përdorimi i saj, nëse nuk ke një planet /mjedis të mirë për ta vendosur atë?”. Revolucioni industrial i shekullit të 18-të u glorifikua me arritjet në ndërtime nga më të ndryshmet, të cilat i adaptuan sistemet mekanike të ngrohjes, ajrosjes, diellosjes dhe me këtë ndikuan në mënyrën e re të formësimit të qyteteve, por edhe të jetës në to. Në të njejtën kohë, ngritja e konsumit global të karburanteve dhe lëndëve të tjera djegëse, si për prodhim ashtu edhe për lëvizje/komunikim, do të ndikonte në rritjen e emetimit të gazit serrë. Kjo kohë shënon boom-in e rritjes së qyteteve dhe një fluks të madh migrimi nga zonat rurale në ato urbane. Nga hulumtime të shumta në botë thuhet se deri në vitin 2025 rreth 80% të popullësisë botërore do të jetojë në qytete.

Njeriu u bë ai që po sfidonte mjedisin në kuptimin e zhvillimeve fizike e socio-ekonomike, por rezultati i fundëm doli të ishte - Qytete të pista, jo të sigurta dhe jo të shëndetshme. Si pasojë e kësaj, lëvizje të shumta për qytete të gjelbra dhe qytete më të shëndetshme nisën të promovohen nga arkitektë në fillimet e shekullit të 20-të. Kujtojmë publikimin “Garden Cities of To-morrow (1898)”, nga Ebenzer Howard, si një thirrje e re për një jetë në harmoni me natyrën, e cila u shndërrua në udhërrëfyes të lëvizjes së qyteteve kopsht në Britaninë e Madhe. Apo edhe thirrjet e Le Coubusier për qytete më të shëndetshme, ku zonat e banimit ishin krejtësisht të lira e të zhytura në gjelbrim dhe njëkohësisht të shkëputura nga funksionet e tjera në qytet. Me gjithë idenë e përafrimit të njerëzve me natyrën, këto lloj konceptesh nuk arritën t’i zvogëlojnë diferencat sociale dhe ekonomike, e as ta rrisin sigurinë nëpër qytete. Pikërisht lidhur me këtë qasje, Jane Jacobs thekson se shumica e arkitektëve dhe planerëve të asaj kohe, thjesht harruan të kujtojnë dhe të kuptojnë se “qytetet e shëndetshme janë sisteme komplekse, organike, spontane dhe të çrregullta”⁸⁷. Është pikërisht shumëllojshmëria, ajo e cila duhet të shihet si vlerë dhe pikat kohezive të jenë hapësira të përafrimit të njerëzve ndërmjet vete dhe me

⁸⁷ Jane Jacobs Was Right: Gradual Redevelopment Does Promote Community

<http://www.citylab.com/housing/2013/03/jane-jacobs-was-right-gradual-redevelopment-does-promote-community/4917/>

natyrën. Sot, agjenda të shumta ndërkombëtare adresojnë çështjen e qyteteve të shëndetshme, qyteteve të gjelbra dhe principet e jetës në harmoni me natyrën, të cilat me një kornizë të vetme i gjejmë si principe të qëndrueshmërisë.

Në kuadër të të gjitha këtyre zhvillimeve, edhe qyteti i Prizrenit si edhe të gjitha qytetet kosovare kanë shumë punë për të bërë. Si e para, ta njohim vlerën e ndërtimeve të dikurshme me materialet natyrore dhe ta rikonsiderojnë atë për forma të reja të ndërtimit dhe interpretimit në qytet dhe fshat. Në të njejtën kohë, të mundohemi t'i amortizojnë tërë ndikimet e industrializimit të shpejtë, por të vonshëm, si dhe ndryshimet drastike në fazën tranzicionale të pasluftës 1999. Në gjithë këtë rrugëtim, e vetmja gjë për të cilën mund të mburremi kur flasim për zhvillimin e qyteteve në harmoni me natyrën është korniza ligjore në Kosovë, e cila ka vite që mundohet të përcjellë gjithë agjendën mjedisore globale/europiane për ta harmonizuar atë me nevojat lokale. Lidhur me këtë, edhe sektori i shoqërisë civile mundohet të japë një ndihmë dhe ta ketë fjalën e vet. Projekti “Qyteti gjithëpërfshirës – Planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren”, është një nga ata që mundohet, përmes përfshirjes së grupeve të ndryshme të komunitetit, t'i identifikojë brengat dhe problemet aktuale dhe t'ua japë një drejtim atyre përmes një konsensusi të përbashkët. Takimet e debatet e shumta dhe hulumtimet në terren lidhur me temën “Planifikimi dhe Mjedisi” nxjerrin përpara shqetësimet e komunitetit prizrenas, sidomos për mungesën e hapësirave të gjelbra, ndotjen e ujërave dhe ajrit, shkatërrimin e prerjen e pyjeve dhe çështjen e menaxhimit të mbeturinave.

Hyrje

“Nuk dua ta mbroj mjedisin. Dua të krijoj një botë ku mjedisi nuk ka nevojë për t'u mbrojtur”

Edhe pse parimet e zhvillimit të qëndrueshëm veçse kishin filluar të diskutoheshin 50 vite më parë, në fakt janë 25 vitet e fundit që iniciativa të shumta globale ngrisin zërin për implikimet e shumta në planetin tokë nga eksploatimi i resurseve, lirimi i gazrave dhe mbeturinat e ngurta. Kujtojmë vitin 1972, kur për herë të parë ishte “Club of Rome” që mori vëmendje me raportin “The limits of Growth”. Por, tek 20 vite më vonë, këto çështje morën hapësirën e merituar të debatit dhe vëmendjes globale në konferencën ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimin, në Rio de Janeiro, 1992. Dokumenti final i konferencës, i miratuar nga përfaqësuesit e 179 shteteve në KB sjell përpara ndërvarësinë e tri çështjeve kryesore, si: **ekonomia, mjedisi dhe shoqëria, apo barazia sociale**, të cilat duhet të merren parasysh barabarësisht në mënyrë që zhvillimi i qëndrueshëm të marrë formë dhe jetë⁸⁸. Dy vite më vonë, më 1994, duke ndjekur konferencën e Rios, në qytetin Alborg të Danimarkës, promovohet “fushata europiane për qytete të qëndrueshme”. Bazuar në “Agjendën 21”, Konventa e Alborgut mundohet t'i adresojë në detaje dhe me specifika çështjet e qyteteve në Europë⁸⁹. Ratifikimi i saj nga 44 shtete të Bashkimit Europian në vitin 2001, solli përmbajtjen e konventës të strukturuar në tri shtylla të cilat adresojnë të drejtën për:

- “Qasje publike në informatat për mjedisin
- Pjesëmarrje publike në vendimet të caktuara që lidhen më mjedisin
- Qasje në gjyqe dhe tribunalet për çështjet mjedisore.”⁹⁰

⁸⁸ Local Agenda 21, http://www.partizipation.at/contact_en.html

⁸⁹ Aarhus Convention, <http://www.partizipation.at/aarhus-convention.html>

⁹⁰ Aarhus Convention, <http://www.partizipation.at/aarhus-convention.html>, (pdf-download)

Aktualisht ka lëvizje dhe thirrje të organizatave të ndryshme të shoqërisë civile që Agjenda 21 të rishqyrtohet në vitin 2015 (post-UN 2015), me propozimin që kultura të hyjë si komponentë e saj⁹¹, për t'u shfrytëzuar si platformë për adresimin e çështjeve si: “Ulja e varfërisë, edukimi, vendbanime dhe të qëndrueshme, barazi, ekosistem dhe biodiversitet dhe zhvillim ekonomik”⁹².

Gjithë këto dokumente të lartpërmendura janë vetëm baza për të adresuar zhvillimin e qyteteve dhe planifikimin e të ardhmes së tyre, duke e theksuar rëndësinë e trekëndëshit të baraspeshës: Ekonomi, Mjedis dhe Barazi sociale. Në fushën e planifikimit, tri perspektivat e ndryshme për qytetin vijnë nga tre tipa planerësh:

- “Planerët urbanë që adresojnë komponentën e zhvillimit ekonomik e shohin qytetin si një mjedis ku prodhimi, konsumi, distribuimi e inovacioni zënë vend. Hapësira shihet si mundësi për zhvillim, infrastrukturë dhe shkëmbime.
- Planerët mjedisorë e shohin qytetin si konsumues të resurseve dhe prodhim të mbeturinave. Qyteti zakonisht është në garë me natyrën për resurset dhe tokën duke u shndërruar në kanosje për të. Hapësira këtu nënkupton natyrën, ekosistemin, peizazhin, lumenjtë, etj
- Planerët socialë e shohin qytetin si lokacion konflikti bazuar në mënyrën e distribuimit të resurseve, shërbimeve dhe mundësive. Gara bëhet përbrenda vetë qytetit, përbrenda grupeve të ndryshme sociale. Hapësira këtu nënkupton hapësirën sociale të komunitetit, lagjeve, organizatat tregtare, hapësirën si mundësi e qasjes, apo edhe segregimit”.⁹³

Bashkimi Europian ka hartuar një set politikash në mbrojtjen e mjedisit, menaxhimin e mbeturinave, dhe promovimin e qëndrueshmërisë dhe ajo që zë vend të rëndësishëm aktualisht është “Strategjia e BE 2020”⁹⁴, e cila synon zgjerimin në vendet e Ballkanit përfundimor nëpërmjet promovimit dhe fuqizimit të parimeve të qëndrueshmërisë dhe gjithpërfshirjes.

Së fundmi, me qëllim të stimulimit të qyteteve për ngritjen e performancës së tyre mjedisore dhe promovimit të saj, është themeluar edhe shpërblimi “European Green Capital”, apo “Kryeqyteti i Gjellbër i Europës”. “Është shumë e rëndësishme që qytetet të vlerësohen për përpjekjet dhe punën e tyre në përparimin e mjedisit urban, duke synuar hapësira më të shëndetshme dhe të qëndrueshme”.⁹⁵ Shpërblimi sigurisht se shënjon arrijtjet e një qyteti duke e shndërruar atë në model për të tjerët dhe në fokus të interesimit të njerëve për ta vizituar, apo edhe për të jetuar a punuar në të.

Nëse kthehemi në kontekstin lokal, kujtojmë se Kosova ka ecur sa iu përket dokumenteve të shumta ligjore të cilat sigurojnë gjithpërfshirjen dhe promovojnë vendimarrjen e përbashkët për një mjedis më kualitativ për jetesë. Por, sa ka arritur t’i zbatojë politikat afatgjata dhe afatmesme në qytete dhe zonat rurale, kjo përbën çështje në vete dhe brengë njëkohësisht.

⁹¹ www.culture2015goal.net

⁹² www.culture2015goal.net

⁹³ Scott Campbell, “Green Cities, Growing Cities, Just Cities?” ,Urban Planning and the Contradictions of Sustainable Development ©*Journal of the American Planning Association* (1996).

⁹⁴ Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025 “Raporti për Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) (draft), UN-HABITAT, Prishtinë, Programi Mbështetës për Planifikimin Hapësinor Komunal në Kosovë

⁹⁵ <http://ec.europa.eu/environment/europeangreencapital/about-the-a&ard/index.html>

Situata aktuale

“The environment is everything that isn’t me” – Albert Einstein

Qeveria e Kosovës përmes Ligjit për Mbrojtjen e Mjedisit - Nr. 03/L-025, synon “harmonizimin e zhvillimit ekonomik dhe mirëqenies sociale me parimet themelore për mbrojtjen e mjedisit sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm”.⁹⁶ Pakoja e ligjeve që trajtojnë çështjet mjedisore është e madhe dhe së fundi përfshin edhe kushtëzimet për vlerësimet e ndikimeve në mjedis për çdo strategji zhvillimore sektoriale qendrore apo lokale. Në anën tjetër, Ligji për Planifikim Hapësinor - Nr. 04/L-174 është platforma e cila gjithë hartimin e dokumenteve zhvillimore në nivel qendror dhe në nivelin lokal e bazon në parimin e gjithëpërfshirjes si domosdoshmëri për të siguruar një të ardhme alternative për të gjitha grupet e interesit. Këto pako legislative më pas pasurohen edhe me shumë dokumente të tjera strategjike/sektoriale në nivelin lokal. Kur jemi te fusha e mjedisit, Komuna e Prizrenit ka hartuar disa sosh, disa prej të cilave si “Plani zhvillimore komunal/urban 2015”, “Strategjia zhvillimore lokale”, “Plani i veprimit mjedisor-2011”, “Plani loal i veprimit në biodiversitet në Komunën e Prizrenit 2013-2017”, “Plani i menagjimit të mbeturinave të ngurta në Komunën e Prizrenit 2014-2018”, etj. Këto dokumente do të duhej të ishin baza reale e adresimit të zhvillimit të ardhshëm të Prizrenit urban/rural, por ajo që vihet re në disa prej tyre është mungesa e analizave më të thella dhe tematike, pastaj materiali i njëjtë i përgjithshëm, i cili është pjesë e dy dokumenteve të ndryshme, gjë që si e para i bën të duken joserioze. Edhe përkundër kësaj, zbatimi i këtyre dokumenteve në praktikë gjithnjë vonon, pak për arsye të mungesës së fondeve e pak edhe nga mungesa e vullnetit të mirë, apo ndonjëherë edhe nga shkujdesja e vet qytetarëve. Ojq-të e shumta kanë luajtur rol të rëndësishëm duke bërë shpesh edhe rolin e “mbikëqyrësit” në proceset e zbatimit të politikave programore komunale, por në të njëjtën kohë edhe në vetëdijësimin social për çështjet e përgjithshme mjedisore, trendet e energjive të ripërtëritshme, reciklimin e mbeturinave dhe të tjera. “Ec ma ndryshe” tash sa kohë punon përmes aktiviteteve të ndryshme, duke u mundur që aspektin e qëndrueshmërisë dhe gjithëpërfshirjes ta sjellë në agjendën primare të Komunës së Prizrenit. Në takimet e debatet me grupe të interesit në temën “Planifikimi urban dhe mjedisi”, fokusi kryesor i debatit ishin “nëntemat si: trashëgimia natyrore, zhvillimi i qëndrueshëm, lumenjtë, resurset natyrore, ndotja e mjedisit dhe pezazhi natyror/parqet dhe hapësirat publike. Sfidat kryesore duken të jenë mungesa e hapësirave të gjelbra, trajtimi i ujërave, por edhe ndërtimet pa leje”.⁹⁷ Në gjithë theksin e brengave të pjesëmarrësve, ajo që duhej kuptuar dhe nënvizuar ishte se mjedisi nuk ka kufij. Veprimet tona të papërgjegjshme kundrejt tij nuk ndikojnë të izoluar, sepse ato nuk njohin kufij urbanë, apo ruralë, komunalë apo shtetërorë, rajonalë apo globalë.

Të gjeturat

“Toka ofron mjaftueshëm për të kënaqur çdo nevojë njerëzore, por jo edhe çdo lakmi njerëzore”

Në rezultatet e hulumtimit të fundit mbi perceptimet e qytetarëve për planifikimin urban në qytetin e Prizrenit (Gusht 2014 – EC Ma Ndryshe), shqetësim i madh duket të jetë mungesa e trotuareve dhe njëkohësisht edhe ndërtimet pa leje.⁹⁸ Shqetësimi i dytë i qytetarëve prizrenas është mungesa e hapësirave të gjelbruara në qytet me 42%, për të cilën përgjigjet nga gjinia meshkullore në këtë çështje janë në 36.3%, ndërsa te gjinia femërore 31.7%. Poashtu problemet infrastrukturore (kanalizimi dhe

⁹⁶ Ligji Nr. 03/L-025, Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit, Neni 1

⁹⁷ Audio nga debati me grupet e interesit, tema “Planifikimi urban dhe mjedisi”, EC Ma Ndryshe.

⁹⁸ Të gjeturat kryesore të hulumtimit, Anketa 1, EC Ma Ndryshe, fq.1

ujësjellësi) marrin hapësirë vëmendjeje në hulumtim në kuotën 18.6%. Qytetarët në përqindje më të vogël shfaqin shqetësim edhe për mungesën e parqeve publike si dhe hapësirave rekreative në qytetin e Prizrenit. Hapësirat e gjelbruara, parqet publike, ndotja e mjedisit (ajrit dhe lumit) dhe mosmbrojtja e mjedisit në përgjithësi shihen si problematike edhe për grupet e tjera të komunitetit në qytet, si pensionistët, të rinjtë, personat me nevoja të veçanta, apo edhe organizatat dhe grupet e caktuara të interesit.⁹⁹

Poashtu, edhe nga debatet e organizuara direkt me grupet e interesit, duket se lista e çështjeve shqetësuese është afërsisht e njëjtë. Fokus grupet si: shoqata të shoqërisë civile, studentë, artistë, pensionistë, kompania rajonale e ujërave, forumi për trashëgimi kulturore, Kryqi i kuq i Kosovës - dega Prizren, përfaqësues të institucioneve publike, vunë theksin te furnizimi me ujë të pijes në qytetin e Prizrenit, humbjet komerciale dhe teknike në rrjet, avansimet e kësaj infrastrukture në lagje të caktuara, por që fare në fund ende furnizimi 24/24 është i pamundshëm.

Nga debatet e viteteve paraprake mbi mjedisin dhe planifikimin urban konkludohet se nuk ka përparim, situata nuk është përmirësuar tutje. OJQ-të konsiderojnë se faktori kryesor për këtë është pikërisht vetë pushteti që nuk merr masa ndëshkuese ligjore në drejtim të mbrojtjes së mjedisit dhe përparimit të tij

- Faktori kryesor për përqindjen e ulët të hapësirave të gjelbra në qytet është mosrespektimi i planeve rregulluese me rastin e ndërtimeve të reja të banesave kolektive, por edhe ndërtimet pa leje.
- Ato hapësira të gjelbra publike në qytet, siç janë parqet publike, nuk mbikëqyren sa e si duhet. Nuk mirëmbahen sipërfaqet e gjelbra, ka prani të mbeturinave dhe shportave që nuk pastrohen me kohë. Kjo i dekurajon njerëzit të kalojnë kohën e tyre në këto hapësira të përbashkëta publike.
- Në të njëjtën kohë njerëzit sillen me papërgjegjësi kundrejt pronës publike dhe në këtë pikë aspekte vetëdijësimi dhe zbatimi i ligjeve duhet të vijë në shprehje.
- Menaxhimi i mbeturinave përveçse në qytet, konsiderohet si problem i madh edhe në fshatrat e Prizrenit. Tejet problematike konsiderohen pikat ilegale të grumbullimit të mbeturinave në fshatin Lubizhdë dhe kundërmimi i deponisë së inerteve në fshatin Zhur.
- Në K.K të Prizreni mbeturinat e ngurta, në gati 90% të vendbanimeve, trajtohen deri në deponitë e caktuara.
- Niveli i ndotjes së ajrit nga si rezultat i pranisë së madhe të makinave të vjetëruara në vendbanimet e K.K Prizren konsiderohet të jetë shumë i madh. Përgjegjës për këtë është niveli qendror, sepse monitorimi i ajrit nuk realizohet nga komuna.
- MMPH angazhohet që të marrë masa për parandalimin e dëmtimit të shtretërve të lumenjve dhe të shfrytëzimit të egër të zhavorit të lumenjve, si dhe zbaton gjoba në rast të dëmtimit të pyjeve. Për shembull në rastin e parkut nacional "Sharri".
- Problematike është konstatuar të jetë edhe mopërcaktimi i kadastrit të lumenjve. Nuk mjafton vetëm mirëmbajtja dhe pastrimi i lumit brenda zonës urbane të qytetit, pasi që vendbanimet e Komunes së Prizrenit kanë po ashtu lumenj, të cilët, në rast të moskujdesit, i sjellin mbeturinat deri në qytet. Pra, konstatohet mungesa e impianteve dhe kolektorëve gjithashtu.
- Nga niveli i ulët i kujdesit, konsiderohet se gjendja e lumenjve në vendbanimet jashtë zonës urbane të Komunes së Prizrenit është alarmante.
- Ndërrimi i rrjedhes së lumenjve për përfitime individuale, shfrytëzimi pa kontroll i ujit të Lumëbardhit, keqpërdorimet e rërës dhe zhdukja e specieve të peshkut në lumë, konsiderohet

⁹⁹ EC Ma Ndryshe, **Planifikim urban për qytetarët 2**, fq. 7-13

të jenë rezultat i mosfunksionimit adekuat të marrëdhënieve mes pushtetit komunal dhe atij qendror.

- Projekti i miratuar nga K.K Prizren për rregullimin e pjesëve anësore të Lumëbardhit, vlerësohet të ketë dëmtuar vetë ambientin, pasi që për ta bërë një intervenim të tillë janë prerë drurët shumëvjeçarë të kësaj zone, të cilët ndër të tjera kanë bërë pjesë edhe në memorien kolektive të qytetarëve të Prizrenit.
- Sipas zyrtarëve të sektorit të mjedisit, ka filluar realizimi i ndërtimit të impiantit që do të përpunojë ujërat e zeza të vendbanimeve në Grykën e Zhupës. Përfundimi i projektit me kohë dhe konform projektit konsiderohet jetik për qytetin e Prizrenit.
- Dëmtimi i pyjeve, ndotja e tyre dhe gjuetia e paligjshme konsiderohen si kanosësit kryesorë të kësaj trashëgimie natyrore dhe kanosin gjithashtu biodiversitetin dhe ekosistemin.
- Po ashtu zjarri dhe mungesa e kapaciteteve për menaxhimin e tij janë rrezik tjetër i pyjeve.

Rekomandimet

“Disa njerëz e kërkojnë vendin e bukur, të tjerët e bëjnë vendin e bukur”

- Komuna e Prizrenit duhet të marrë përgjegjësinë që i takon në mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen dhe ruajtjen e Lumëbardhit dhe menaxhimin e mbeturinave. Komuna inkurajohet të respektojë ligjin dhe të veprojë konform tij, atëherë kur duhet të marrë masa ndëshkimore ndaj atyre që e degradojnë ambientin me çfarëdo lloj veprimi.
- Pushteti lokal inkurajohet që të gjejë forma të ndryshme për të vetëdijesuar qytetarët për mbrojtjen e mjedisit dhe për rëndësinë që ka ai për qytetin dhe mirëqenien e tyre.
- Komuna duhet t’i përfshijë qytetarët në hartimin e politikave lokale urbane - ekonomike/sociale/mjedisore që në fillim të proceseve, sepse ata janë forca shtytëse zhvillimore lokale.
- Një partneritet midis Komunës dhe OJQ-ve lokale në zhvillimin e projekteve të përbashkëta për të mirën e qytetit, është domosdoshmëri, duke marrë parasysh mundësitë e fondeve IPA nga Bashkimi Europian.
- Te jetuarit gjelbër është diçka që duhet të promovohet dhe të kultivohet me të gjitha instrumentet shprehëse nga Komuna e Prizrenit. Paketa e gjelbër e hartuar nga REC duhet të shihet si mundësi e mirë për fëmijët që të njihen me konceptet e qëndrueshmërisë që në fazën e hershme të formësimit të tyre.
- Poashtu promovimi i koncepteve të arkitekturës së gjelbër si fokus në investimet kapitale duhet të hyjë në agjendë për ta promovuar cilësinë e ndërtimit, energjinë alternative dhe vetëqëndrueshmërinë e objekteve.
- Komuna duhet të shikojë mundësinë e krijimit të alternativave për hapësira semipublike, të cilat mund t’i bashkangjiten rrjetit të përgjithshëm të gjelbrimit në Prizren dhe ta pasurojnë peizazhin urban si dhe nevojën e qytetarëve për to.
- Poashtu një program pyllëzimi dhe një plan peizazhor për qytetin dhe zonën turistike Prevallën duhet të vijë në shprehje në vitet në vijim.
- MMPH të bashkëpunojë ngusht me qeverinë lokale në mirëmbajtjen e pyjeve. Të gjobiten të gjithë atë që dëmtojnë në çfarëdo forme pyjet dhe të krijohen kapacitete adekuate për menaxhimin e zjarreve eventuale në zonat pyjore.
- Pajisja e qytetit, jo vetëm e zonës qendër, me shporta të mbeturinave. Sidomos në zonat më të frekuentuara. Përtej vetëdijësimit, qytetarët kanë nevojë për vende ku t’i hedhin mbeturinat e tyre.

- Përfundimi në kohë i ndërtimit të impiantit të ri për trajtimin e ujrave të zeza. Pajisja po ashtu edhe me kolektorë të rinj për grumbullimin e ujit.
- Të konsiderohet ngritja e akumulimeve si mundësi për ujitje dhe prodhim të energjisë elektrike, ngritja e kapaciteteve turistike, druri, rëra, thëngjilli e minerale të shumta, si resurs natyror, të cilin e disponon regjioni i Prizrenit.
- Të bëhen analiza të problematikave mjedisore para se të intervenohet në zona të caktuara. K.K Prizren inkurajohet që paraprakisht të shohë cilat janë resurset e saj natyrore dhe çfarë kapaciteti ka qyteti në mbrojtjen dhe pasurimin e mjedisit natyror.
- Respektimi strikt i planeve rregulluese mbi normat dhe përcaktimet për sipërfaqet e gjelbra nga ndërtuesit e objekteve shumëbanesore në qytet. Vlerësimi i ndikimit në mjedis i domosdoshëm / leja mjedisore.

Sfidat që kemi përpara janë të shumta, prandaj për ta përparuar mjedisin në Prizren dhe për t'iu prirë për të mirë zhvillimeve urbane si e para duhet që qasja jonë të ndërrojë. Të gjithë jemi përgjegjës dhe ndikues në një formë apo tjetër në zhvillimet urbane dhe rolet tona marrin jetë apo ndryshojnë varësisht nga situata. Do ta përfundoja këtë raport me dy thënie të vjetra, por besoj stimuluese, të cilat mund të na e ngacmojnë mendjen të paktën për të ndërruar pikëvështrimin, pozicionin, qëndrimin dhe sjelljen tonë karshi mjedisit ku jetojmë.

“Koha më e mirë për ta mbjellë një dru ka qenë para 20 viteve, koha më e mirë e ardhshme për ta bërë këtë është sot” (proverb kinez), andaj “bëhu ndryshimi që ti dëshiron ta shohësh në botë” - Ghandi

X. Kultura dhe planifikimi urban në Prizren

Zhvillimi ekonomik përmes turizmit kulturor

Shkruar nga, Hajrulla Çeku dhe Senat Haliti

Përmbledhje ekzekutive

Një numër i konsiderueshëm dokumentesh strategjike të miratuara nga të dy nivelet e qeverisjes në Kosovë qartësojnë kahet zhvillimore të komunës së Prizrenit. Në bazë të analizës së këtyre dokumenteve konstatohet se zhvillimi i turizmit është ndër mundësitë më reale të forcimit të ekonomisë lokale të Prizrenit. Një numër i dokumenteve zhvillimore e konstatojnë potencilin e zhvillimit lokal të Prizrenit bazuar në turizëm kulturor: Plani Hapësinor i Kosovës dhe Ardhmëria e Komunës së Prizrenit, Vizioni i Integruar i Prizrenit dhe ardhmëria e Komunës së Prizrenit, Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit dhe Ardhmëria e Komunës së Prizrenit, Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendres Historike, Strategjia orientuese për zhvillimin kulturor në Komunën e Prizrenit 2012 – 2016.

Ekziston një nevojë imediate për ridefinimin e rolit të kulturës në politika publike në përgjithësi, e në planifikim urban në veçanti. Në anën tjetër, planifikimi urban nuk guxon të mbetet një aktivitet thjesht fizik e teknik, por duhet ta ketë të integruar dimensionin njerëzor. Sot flitet për “kthesën kulturore” të planifikimit urban, ndërsa avokuesit argumentojnë se, sado të rëndësishëm që janë, planerët urban duhet të zgjerojnë agjendën dhe qasjen e tyre. Qytetet dhe jeta në qytete nuk ka të bëjë vetëm me dizajnimin e hapësirës fizike, pasi që njerëzit e zhvillojnë jetën e tyre pikërisht brenda këtyre hapësirave, jo rrallë në mospërputhje me qëllimet origjinale të planerëve. Planifikimi urban dhe zhvillimor duhet të përfshijë një koncept shumë më të gjerë social e kulturor, sesa vetëm vizatimi i vijave me ngjyra të ndryshme mbi një copë letër.

Bazuar në të gjeturat e projektit si dhe dokumenteve dhe analizave ekzistuese në fushën e kulturës (trashëgimisë kulturore) dhe planifikimit urban dhe zhvillimor, në vijim janë rekomandimet e raportit:

- Ridefinimi i rolit të kulturës dhe rritja e komunikimit me sferat e tjera të politikave publike,
- Hartimi i strategjisë për turizëm kulturor, si politikë qendrore për t’i udhëzuar veprimet strategjike për zhvillim lokal përmes turizmit,
- Respektimi i të gjitha dokumenteve strategjike të nivelit qendror dhe lokal të cilat e vizionojnë zhvillimin e Prizrenit përmes turizmit,
- Fokus më i madh në përmbajtje kulturore (aktivitete) se sa në infrastrukturë,
- Zhvillimi i produkteve të reja dhe profesionale turistike përmes të cilave do të pasurohet oferta turistike e qytetit,
- Respektimi i të gjitha ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit, si obligim i panegociueshëm i institucioneve qendrore dhe lokale,
- Rrënimi i ndërtimeve pa leje në Qendrën Historike të Prizrenit për të parandaluar zhdukjen totale të trashëgimisë kulturore,
- Respektimi i përpiktë i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor, ku çdo pëlqim i lëshuar nga kjo qendër duhet të jetë detyrues për komunën e Prizrenit,
- Hartimi i planit lokal të trashëgimisë kulturore do të ndihmonte planifikimin strategjik të trashëgimisë kulturore,
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në hartimin e planeve urbane duhet të jetë komponentë qendrore e planifikimit urban,

- Buxhetimi me pjesëmarrje në sektorin e kulturës është kusht elementar i demokracisë në qeverisjen dhe planifikimin e qytetit,
- Krijimi i një mentaliteti të ri ku trashëgimia kulturore të jetë pjesë e kurikulës shkollore,
- Përcaktimi i kritereve për ndarjen e granteve për kulturën e pavarur përmes një sistemi të kritereve dhe të bazuar në merita.

Hyrje

Kultura nuk është një sektor i veçantë i politikave, por pjesë integrale e planifikimit zhvillimor, e në këtë kuadër edhe e planifikimit urban. “Artet dhe burimet kulturore në përgjithësi po shndërrohen në asete strategjike të planifikimit dhe zhvillimit urban, duke luajtur rol qenësor në zhvillimin e ekonomisë së re.”¹⁰⁰ Raporti i UN Habitat “State of the World’s Cities Report” i vitit 2004 ka dokumentuar trendin në rritje të ribrendimit të qyteteve si parajsë kulturore, që sipas raportit paraqet një “përpjekje kreative nga shumë qeveri lokale për t’i zhvilluar ekonomitë që kanë nevojë për mekanizma ringjallëse urbane”.¹⁰¹ Raporti gjithashtu konstaton se “mbi supozimin që kultura mund të jetë motor i gjenerimit të punësimit, qeveritë janë duke i orientuar investimet kah industrinë dhe distriktet kulturore, përfshi hapësirat publike, komoditetet kulturore të së cilës kanë prirje të harmonizojnë interesat e ndryshme shoqërore dhe të ngrisin cilësinë e jetesës urbane”.¹⁰²

Planifikimi urban nuk guxon të mbetet një aktivitet thjesht fizik e teknik, por duhet ta ketë të integruar dimensionin njerëzor. Sot flitet për “kthesën kulturore” të planifikimit urban, ndërsa avokuesit argumentojnë se, sado të rëndësishëm që janë, planerët urban duhet të zgjerojnë agjendën dhe qasjen e tyre. Qytetet dhe jeta në qytete nuk ka të bëjë vetëm me dizajnimin e hapësirës fizike, pasi që njerëzit e zhvillojnë jetën e tyre pikërisht brenda këtyre hapësirave, jo rrallë në mospërputhje me qëllimet origjinale të planerëve. Planifikimi urban duhet të përfshijë një koncept shumë më të gjerë social e kulturor, sesa vetëm vizatimi i vijave me ngjyra të ndryshme mbi një copë letër.

Ekziston një nevojë imediate për ridefinimin e rolit të kulturës në politika publike në përgjithësi, e në planifikim urban në veçanti. Arti dhe kultura duhet të kenë mjete komunikimi me sferat e tjera të politikave, si psh. planifikimi hapësiror, zhvillimi ekonomik, turizmi, rinia dhe arsimit, politika e jashtme, qeverisja lokale, etj. Kjo do të promovonte qasjen e re qeveritare ndaj kulturës, duke e vendosur atë në qendër të planifikimit të politikave shtetërore. Kjo qasje, përveç që ndikon në rritjen e buxhetit shtetëror për kulturën, do të siguronte ndërveprimin e kulturës me sistemin arsimor dhe edukimin artistik të fëmijëve, planifikimin hapësiror dhe mbrojtjen e mjedisit, zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik përmes industrive kreative, politikën e jashtme dhe diplomacinë kulturore, qeverisjen lokale dhe sferat e tjera potenciale.¹⁰³

Një numër i konsiderueshëm dokumentesh strategjike të miratuara nga të dy nivelet e qeverisjes në Kosovë qartësojnë kahet zhvillimore të komunës së Prizrenit. Në bazë të analizës së këtyre dokumenteve konstatohet se zhvillimi i turizmit është ndër mundësitë më reale të forcimit të ekonomisë lokale të

¹⁰⁰ Colin Mercer, Cultural planning for urban development and creative cities, 2006, në http://burgosciudad21.org/adftp/Shanghai_cultural_planning_paper.pdf

¹⁰¹ UN Habitat, State of the World’s Cities Report, 2004, në <http://www.unhabitat.org/pmss/listItemDetails.aspx?publicationID=1163>

¹⁰² Po aty

¹⁰³ Forumi Kulturor, Pse na duhet një strategji e kulturës?, 2012, në <http://forumikulturor.net/cms/wp-content/uploads/2012/11/Pse-na-duhet-nj%C3%AB-Strategji-e-Kultur%C3%ABs.pdf>

Prizrenit. Një numër i dokumenteve zhvillimore e konstatojnë potencialin e zhvillimit lokal të Prizrenit bazuar në turizëm: Plani Hapësinor i Kosovës dhe Ardhmëria e Komunës së Prizrenit, Vizioni i Integruar i Prizrenit dhe ardhmëria e Komunës së Prizrenit, Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit dhe Ardhmëria e Komunës së Prizrenit, Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendres Historike, Strategjia orientuese për zhvillimin kulturor në Komunën e Prizrenit 2012 – 2016.

Turizmi kulturor përbën një nga potencialet e medha për zhvillim në Kosovë, por ai shfrytëzohet dhe promovohet shumë pak. Një numer ngjarjesh kulturore organizohen në qytete të ndryshme të Kosovës. Këto aktivitete kryesisht organizohen nga organizata të shoqërisë civile dhe operatorët kulturorë dhe tërheqin turistë vendorë e të huaj. Një nga ngjarjet e përvitshme më me ndikim në Kosovë është festivali i filmit dokumentar, Dokufest, në Prizren. Sipas statistikave të festivalit, rreth 10,000 vetë kanë marrë pjesë në edicionin e vitit 2013 të festivalit, ku 23% nga gjithsej numri i mysafirëve ishin vizitorë të huaj. Hulumtimi i kryer nga Instituti GAP gjatë edicionit të dhjetë të këtij festivali (2011) tregon që ndikimi ekonomik i Dokufestit në BPV-ne ishte €3.1 milionë, gjersa ky numër pritet të jetë €21.9 milionë gjatë periudhës së ardhshme katërvjeçare.¹⁰⁴

Situata aktuale / korniza strategjike

Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ i përpiluar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në vitin 2010 propozon katër zona/regjione ku Prizreni është qendër e Kopshteve të Kosovës. Kjo zonë është paraparë për turizmin kulturor, industrinë bujqësore dhe tregti dhe shërbime ku Prizreni ka një rol udhëheqës me potencialin e saj rekreativ dhe kulturor, si dhe vlerat natyrore dhe ato të trashëgimisë kulturore. Vizioni për Prizrenin në bazë të këtij plani është ndërtimi i qendrës në rrënjët tradicionale të kësaj treve antike, të shndërrohet në një qendër moderne kulturore-turistike të zhvilluar në një rrjet funksional duke krijuar lidhje më të forta me fshatrat rurale për të stimuluar aktivitetet e bazuara në potencialet natyrore, atraktive për të punuar dhe jetuar aty dhe hapësirë të mjaftueshme për kyçjen e sektorit privat në vreshtari, bujqësi dhe turizëm. Plani po ashtu sugjeron krijimin e ambientit tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve private afariste dhe inkurajon shfrytëzimin më të mirë të potencialeve lokale ekonomike si dhe të burimeve njerëzore e natyrore, sidomos në turizëm dhe bujqësi.¹⁰⁵

Në mesin e pesë qëllimeve të përgjithshme për Prizrenin të caktuara në Plan është edhe “zhvillimi i turizmit malor dhe atij kulturor, mbrojtja e trashëgimisë kulturore, historike dhe natyrore.” Sidomos konsiderata e trashëgimisë kulturore në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+ është një hap i rëndësishëm për zhvillimin e ardhshëm dhe strategjisë së konservimit (ruajtjes) të vendit. Në këtë aspekt, Prizreni është një nyje e rëndësishme me trashëgiminë e saj të pasur historike dhe kulturore si dhe me resurse mjedisore. Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+ e përcakton rolin e Prizrenit si “Qytet Muze” për të kontribuar në krijimin e kushteve për mbrojtjen dhe shfrytëzimin e trashëgimisë për zhvillimin lokal ekonomik. Por duke u nisur nga strategjia, ka nevojë për një veprim të përqendruar në aspektin e mbrojtjes ambientale dhe të burimeve njerëzore, si dhe për promovim të trashëgimisë kulturore dhe natyrore, mbrojtjen e cilësisë së tokës bujqësore dhe promovimin e prodhimeve vendore, mbrojtje të resurseve minerale dhe përdorimin racional të tyre si dhe kontrollimin e rritjes së vendbanimeve.¹⁰⁶

¹⁰⁴ Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, Profili i Sektorit të Turizmit, 2014

¹⁰⁵ Ministria e Mjedisit dhe Planifikimi Hapësinor, Plani Hapësinor i Kosovës 2010-2020+

¹⁰⁶ Po aty

Vizioni i integruar i Prizrenit i përgatitur nga Komuna e Prizrenit dhe UN HABITAT në Mars të vitit 2008 përcjellë vizionin e përcaktuar në Planin Hapësinor të Kosovës 2010-2020+, dhe Prizreni definohet si: “qendra e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, me një ekonomi që krijon potenciale për zhvillimin e shoqërisë si dhe udhëkryq i regjionit ku sundon toleranca dhe ligji” Ajo është strukturuar në pesë fusha themelore të intervenimit sa i përket zhvillimit komunal. Këto fusha janë: Zhvillimi urban dhe rural dhe Planifikimi, Lëvizshmëria dhe Transporti, Trashëgimia Kulturore dhe Burimet Natyrore, Ambienti Ekonomik dhe Bujqësia, Infrastruktura dhe Shërbimet Publike.¹⁰⁷

Plani Zhvillimor Urban i Prizrenit që është përgatitur nga Komuna e Prizrenit më 2003 dhe paraqet një plan dhjetë vjeçar për zhvillimin e qëndrueshëm të qendrës së Prizrenit. Ky plan nuk ka një vizion të qartë për ardhmërinë e Komunës së Prizrenit. Plani nënvizon rëndësinë e madhe të trashëgimisë kulturore dhe historike të Prizrenit. Ruajtja dhe integrimi i ndërtesave dhe komplekseve ndërtimore me vlera historike dhe kulturore në zhvillimet bashkëkohore kanë rolin e madh në zhvillimin e përhershëm. Trashëgimia e mbrojtur do të paraqesë një përbërës të rëndësishëm të pamjes së përgjithshme të qytetit. Të gjitha vlerat trashëgimore duhet të rigjenerohen. Qëllimi i këtij regjenerimi është arritja e vlerave që do të ballafaqohet me ndryshimet kohore. Trashëgimia kulturore dhe historike janë potencial për zhvillimin ekonomik. Promovimi i këtyre vlerave paraqet trendin zhvillimor të sektorit të turizmit.¹⁰⁸

Vizioni për Prizrenin i përcaktuar në Planin Zhvillimor Komunal të Prizrenit 2025 është: Prizreni pritet të ketë pozitë qendrore si qendër moderne kulturore turistike përmes rrjetit funksional që krijon lidhje më të forta me fshatrat rurale. Rezultatet e pyetësorit nga debati publik PZHKP 2025 po ashtu sugjerojnë rolin e ardhshëm të Prizrenit si qendër kulturore që përdor trashëgiminë e saj të pasur kulturore dhe natyrore. Komuna e Prizrenit posedon një sërë forcash shtytëse siç është prezantuar në fazën e parë të PZHKP 2025. Ato janë: Trashëgimia e pasur kulturore dhe natyrore, Resurset e pasura / të volitshme mjedisore, Diversiteti socio- kulturor, Fuqia punëtore e re dhe e edukuar dhe e kualifikuar, Potenciali i lartë bujqësor dhe prodhues, Linja të mira transportuese me pjesët tjera të Kosovës dhe shtetet fqinjë.¹⁰⁹

Parimet kyçe të PZHKP 2025 janë :

- Parimi 1: Ruajtja e trashëgimisë natyrore dhe kulturore
- Parimi 2: Qëndrueshmëria ambientale
- Parimi 3: Inkuadrimi social, barazia sociale dhe cilësia e lartë jetësore.
- Parimi 4: Vitaliteti ekonomik
- Parimi 5: Integriteti hapësinor

Një tjetër dokument strategjik është edhe Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike. Objektivat themelore të Planit të Konservimit janë grupuar në këto kategori: Kualifikimi Funksional, Komunikimi Optimal, Integrimi shoqëror dhe kulturor, Mjedis pozitiv për kualitetin arkitektonik dhe urban, Kushte pozitive për shëndet dhe qetësi, Çmimi optimal dhe përkrahja ekonomike, Flaksibiliteti dhe zbatueshmëria. Objektivat e kategorisë “Integrimi shoqëror dhe kulturor” janë:

- Të bëhet transformimi i një nga vendet më të rëndësishme të Kosovës përsëri në një qendër atraktive kulturore e turistike, duke lartësuar vlerat kulturore, arkeologjike dhe natyrore, si dhe potencialin e trashëgimisë arkitektonike dhe strukturën tradicionale urbane që e posedon,

¹⁰⁷ Komuna e Prizrenit dhe UN Habitat, Vizioni i Integruar i Prizrenit, 2008

¹⁰⁸ Komuna e Prizrenit, Plani Zhvillimor Urban 2003-2013

¹⁰⁹ Komuna e Prizrenit, Plani Zhvillimor Komunal i Prizrenit 2025

- Të ngritët vetëdija publike mbi konservimin e trashëgimisë kulturore duke siguruar një ambient edukativ,
- Të rritë kuptimin e planit të konservimit në mënyrë që të siguroj zhvillimin e strukturave shoqërore,
- Të tërheqë vëmendje në konservim, planifikim dhe procesin e tij të implementimit me pjesëmarrjen e plotë të banorëve.

Ideja e përgjithshme e njerëzve është që të vlerësohen tiparet historike të zonës me anë të organizimeve të ndryshme në Prizren. Shumica e njerëzve kanë deklaruar se ata e imagjinojnë vendin të shfrytëzohet për qëllime turistike dhe mendojnë se shumica e shtëpive të listuara duhet të restaurohen dhe të shfrytëzohen si hotele, restorante dhe përmbajtje të ngjashme. Njerëzit kanë nevojë për një mjedis me më shumë vende për këmbësorë dhe se Prizreni duhet të zhvillohet duke marrë parasysh potencialin turistik dhe kulturor. KK i Prizrenit ndien nevojën për plane të detajizuara të këtij lloji si dhe projekt-propozime duke pasur parasysh që një ndër komponentet kryesore për zhvillim ekonomik të Komunës së Prizrenit është edhe turizmi dhe zhvillimi i tij duke e shfrytëzuar trashëgiminë kulturore dhe revitalizimin e objekteve me vlera, monumenteve, shesheve, krijimin e ansambleve me vlera si dhe revitalizimin e atyre ekzistuese si dhe aktiviteteve kulturore që mund të zhvillohen duke pasur parasysh karakterin e zonës.¹¹⁰

Strategjia orientuese për zhvillimin kulturor në Komunën e Prizrenit 2012-2016 është edhe një zotim i komunës së Prizrenit për të shfrytëzuar turizmin për nevoja të zhvillimit lokal ekonomik. Falë infrastrukturës së instaluar kulturore, e cila përpiqet të jetë në funksion të ruajtjes, kultivimit dhe prezantimit të vlerave të trashëgimisë së kulturës materiale e shpirtërore, qyteti i Prizrenit provon të projektojë edhe në zhvillimin e turizmit, si veprimtari ekonomike profitabile. Prizreni ka një potencial të lakmueshëm vlerash kulturore të trashëguara nga periudha të ndryshme historike. Me 24 lokalitete arkeologjike të identifikuara, me 39 objekte kulti të krishtera, 46 objekte sakrale islame, me mbi 74 objekte me karakteristika të theksuara të arkitekturës folklorike, Prizreni synon të bëhet një qendër e frekuentuar turistike. Kalaja që ngrihet në kodrën mbi qytet, Kisha e Shën Premtes, Manastiri i Kryeengujve, Kisha e Shën Shpëtimtarit, Katedralja e Zonjës Ndihmëtare, Xhamia e Sinan Pashës, Hamami i Gazi-Mehmet Pashës, Ura e Vjetër e Gurit, janë vetëm një pjesë e trashëgimisë së kulturës materiale që mund të hasen në qytetin e Prizrenit.¹¹¹

Prizreni është i njohur edhe për traditën e mirë të kultivimit të arteve të bukura. Në te janë organizuar dhe vazhdojnë të organizohen manifestime të shumta kulturore tradicionale. Festivali i këngës së vjetër qytetare “Zambaku i Prizrenit”, Festivali i filmit dokumentar dhe të shkurtër “Dokufest”, fillimi i mbarë punës së Teatrit Profesionist të qytetit, dhe një varg ngjarjesh tjera kulturore të karakterit kombëtar e ndërkombëtar, e bëjnë Prizrenin edhe më joshës në planin turistik. Kur të gjitha këtyre u shtohen edhe bukuritë e rralla natyrore të Maleve të Sharrit me qendrën e njohur skitare, me të drejtë mund të thuhet se “mozaiku i kërkesave turistike” plotësohet në tërësi.¹¹²

Përkundër të gjitha këtyre dokumenteve strategjike, Prizrenit ende nuk e ka jetësuar vizionin zhvillimor të bazuar në turizëm kulturor. Për më tepër, Prizreni është një rast tipik i dështimit të institucioneve të shtetit në mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Degradimi i vlerave të Qendrës Historike të qytetit ka ardhur si pasojë e mosrespektimit të kornizës ligjore për trashëgiminë kulturore nga të dyja nivelet e

¹¹⁰ Komuna e Prizrenit, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit

¹¹¹ Komuna e Prizrenit, Strategjia orientuese për zhvillimin kulturor në Komunën e Prizrenit 2012-2016

¹¹² Po aty

qeverisjes. Derisa MKRS nuk e ka kryer obligimin e vet mbikëqyrës, qeveria lokale e Prizrenit ka qenë e paaftë në parandalimin e veprimeve shkatërruese të ndërtuesve në dëm të trashëgimisë kulturore. Më keq se kaq, qeveria lokale e Prizrenit, me shpërfilljen e ligjeve, Planit të Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit¹¹³ dhe planeve rregullative urbane,¹¹⁴ ka qenë kontribuesi kryesor në procesin e zhdukjes së vlerave kulturore dhe historike të qytetit.¹¹⁵

Kosova (rrjedhimisht edhe Prizreni) ende nuk ka zhvilluar qasje të integruar të planifikimit dhe zhvillimit të politikave. Në rastin konkret, politika e konservimit të integruar paraqet domosdoshmërinë për koordinim institucional për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore. Një qasje e tillë presupozon se trashëgimia kulturore është përgjegjësi shumë më e gjerë se sa e një institucioni të vetëm. Konservimi i integruar ka të bëjë me bashkëpunimin ndërsektoral mes organeve të ndryshme publike administrative, si dhe me koordinimin e masave legjislative në mënyrë që të plotësojnë dhe zgjerojnë njëra tjetrën.¹¹⁶

Të gjeturat

Në shtator të vitit 2014, EC Ma Ndryshe ka publikuar rezultatet e anketimit të tretë me mostër të gjerë në qytetin e Prizrenit brenda dy viteve, që ka për qëllim konstatimin e shqetësimeve kryesore dhe matjen e kënaqshmërisë së qytetarëve të Prizrenit rreth urbanizmit. Huluntimi është pjesë e metodologjisë së projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës...”, i cili nga janari i vitit 2013 i përkthen nevojat e qytetarëve të Prizrenit në plane të zbatueshme urbane të komunës. Anketa ishte e ndarë në dy pjesë, me popullatën e përgjithshme ku kanë marrë pjesë 300 respondentë (ku 55% të gjinisë femërore dhe 45% të gjinisë mashkullore) dhe me organizata e grupe të komunitetit ku janë zhvilluar 100 intervista. Huluntimi ka shikuar edhe perceptimet e organizatave kulturore dhe mjedisore në Prizren dhe ka konstatuar se pesë shqetësimet kryesore të këtyre grupeve janë: ndotja e mjedisit, shkatërrimi i Qendrës Historike, mungesa e planit për zhvillim të qëndrueshëm mjedisor, bllokimi i trotuarëve dhe mungesa e hapësirave kulturore.

Këto të gjetura të anketimit me mostër të gjerë në Prizren konfirmohen edhe nga fokus grupet dhe debatet e organiizuara me grupin e komunitetit të kulturës në kuadër të projektit “Qyteti Gjithëpërfshirës...”.

Gjatë fokus grupeve të projektit me komunitetin e kulturës, në pah kanë dal shumë shqetësime të këtij sektori në raport me planifikimin urban. Në pjesën pasuese, këto të gjetura janë të paraqitura të grupara në kuadër të trashëgimisë kulturore dhe turizmit kulturor. Një pjesë e të gjeturave korrespondojnë edhe me diskutimet e zhvilluara gjatë vitit 2013 në kuadër të projektit, duke e konfirmuar ngencjen e komunës në adresimin e sfidave në këtë sektor. Konstatim i shpeshtë i diskutimeve është se kultura vazhdon të mos jetë prioritet për politikën e Komunës së Prizrenit. Asaj vazhdohet të i ndahet një buxhet shumë i vogël me të cilin financohen disa aktivitete minore në raport me zhvillimin kulturor të nevojshëm. Potenciali kulturor të cilin e ka Prizreni duhet të përkthehet në planifikim dhe zhvillim të

¹¹³ Komuna e Prizrenit, Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Zonës Historike të Prizrenit, 2008, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/getattachment/25fdb992-4fa8-4623-9811-ae22a0bd6b2a/Plani-i-Konservimit-dhe-Zhvillimit-te-Zones-Histor.aspx>

¹¹⁴ Komuna e Prizrenit, Planet Rregullative, në <http://kk.rks-gov.net/prizren/Projects/Planet-Rregullative.aspx>

¹¹⁵ EC Ma Ndryshe për Forumin 2015, Gabim pas Gabimi, 2013, në http://ecmandryshe.org/repository/docs/Gabim_pas_gabimi_ALB.pdf

¹¹⁶ Baza e parimeve të konservimit të integruar për herë të parë u vendos në Kartën Evropiane të Trashëgimisë Arkitekturale dhe Deklaratën e Amsterdimit, miratuar në vitin 1975 nga Komisioni i Ministrave i Këshillit të Evropës

Prizrenit, duke u përfshirë në prioritetet e komunës, duke ikur nga investimet (subvencionet) disa qindra euroshe në emër të përkrahjes së aktiviteteve kulturore. Mbi të gjitha, Drejtoria e Kulturës është vendosur në qendër të pazareve plotike, duke emëruar drejtorë të pa profilizuar dhe të cilën nuk marrin mundin të jenë pranë komunitetit kulturor e as t'i përcjellin aktivitetet kulturore. Problemi i buxhetimit vazhdon të jetë një ndër sfidat kryesore, duke qenë se rëndom investohet në infrastrukturë dhe të tjera kategori të cilat plotësojnë qëllimet politike të kohës.

Trashëgimia kulturore

- Objektet e trashëgimisë kulturore, përveç mungesës së investimeve të nevojshme për ruajtjen e tyre, ballafaqohen edhe me mungesë të shenjëzimit, ndriçimit dhe rrethimit adekuat,
- Komuna ka qenë investuese e disa projekteve restauruese të cilat janë kryer në kundërshtim me parimet profesionale të intervenimit. Rast tipik është projekti i shtëpisë së Shuaip Pashës, i cili përveç tjerash, ka mbet edhe pa një plan të menaxhimit,
- Qytetarët dhe shoqëria civile shumë shpesh kanë ndërmarrë veprime konkrete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, por një pjesë e madhe e tyre nuk kanë patur ndikim real për shkak të apatisë dhe mosinteresimit të institucioneve shtetërore,
- Ka mungesë angazhimi për të ngritur vetëdijen e fëmijëve dhe nxënësve shkollorë për rëndësinë e trashëgimisë kulturore dhe angazhimin e tyre për mbrojtjen e qytetit,
- Komuna dhe autoritetet e zbatimit të ligjit shpesh janë të paafta t'i ndalin veprimet e paligjshme në Qendrën Historike për shkak të mungesës së vullnetit për t'u ballafaquar me persona që konsiderohen të fuqishëm dhe mbi ligjin,
- Ka mungesë të theksuar koordinimi mes institucioneve, sidomos mes komunës dhe Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore, për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore,
- Edhe brenda komunës, planifikimi urban funksionon pothuaj tërësisht i shkëputur nga sektorët e kulturës, inspektoratit dhe turizmit, duke e pamundësuar qasjen e planifikimit të integruar,
- Ndërtimet pa leje, sidomos ato brenda Qendrës Historike të Prizrenit, janë shkaktari kryesor i degradimit të trashëgimisë kulturore,
- Plani i Konservimit dhe Zhvillimit të Qendrës Historike të Prizrenit, i miratuar nga Kuvendi i Komunës më 2008 është dokument që është shkëlur në mënyrë sistematike nga vetë autoritetet komunale.

Turizmi kulturor

- Qyteti nuk ka arritur të strukturojë dhe paraqesë ofertën e vet kulturore dhe turistike, ndërsa mungojnë edhe produktet bazike si pakot turistike,
- Ndonëse kohëve të fundit janë prodhuar disa materiale promovuese për turizmin kulturor, një pjesë e konsiderueshme e tyre nuk janë me përmbajtje dhe prezantim atraktiv për turistin,
- Info Qendra turistike e vendosur brenda objektit të Beledijes funksionon me kapacitete të kufizuara, ndërsa nuk i shërben ndonjë numri të madh vizitorësh, kryesisht për shkak të lokacionit të fshehtë,
- Jo vetëm Prizreni, por edhe Kosova në përgjithësi ka mungesë ekspertësh të turizmit, ndërsa shpesh turizmi nuk trajtohet si pjesë integrale e planifikimit të politikave kulturore, trashëgimisë kulturore zhvillimit urban e rural, zhvillimit ekonomik, etj,
- Prizrenit i mungon një mekanizëm matës për zhvillimin e turizmit, i cili do të përpilonte analiza në aspektin hapësinor, duke ofruar të dhëna mbi zhvillimin e turizmit, numrin dhe profilin e vizitorëve, hapësirën e nevojshme për turizëm, etj,
- Mungesa e politikave adekuate për zhvillimin e turizmit kulturor është treguesi më i mirë i përkushtimit të mangët të qeverisë lokale për zhvillimin e turizmit. Edhe pse komuna pati shpreh vullnetin për të përpiluar një strategji të turizmit, ky veprim vazhdon të jetë në pritje,

- Përkundër ekzistimit të Drejtorisë së Kulturës dhe asaj të Turizmit, nuk ekziston asnjë lloj komunikimi dhe bashkëpunimi në mes tyre,
- Operatorë turistike të shteteve fqinje janë duke përfituar nga potenciali turistik i qytetit, përderisa në këtë aspekt do të mund të përfitonte më shumë vetë qyteti po qe se do të ekzistonte një strategji,
- Zejet e Prizrenit nuk e gëzojnë trajtimin e merituar bazuar në rëndësinë e tyre kulturore dhe afariste që e kishin dikur. Zejtaria është një segment i rëndësishëm i zhvillimit të qytetit dhe se hapësira të caktuara në qytet duhej t'i dedikoheshin zhvillimit dhe promovimit të zejtarisë.

Rekomandimet

Bazuar në të gjeturat e projektit përmes fokus grupeve, debateve, anketimeve me qytetarë, si dhe dokumenteve dhe analizave ekzistuese në fushën e kulturës (trashëgimisë kulturore) dhe planifikimit urban nga EC Ma Ndryshe dhe organizatat e institucionet e tjera të sektorit, në vijim janë rekomandimet specifike për qeverinë lokale të Prizrenit për integrimin e kulturës në planifikimin zhvillimor të komunës (përmes turizmit kulturor).

- Ekziston një nevojë imediate për ridefinimin e rolit të kulturës në politika publike. Arti dhe kultura duhet të kenë mjete komunikimi me sferat e tjera të politikave, si psh. planifikimi hapësinor, zhvillimi ekonomik, turizmi, rinia dhe arsimi, politika e jashtme, qeverisja lokale, etj. Prizreni ka nevojë për një strategji të zhvillimit të kulturës që do të promovonte qasjen e re ndaj kulturës, duke e vendosur atë në qendër të planifikimit të politikave publike komunale, me theks të veçantë në planifikimin urban,
- Hartimi i strategjisë për turizëm kulturor, ndërsa planifikimi dhe realizimi i kësaj politikave lokale duhet të ndjekë linjën e integruar, sipas të cilës zhvillimi kulturor nënkupton koordinimin mes shumë sektorëve të politikave lokale,
- Respektimi i të gjitha dokumenteve strategjike të nivelit qendror dhe lokal të cilat e vizionojnë zhvillimin e Prizrenit përmes turizmit, me fokus në trashëgiminë kulturore, jetën kulturore (prodhimtarinë artistike) dhe natyrën,
- Fokus më i madh në përmbajtje kulturore (aktivitete) se sa në infrastrukturë, pasi që zhvillimi kulturor nuk mund të realizohet vetëm përmes investimeve në hapësira fizike. Krijimi dhe pasurimi i përmbajtjes kulturore (prodhimtarisë artistike) është në thelbin e ofertës kulturore dhe turistike të qytetit,
- Zhvillimi i produkteve të reja dhe profesionale turistike përmes të cilave do të pasurohet oferta turistike e qytetit. Komponentë qendrore e ofertës turistike duhet të jetë prodhimtaria kulturore dhe artistike,
- Respektimi i të gjitha ligjeve për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore të Prizrenit, si obligim i panegociueshëm i institucioneve qendrore dhe lokale për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm të Prizrenit,
- Rrënimi i ndërtimeve pa leje në Qendrën Historike të Prizrenit për të parandaluar zhdukjen totale të trashëgimisë kulturore. Autoritetet komunale duhet të ndërmarrin veprime konkrete

për rrënimin e ndërtimeve pa leje dhe tejkalimeve të tjera që janë në kundërshtim me parimet e trashëgimisë kulturore,

- Respektimi i përpiktë i Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturore, ku çdo pëlqim i lëshuar nga kjo qendër duhet të jetë detyrues për komunën e Prizrenit, pasi që ato bazohen në standardet ndërkombëtare dhe ligjet shtetërore të trashëgimisë kulturore. Prandaj, çdo tejkalim i masave të parapara me pëlqime të QRTK-së duhet të pengohet dhe/ose të ndëshkohet nga autoritetet lokale dhe qendrore,
- Hartimi i planit lokal të trashëgimisë kulturore do të ndihmonte planifikimin strategjik të trashëgimisë kulturore, ndërsa komuna e Prizrenit do të valirizonte një potencial të rëndësishëm për zhvillimin lokal ekonomik. Plani lokal i trashëgimisë kulturore do të hapte rrugë edhe për koordinim më të mirë ndër-sektoral bazuar në parimet e konservimit të integruar (sidomos me planifikimin urban),
- Përfshirja e trashëgimisë kulturore në hartimin e planeve urbane duhet të jetë komponentë qendrore e planifikimit urban në Prizrenit. Gjatë hartimit të planeve urbane, komuna duhet të respektojë të gjitha parimet e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore,
- Buxhetimi me pjesëmarrje në sektorin e kulturës është kusht elementar i demokracisë në qeverisjen dhe planifikimin e qytetit. Komuniteti i kulturës duhet të jenë pjesë e definimit të buxhetit komunal, e sidomos për pjesën e kulturës dhe trashëgimisë kulturore,
- Krijimi i një mentaliteti të ri ku trashëgimia kulturore të jetë pjesë e kurikulës shkollore dhe të mësuarit për trashëgiminë kulturore do të fillojë në shkollën fillore, duke e përfshirë lëndën përkatëse në kurrikilat zyrtare shkollore,
- Përcaktimi i kriterëve për ndarjen e granteve për kulturën e pavarur (shpenzimi i buxhetit komunal për kulturën e pavarur) duhet të realizohet përmes një sistemi të kriterëve dhe të bazuar në merita.

EC Ma Ndryshe

Organizata jo-qeveritare “EC Ma Ndryshe” u themelua në mars të vitit 2006. Qëllimet kryesore të organizatës janë: promovimi i qytetarisë aktive dhe pjesëmarrëse dhe ngritja e vetëdijes qytetare për mbrojtjen dhe kultivimin e trashëgimisë kulturore. EC Ma Ndryshe është ndër themelueset dhe përfaqëson Kosovën në Rrjetin e Evropës Juglindore të organizatave që merren me trashëgimi kulturore – SEE Heritage Network. Gjithashtu, është themeluese e Forumit të Trashëgimisë Kulturore të Prizrenit, Rrjetit të Organizatave Kulturore të Prizrenit dhe Rrjetit të Organizatave të Pavarura të Kulturës në Kosovë – Forumi Kulturor. EC Ma Ndryshe, që nga themelimi më 2006 është duke ushtruar presion direkt ndaj qeverisë lokale të Prizrenit për t’i krijuar qasje shoqërisë civile dhe qytetarëve për bashkë vendimmarrje. Përveç pjesëmarrjes direkte në proceset e konsultimeve publike, EC Ma Ndryshe ka avokuar rregullisht për respektimin e obligimeve ligjore për konsultime publike, përfshirjen sa më të gjerë komunitare në konsultime publike dhe përfshirjen e shqetësimeve dhe kërkesave të komunitetit në dokumentet e politikave publike.

Projektet kryesore: Aktivizmi kulturor dhe urban në Prizren (2014 – 2015), Lidhja e komunitetit me shërbyesit e drejtësisë (2014), Urbanism Watch - Urbanizmi i Prizrenit nën vëzhgim të përhershëm (2013 – 2014), Pjesëmarrja qytetare përmes medias sociale në Prizren dhe Gjilan (2013 – 2014), Qyteti gjithëpërfshirës – planifikimi me pjesëmarrje për zhvillim të qëndrueshëm urban në Prizren (2013 – 2015), Trashëgimia kulturore, shtyllë qendrore për zhvillim të qëndrueshëm lokal dhe rajonal në Prizren (2013 – 2014), Vullnetarët e Kulturës (2012 – 2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin dhe zbatimin e politikave kulturore në komunën e Prizrenit (2012 – 2013), Transparenca online e komunës së Prizrenit, Mamushës dhe Prishtinës (2012 - 2015), Roli i shoqërisë civile në promovimin e trashëgimisë kulturore (projekt rajonal) 2011 – 2013, Një përrallë ballkanike, trashëgimia otomane në Ballkan (projekt rajonal) (2011 – 2013), Ngritja e vetëdijes kulturore tek të rinjtë përmes dokumentarëve (2010), Forcimi i veprimit qytetar për promovim dhe mbrojtje të trashëgimisë kulturore (2009), Platforma “Culture 2013” (2008 – 2009), Kampet e Restaurimit (2007, 2008 & 2009), Forumet e Hapura Qytetare (2007), Ditët e Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2006, 2007 & 2008), Zambaku i Prizrenit 2006.

Publikimet: Ku është kalldrëmi i Prizrenit (2014), Qendra Historike e Prishtinës numëron ditët e fundit (2014), Paraja publike si “paret e babës” (2014), Rinia dhe Transparenca: Përparim apo stagnim? (2014), Dokumentari - Sa aktiv, aq transparent? (2014), Udhëzues për Transparencën në Komuna (2014), Ligjet nuk po e mbrojnë Qendrën Historike (2014), Urbanizmi si lexim i qytetit (2014), Qendra Historike e Prizrenit–zonë e (pa)mbrojtur (2014), Qyteti gjithëpërfshirës (2014), Kush mbikëqyr mbikëqyrësit – llogaridhënia e shoqërisë civile në Kosovë (2013), Rinia dhe Transparenca: Të përjashtuar apo të injoruar? (2013), Planifikimi Urban për Qytetarët (2013), Pjesëmarrja qytetare në hartimin e politikave kulturore në Prizren (2013), Prizreni “Qytet i kulturës” - film dokumentar (2013), Gabim pas gabimi – analizë mbi gabimet e panumërta dhe të vazhdueshme në trashëgimi kulturore (2013), Pesë analiza të projektit “Online Transparency”,: 1. Një vit monitorim për më shumë transparencë 2. Degradimi Natyror dhe Urbanistik, 3. Respektimi i ligjit në qeverisjen lokale, 4. Qeverisja e mirë nuk është fjalë goje, 5. Transparenca e qeverisjes lokale në Prizren (2012 – 2013), Silent Balkan, film dokumentar i projektit “A Balkan Tale” (2012), Jeta kulturore në komunën e Prizrenit (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2010-2011), Prizreni në Retrovizorë, krahasim i fotografive të vjetra dhe të reja të Prizrenit (2009), Vullnetarizmi dhe Trashëgimia Kulturore (2009), Intervenimi me kosto të ultë (2009), Dokument Strategjik mbi Organizimin e Ditëve të Trashëgimisë Evropiane në Kosovë (2008), Trashëgimia Kulturore dhe Turizmi Kulturor në Prizren (2008), Hapësirat Kulturore në Kosovë (në bashkëpunim me Teatrin ODA) (2008).